

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 390 MAJ 2023



VENDI YNË MERR PESHË E KUPTIM,
VETËM ME BIJTË E BIJAT E SAJ

RUAJTJA DHE KULTIVIMI
I VLERAVE TE RAMAZANIT

SHTATË MYFTILERËT
PREJ SAHABËVE

FËMIJËT, ZBUKURIM I ÇDO FESTE!

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, këshillat e Bashkësisë Islame në komuna të ndryshme të vendit kanë shpërndarë dhurata për fëmijë.

Mes urimeve e dhuratave fëmijët e shijuan festën dhe e zbukuruan atë me këndimin e ilahive, poezive e aktiviteteve të tjera.



EDITORIAL

- 4 Djersa që s'u çmua

FE & SHKENCË

- 5 Vendi ynë merr peshë e kuptim, vetëm me bijtë e bijat e saj
(Hytbeja e Fitër Bajramit)
- 7 Ndikimi dhe porositi e Ramazanit
(Ligjërata e Fitër Bajramit)
- 11 Komentimi i kaptinës El-Fet'h (4)
Sabri Bajgora
- 15 Ruajtja dhe kultivimi i asaj që e përvetësua në Ramazan
Mr. Muharrem Bryma
- 17 Shtatë myftilerët më të shquar në mesin e sahabëve
Shejh Muhamed Hasenej Makhlu
- 19 Të shpallurit e një personi si jobesimtar (kafir)
Mufti Muhamed Teki Usmani
- 23 Ateizmi, kauzë apo mohim?
Mr. Adnan Shala
- 26 Dispozitat e qirasë sipas jurisprudencës islame
Dr. Flamur Sofiu
- 30 Funkcioni i imamit në kohën e globalizmit
Bashkim Aliu
- 32 Arti dhe e vërteta
Besnik Jaha
- 34 Metodologjia e Pejgamberit a.s. në zgjidhjen e problemeve
Isa Tërshani
- 36 Tri cilësitë e Uvejs el Karnit
Florim Zejnullahu



- 39 Mjekësia islame – benefitet e ujit Zemzem
MSc. Njomza Sadriu

EDUKIM & FAMILJE

- 42 Si mund të arrihet bashkëpunimi shkollë - familje për edukimin moral?
Melihate Zeqiri
- 44 Shamia – obligim, liri dhe sfidë
Dr. Violeta Smajlaj
- 47 Mësoni nga fëmijët para se t'i mësoni ata!
Dr. Naif Isa Sheda



KULTURË

- 48 Vepra "El Hidaje" e Imam Merginanit
Blerton Bahtiri
- 51 Një burim i rëndësishëm për të kaluarën e Islamit dhe myslimanëve të vendeve tona
Nuridin Ahmeti
- 55 Rëndësia e mektebit në frymën e duhur islame
Dr. Azmir Jusufi



PERSONALITETE

- 58 Më shumë se një nekrolog për shokun dhe mikun tim të çmuar, Jashar ef. Jasharin
Ali Vezaj



AKTIVITETE

- 69 Besimtarët myslimanë festuan Fitër Bajramin



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 390 • viti 36 • maj 2023
• Sheval 1444
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavi,
mr. Vedat Shabani.
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë



“E, secilit sipas veprave që i ka kryer i takon merita- shkalla, e shpërblimi për veprat e tyre do t’u plotësohet, e nuk u bëhet padrejtë.”

(El Ahkaf, 19)

Djersa që s’u çmua

Puna dhe djersa e punëtorit mbeten faktorët kyçë dhe elementet më thelbësore që gjithnjë gjatë historisë kanë dalluar shoqëritë e ngritura e të civilizuar nga ato të ngathëta e të prapambetura. Ato vende që patën sukses që të krijonin tek anëtarët e shoqërive të tyre vetëdijen e punës së mirëfilltë, por edhe atë të elanit e angazhimit të pandalshëm, arritën ta lëviznin rrotën e historisë dhe lanë gjurmë të pashlyeshme në civilizimin njerëzor.

Megjithatë, ky, njeriu me vlerë, e pa të cilën nuk do të ndërtohej bota fare, jo rrallëherë mbetej njeriu më i nëpërkëmbur dhe të drejtat e tij përdhoseshin arbitrarisht, aq sa ai nuk trajtohej fare as si njeri. Ai, në shumë vende e shoqëri, më shumë i ngjante një të robëruari, fatin e të cilit e kishte në dorë punëdhënësi dhe zotëria i tij. Rrëfimet e gjata dhe tregimet e dhimbshme të cilat tregonin për vuajtjet dhe rënkimet e shtresës së punëtorëve anekënd botës, janë ana e errët e një civilizimi të kulluar materialist, pavarësisht se cilit pellg kulturor apo ideologjik i takonte ai. Punëtorëve iu desh që të sakrifikonin më të shtrenjtën, vetëm për të fituar edhe ato të drejtat minimale, ani pse puna e ndershme dhe fisnike ishte “mëkati” më i madh i tyre.

Shënimi i një date siç është ajo e 1 Majit, si Dita e Punëtorëve, na e rikthen në memorien tonë një listë të gjatë të vuajtjeve e sakrificave, që kjo shtresë i përjetoi. Historia e kësaj dite të shënuar si Dita e Punëtorëve, lidhet ngushtë me luftërat për punë të denjë dhe për pushim. Veprimet e para të suksesshme për vendosjen e ditës tetorëshe të punës ishin në Australi nga punëtorët e minierave të gurëve dhe ato të ndërtuesve atje, të cilët ndërprejnë punën e tyre dhe organizuan një protestë madhështore. Ato u pasuan 30 vjet më vonë – dhe atë mu më datën 1 maj, të vitit 1886, në SHBA-në, me të njëjtat moto e të njëjtat kërkesa. Protestuesit u shtypën pamëshirshëm, e disa edhe u vranë, mirëpo ideali dhe kërkesat e tyre mbetën gjallë. Këto ngjarje ndodhën ngase, gjithandej në shoqëritë e ndryshme njerëzore, vëreheshin se ekzistojnë ndarje në klasa me dallime të thella shtresore; njëra fisnike dhe aristokrate, kurse tjetra ajo ulëta dhe e pashtuara (skllavopronare). Aristokracia kishte të drejtë gjithçka, madje e kishte në dispozicion edhe jetën e punëtorit, ndërsa punëtori nuk posedonte asgjë, madje as të drejtën për të lëshuar ofshamën e dhimbjeve e përvuajtjeve të cilën ai e përjetonte për çdo ditë.

Një valë e tillë e pakënaqësive nuk ka shenja se do t’i ketë ardhur fundi, madje ato kanë tendenca edhe të përshkallëzimeve e masivizimit të mëtutjeshëm.

Në këtë kontekst, do të ishte e udhës që të ndalemi edhe njëherë për të parë se çfarë ishin të drejtat e punëtorit në platformën ideale islame. Platformë kjo e cila është e mbrojtur nga tendenca njerëzore dhe mbanë vulën e përkujdesjes hyjnore ndaj krijesës njeri.

Në shoqërinë e cila u ngrit mbi themelet e Drejtësisë Absolute të Krijuesit tonë, dhe e cila është formuar në frymën e Shpalljes Hyjnore, vlen postulatit kuranor: “E, secilit sipas veprave që i ka kryer i takon merita- shkalla, e shpërblimi për veprat e tyre do t’u plotësohet, e nuk u bëhet padrejtë.” (El Ahkaf, 19). Pra meritokracia është themeli i vlerësimit të çdo veprë në Islam. Edhe pse, në shikim të parë krijohet përshtypja se ky vlerësim ka të bëjë vetëm me shpërblimin e Botës Tjetër, megjithatë shumë prej ekonomistëve bashkëkohorë myslimanë, këtij citati i kanë dhënë hapësirë më të gjerë interpretuese, duke thënë që, sipas parimeve të Islamit, secili meriton edhe në këtë botë aq sa ka derdhur mundin për punën që ai ka kryer.

Ndërsa i Dërguari i Zotit, Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, në njërën anë punëtorit ia kërkoi të përkryerën dhe perfeksionimin e veprës së tij, kur ai tha: “Vërtet Allahu dëshiron që kur dikush ta kryej ndonjë punë, ta përkryej atë (sa të është e mundur)”. E në anën tjetër, punëdhënësit ia kërkoi shpërblimin dhe shpagimin e punës së punëtorit me meritë dhe pa vonesë kur atij iu drejtua: “Jepjani punëtorit shpagimin e duhur për punën e tij, para se atij t’i thahet djersa e tij”.

Këto dy porosi fisnike dhe kjo ekuivalencë mahnitëse në udhëzimet profetike mbesin sloganet më mbresëlënëse, nëpërmes të cilave kristalizohen të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësve dhe punëtorëve pa asnjë fije animi gjer në Amshim.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Fitër Bajramit

Vendi ynë merr peshë e kuptim, vetëm me bijtë e bijat e saj

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon Zotit të botëve, Atë e madhëron
çfarë ka në Tokë e çfarë ka në qiej, Ai është i Gjithë-
pushtetshmi, Absoluti.

Salatet e selamet tona ia dërgojmë më të mirit të njerëzisë,
Muhamed Mustafasë, familjes së tij të pastër dhe shokëve të
tij besnikë.

Të dashur besimtarë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Vëllezër e motra!

Në këtë mëngjes të bukur, ballëhapur e krenarë jemi tubuar
në xhamitë tona anakënd vendit për ta shënuar fillimin e
festës së Fitër Bajramit me namaz e lutje, festë e cila bartë në
vete gëzimin, harenë, lumturinë e çiltërsinë në shpirtin dhe
zemrën e besimtarit.

Të gjithë besimtarët gjithandej globit me plot arsye sot
festojnë, urojnë e përgëzojnë, ngase për një muaj rresht, me
bindje e përkushtim, kanë zbatuar urdhrin e Krijuesit të
gjithësisë, duke agjëruar muajin Ramazan.

Muaji Ramazan, të cilin sapo e lamë pas, me mirësitë e
begatitë e tij, si asnjë muaj tjetër, e si asnjë ibadet tjetër, na
ofroi qetësi, lutje, solidaritet e bamirësi.

Agjërimi për besimtarin është sakrificë që bëhet vetëm për
Krijuesin, andaj sot çdo besimtar e besimtare, i ri e i moshuar
ndjehet i gëzuar dhe ka arsye që të festojë me ibadet në xhami,
me gëzim në familje, farefis e shoqëri.

Tërë muajin Ramazan agjëruam, ibadet ky që kërkon
sakrificë e përmbytje, por mbi të gjitha kërkon bindje e
besim. Në Ramazan na bashkoi agjërimi, namazi, lutja, sofa
e iftarit e bereqeti i syfyrit, qemë bashkë në solidaritet e
bamirësi, prandaj sot kemi arsye që të jemi bashkë në festën
e Fitër Bajramit, festë kjo që përjetohet nga të gjitha shtresat
e shoqërisë.

Të nderuar besimtarë,

Vëllezër dhe motra!



Gjatë tërë muajit Ramazan ishim më të afërt, më të dëlirë,
më të urtë, më fisnikë e më humanë. Pa harruar që në
misionin tonë ishim me bindje, sinjeritet e devotshmëri.
Zaten ky është edhe qëllimi i agjëritimit, që njeriun ta
fisnikërojë e ta bëjë të ndërgjegjshëm për misionin e tij në
këtë botë.

Misioni i njeriut në këtë botë është që të njoh Krijuesin, të
praktikojë mësimet e Tij, si dhe të zgjojë në qenien e vetëdijen
e tij, ndërgjegjen e heshtur të shpirtërores e njerëzores, të cilat
e shtyjnë dhe e motivojnë për realizimin e idealeve të larta
gjatë jetës së tij.

Nimetet dhe begatitë e agjëritimit me të cilat Zoti xh.sh. i
furnizoi besimtarët ishin të mëdha e të shumta.

Gjatë gjithë muajit të bekuar Ramazan, shtëpitë, lagjet e
xhamitë tona përjetuan në formën më të mirë freskinë e



gjallërinë, të shoqëruar me ibadete me më të dashurit tanë, me miq e faqefis.

Vëllezër e motra!

Ramazanin po e përcjellim të lumtur që Krijuesi na e dha mundësinë t'i përjetojmë begatitë e tij, e sot, krenarë e faqebardhë, me familjet tona festojmë festën e Fitër Bajramit, festë kjo tashmë është e shtresuar thellë në identitetin tonë. Fitër Bajrami është festa më popullore që prek të gjitha moshat dhe të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Mësimet e porositë e muajit të bekuar Ramazan, duhet të na shoqërojnë edhe në muajt e tjerë, e para prej tyre është kujdesi ndaj familjes, ruajtjes së saj, si dhe rritës dhe edukimit të drejtë të saj. Vetëm një familje e shëndoshë dhe e edukuar mirë, është themeli për një komunitet e shoqëri me vlera e parime fisnike.

Familja te populli ynë, në vazhdimësi ka qenë institucioni më i vlerësuar e më i çmuar, vlera këto të cilat duhen trasuar e ruajtur me xheloz, dhe duhen kultivuar te brezat e rinj.

Atakimi i vlerave mbi të cilat është ngritur familja te ne, nuk është në të mirën tonë dhe të popullit tonë. Zoti në Kuranin fisnik na urdhëron ta ruajmë familjen duke na thënë: *"O ju besimtarë ruani veten dhe familjet tuaja."* (Tahrir, 6).

Po ashtu, e kemi obligim që ta ruajmë e ta ngremë vendin tonë aty ku e meriton ai.

Ka dashtë Zoti, që tash e sa vite vendi ynë është i lirë e i pavarur, mirëpo është obligim yni që vendin tonë ta ndërtojmë e ta bëjmë me perspektivë, një vend ku jetohej me dinjitet, ku fëmijët tanë të rriten të sigurt e të marrin edukim e arsimim cilësor, një vend ku sigurojmë vende pune e jetesë të dinjitetshme për bijtë dhe bijat tona.

Dikur lirinë e vendit e kishim ide e projekt, ndërsa tani falë sakrificës shekullore të popullit, tash e sa kohë shtetin tonë e

kemi realitet, por, si qytetarë të këtij vendi, e kemi obligim që ta bëjmë më të mirën për vendin tonë, që ta bëjmë atë të jetueshëm për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Braktisja e vendit nuk është zgjidhje e duhur, sidomos nga të rinjtë dhe ekspertët tanë. Jeta në këtë botë nuk ka për qëllim kryesor e mision vetëm anën materiale. Dashtë Zoti që vendi ynë, me angazhimin tonë, të bëhet vend ku jetohej e punohet me dinjitet.

Vendi ynë merr peshë e kuptim, vetëm me bijtë e bijat e saj atëherë kur i kemi shtëpitë tona plot, me bijë e bija, nipa e mbesa, kur çerdhet e shkollat i kemi në funksion të edukimit e mësimi, se në të kundërtën i mbetemi borxh vendit dhe brezave që vijnë, pra e kemi obligim ta duam e ta ndërtojmë vendin tonë.

Vëllezër e motra!

Festa e Fitër Bajramit kultivon në formën më të mirë ndjesinë e mirëkuptimit, tolerancës, harmonisë, respektit e bujarisë, vlera këto që fisnikërojnë individin e shoqërinë.

Ne, sot ne kemi festë dhe bashkërisht do të shijojmë festën e madhe të Fitër Bajramit.

Ju ftoj të festojmë me të afërmit, me të dashurit e miqtë tanë, që të shijojmë ëmbëlsinë e kësaj feste në harmoni të plotë pranë njëri-tjetrit.

Në fund, duke lutur Zotin që ta ketë pranuar agjërimin, lutjet, ibadetet e punët tona të mira, të gjithëve ju uroj festën e Fitër Bajramit, duke ju dëshiruar shëndet e mbarësi, kudo ku jeni, ju përgëzoj e ju uroj të gjithëve festën e Fitër Bajramit!

Me hair e me të mira na qoftë Fitër Bajrami!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. TËRNAVA

Prishtinë, 21 prill 2023

Ligjërata tematike e mbajtur me rastin e manifestimit të Fitër Bajramit në Xhaminë e Madhe në Prishtinë

Ndikimi dhe porositë e Ramazanit

Dr. Muhamed ef. Stublla

Falënderimet i takojnë Zotit të Gjithësisë, i Cili krijoi çdo gjë nga asgjëja. Allahu është Një, i Vetmi, pa fillim dhe pa mbarim. Atij nuk i ngjanë asgjë, është i pa të meta, nuk ka nevojë për asgjë, dhe të gjithë kanë nevojë për Të. Salavatet dhe përshëndetjet tona ia dedikojmë të Dërguarit të Allahut, vulës së pejgamberëve, Muhamed Mustafasë a.s., i cili ishte shëmbëlltyra më e mirë e praktikimit të mesazhit hyjnor në Tokë. Lutjet tona shkojnë për familjen e tij të ndershme, e paqja e rahmeti i Zotit qoftë për shokët e tij, të cilët me singjeritetin, përkushtimin dhe sakrificën e tyre arritën kënaqësinë e tij. Ata sakrifkuan pasurinë, vendin dhe veten e tyre, me një qëllim të vetëm, arritjen e kënaqësisë së Allahut, i Cili iu dha myzhde duke ju thënë: *“Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Zotin e tyre.”* (El Bejneh 8).

Po pra, kur pason sunetin e Pejgamberit a.s. dhe ndjek udhëzimin e Zotit, respektivisht arrin kënaqësinë e Tij, të tillin e do Zoti, dhe kënd e do Zoti, do ta duan edhe krijesat e Tij. Nga kjo themi se ai që e do dhe e pason Pejgamberin, familjen dhe shokët e tij, atë e do dhe e mëshiron Zoti xh.sh.. Për këtë, Ai thotë: *“Thuaj (o Muhamed) nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet, Allahu është falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”*

Gjenerata që e donin më së shumti Pejgamberin a.s., familjen dhe shokët e tij padyshim se ishin tabinët, ata që jetuan e mësuan nga familja dhe shokët e tij, të cilët edukatën dhe diturinë islame e formësuan në rregulla e parime, të cilat i shkruan nxënësit e tyre duke qenë nën mbikëqyrjen e nxënësve të sahabëve. Përmes kësaj forme është ruajtur apo garantuar vazhdueshmëria e fesë, është ruajtur feja po në versionin autentik të shpalljes. Me përmbylljen e misionit të pejgamberëve, masazhet hyjnore morën formën shkencore, përmes shkollave akaidologjike dhe instituteve juridike, që në terminologjinë fetare i quajmë medhhebe. Saktësia e besimit dhe praktikimit të Islamit është e ndërlidhur me

saktësinë e metodës studiuese dhe saktësinë e rrugës së burimeve argumentuese, dhe nga kjo themi se, përderisa është ruajtur saktësia e Islamit, kjo tregon se trashëgimia shkencore islame e inkorporuar komfor rrethanave të shoqërive, tregon fuqinë dhe saktësinë e Islamit. Andaj nëse nuk trasohet kjo rrugë, atëherë kemi devijuar nga shkenca, respektivisht nga Islami real. Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, ata shpjeguan Islamin ashtu siç e kishte plasuar Muhamedi a.s., disa prej tyre ishin më të dalluar për devotshmëri, profesionalizëm dhe angazhim në mësimin e gjeneratave, ku dhe formësuan institutet shkencore. Ndër personalitetet qendrore të këtyre instituteve shkencore pa dyshim se janë katër imamët, me emrat e të cilëve u emërtuan



ato institute apo medhhebe, gjersa ne jemi përcaktuar të praktikojmë Islamin përmes institutit, medhhebit të imam El Adhamit, Ebu Hanife en Numanit, i cili medhheb kishte marrë formën e duhur të shkencës, teksa disa nga sahabët ende ishin në jetë. Kjo tregon se fryma e shpalljes ende ishte e freskët dhe ndikuese e drejtpërdrejt në qëndrimet e këtij instituti për shkak të afërsisë së tij me Pejgamberin a.s..

I lutemi Mëshiruesit, që t'i gradojë këta dijetarë me gradën e pejgamberëve, por edhe të gjithë ata që pasuan dhe pasojnë ata në zhvillimin e diturisë islame mbi bazat e shëndosha të këtyre parimeve.

Të dashur besimtarë,

Vëllezër e motra!

Dje, agjërimi ishte obligim, sot ai është i ndaluar. Ditët për nga përmbajtja janë të ngjashme, por jo edhe për nga vlera, rëndësia dhe qëllimi i tyre. Ky ndryshim vjen si rezultat i përcaktimit dhe vlerës që i ka dhënë vetë Krijuesi. Çdo krijesë, kohë, vend, apo objekt, ka vlerë aq sa i ka dhënë vlerë Zoti i Gjithësisë. Këtë muaj edhe më të veçantë e bëjnë ngjarjet që ndodhën në të, përderisa shpallja vazhdon, e të cilat ngjarje u kurorëzuan me fitore të jashtëzakonshme, dhe dhanë shkëndijat e shpresës dhe sigurinë e ekzistencës. Njeriu ndjehet i gëzuar dhe i lumtur atëherë kur arrin të jetësojë një qëllim, punë apo detyrë. Mbështetur në këtë premisë, besimtarët, respektivisht agjëruarit me shumë të drejtë sot

ndjehen të gëzuar dhe festojnë. Ishte nevojë imediate për shoqëritë që të ketë festa që gëzojnë tërë komunitetin, dhe kjo pasi që sukcesi i përfundimit të agjërimit ishte më shumë se sa individual. Ky gëzim është i natyrshëm, andaj duhet të jetë edhe hyjnor. Muhamedi a.s. ka thënë: “Agjëruari gëzohet në dy raste, atëherë kur e përfundon agjërimin dhe kur do të takojë Zotin e tij.”¹

Sot nuk gëzohemi vetëm për përfundimin e ditëve respektive të agjërimit, por për agjërimin e një muaji të tërë, andaj e drejta për gëzim është më e veçantë! Ky gëzim shpresojmë të marrë formën ideale atëherë kur do ta takojmë Zotin xh.sh. dhe të shpërblejë çdo agjëruar ashtu siç Furnizuesi dëshiron. Sot është e kërkuar shfaqja e gëzimit, përmes përdorimit të të mirave që ne i posedojmë nga Furnizuesi. Madhështia e kësaj dite përmes gëzimit konsiderohet adhurimi më i veçantë në të.

Të dashur besimtarë,

Shenjtëria dhe shpërblimi i agjërimit janë të jashtëzakonshme për ju, për shkak të nënshtrueshmërisë tuaj të veçantë ndaj Krijuesit, ndërsa ushqimet dhe pijet apo abstenimi nga to, komfor mësimave hyjnore tregojnë kërkesën, vullnetin dhe vendosmërinë tuaj të sinqertë për përfitimin e këtyre begative. Llogaritur në këtë, Zoti dëshiron që besimtari të jetojë një jetë të menaxhuar sipas mësimave



të Tij, dhe jeta e tij do të jetë në kulminacion të shpërblimit, pavarësisht a është duke ngrënë apo agjëruar.

Ndoshta përfitimi më thelbësor nga agjërimi shfaqet përmes mesazhit se, zhvillimi i njeriut duhet të kalojë në faza të ndryshme të trajnimeve të vazhdueshme, por edhe të atyre sezonale, të cilat nganjëherë janë më të ngjeshura. Përmes trajnimeve të tilla, ndryshon rutina e veprimit, ku vazhdimi në atë që është obligim do të jetë më i sigurt dhe më i lehtë. Përgatitjet e nevojshme në kohë të duhur, janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të kënaqshme në angazhimet tona, saktësisht sikurse studenti i cili duhet që në vazhdimësi të studiojë e të lexojë, por në kohën e provimeve, ai duhet të shkëlqejë, në mënyrë që të arrij rezultatet që dëshiron. Andaj Muhamedi a.s. kishte thirrur që muaji shaban, i cili i paraprin Ramazanit, të jetë muaj në të cilin shtohen veprat e mira, sa që, ai nuk kishte agjëruar në ndonjë muaj vullnetar më shumë sesa që agjëronte në muajin i cili i paraprinte Ramazanit, në mënyrë që të jetë më i përgatitur shpirtërisht dhe fizikisht për agjërimin e Ramazanit, dhe kështu agjërimi i tij të jetë sa më i avancuar që të arrijë qëllimin e rezultateve të përcaktuara nga Krijuesi. Kjo do të shërbente që shfrytëzimi i adhurimeve obligative të jetë në nivel sa më të lartë, njëkohësisht edhe ndikimi i tij të jetë sa më i prekshëm në besimin dhe jetën e besimtarëve. Nga kjo konkludojmë se njeriu duhet të pajiset me besim e adhurim që të përballojë sfidat e jetës duke qenë i mbështetur tek Allahu xh.sh., mbi të gjitha të përgatitet për botën tjetër, nga e cila nuk mund të përfitojmë mundësi tjetër. Përmes Ramazanit, Zoti xh.sh. dëshiron që besimtarëve t'ju instalojë sistemin e veprimit në formë të organizuar, dhe kjo të jetë e unifikuar komfor institucioneve ku veproni. Kështu Allahu do të jetë i kënaqur me ne, pasi që Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mbështetja e Allahut është për bashkësinë.”² Në këtë mënyrë do të arrihet harmonia shoqërore. Mbështetur në këtë, Muhamedi a.s. ishte ai që shpallte fillimin dhe përfundimin e Ramazanit. Ai nuk ua kishte lënë në diskrecion shokëve të tij as caktimin e fillimit dhe përfundimit të agjërit të ditëve respektive, por kishte angazhuar disa nga sahabët që të lajmëronin për kohët e caktuara përmes ezanit. Rëndësia e unifikimit tonë shoqëror është emergjencë kolektive, ndër rastet më mbresëlënëse të unifikimit shoqëror në jetën e sahabëve, ishte organizimi i teravive pas një imami, pasi që deri në atë moment faleshin në grupe të ndara. E veçanta e kësaj ngjarje shfaqet në konsensusin e sahabëve për një organizim të tillë. Kjo tregon që autoritetet profesionale dhe kompetente kanë mundësi të marrin vendime për unifikimin dhe organizimin e shoqërisë edhe nëse ato çështje nuk gjenden në mënyrë decitive në tekstet bazë, por duke mos u

atakuar asnjëherë me parimet islame. Përmes Ramazanit, neve na u shtua ndjenja e përgjegjësisë në raport me Krijuesin, ku jo vetëm që u larguam nga të ndaluarat, por u privuam edhe nga të lejuarat në baza ditore për një muaj të tërë. Mesazhi i së cilës sakrificë, tregon se përderisa beson në ndihmën dhe mbikëqyrjen e Zotit, jo vetëm që mundesh me i larguar barrierat apo pengesat e zakonshme, por mund të sfidosh atë që dikush nuk mund ta paramendoj. Por njëkohësisht, ky mesazh është edhe për ata të cilët arsyetojnë mos përkushtimin e tyre ndaj Zotit, pasi që, nëse gjatë Ramazanit je stopuar nga të lejuarat, mundësia e juaj që të largoheni nga të ndaluarat është e padiskutueshme. Ndër synimet e agjërit sigurisht se është edhe rregullimi i raporteve të njerëzve në rrafshin horizontal. Agjërimi ngrit ambiciet e shpërblimit dhe shton dëshirën e sakrificës për të arritur kënaqësinë e Allahut, andaj Pejgamberi a.s., ndër të tjera për agjëruarit kishte porositur: “Kur dikush prej jush agjëron, le të mos flasë fjalë të ndyta, as mos të bërtas, e nëse dikush e shan, apo e ofendon, le t'i thotë: unë jam agjërushëm.”³

Përmes agjërit synohet menaxhimi dhe kontrollimi i emocioneve, respektivisht dorëzimi dhe durimi absolut i besimtarit që të arrij shpërblimet sublime, dhe njëkohësisht të përgatit një individ, dhe kështu përmes tij një shoqëri paqësore, e cila aspirojnë më të mirën për të tjerët dhe asnjëherë duke mos synuar hakmarrjen. Ndërsa, inicimi i ofendimeve apo ngatërimeve nga besimtari nuk duhet të jetë alternativë ekzistuese.

Të dashur besimtarë,

Agjërimi nuk është vështirësi, përkundrazi vështirësitë mbesin minore nëse vlerësojmë mëshirën dhe lehtësitë e ofertave të shumta shpërblyese që Zoti kishte ofruar për besimtarët, siç është falja e namazit të teravive me xhematë duke filluar dhe përfunduar me imam konsiderohej shpërblimi sikurse të jeni falur tërë natën, mundësi që ofron vetëm bujaria e pakufizuar e Allahut xh.sh.. Por jo vetëm kaq, në këtë muaj, gjendej edhe Nata e Kadrit, në të cilën zbriti Kurani, i cili është fjalë e Zotit, dritë, udhëzim dhe kornizë e veprimtarisë së mbarë njerëzimit, që në formë bashkëbisedimi e këshillon njeriun, andaj zbritja e Kuranit në këtë natë, ia shtoi vlerën për më shumë se një mijë muaj. Imam El Kendehlevi ka thënë: “Saktësia e adhurimeve në formën dhe kohën e caktuar, është më me vlerë sesa numri i atyre adhurimeve jashtë atyre kohëve. Andaj shpërblimet e ofertave të caktuara në këtë muaj ngritin vlerën e tij.” Kjo duhet që të na vetëdijësojë, që jetën dhe kohën të cilën e posedojmë, ta shfrytëzojmë para se kjo kohë të kalojë dhe mundësia të

përfundojë. Ramazani, jo vetëm që reflektoi në jetën e besimtarëve në aspektin e shpërblimit, por ai ndikoi pozitivisht edhe në aspektin ekonomik dhe social, kjo pasi që njeriu është i krijuar nga komponentët shpirtëror dhe material. Përveç adhurimeve të cilat janë rezultat i besimit dhe bindjes, njeriu ka nevojë në vazhdimësi edhe për plotësimin e aspektit material. Plotësimin e këtyre nevojave të shoqërisë, Zoti xh.sh. nuk e kishte lënë në vullnetin dhe mëshirën e njerëzve. Ai me bujarinë e tij e bëri obligim ndihmën ndaj të tjerëve përmes zekatit, dhurimit të një pjese të pasurisë për ata që kanë nevojë. Por jo vetëm kaq, Zoti xh.sh. plotësimin dhe pastrimin e agjërimit, e kushtëzoi me ndihmën ndaj nevojtarëve. Lëmosha ndikon në pastrimin e agjërimit dhe plotësimin e shpërblimit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Lëmosha i shuan mëkatet, ashtu sikurse e shuan ujë zjarrin.”⁴ Përmes një vlere simbolike, përsoset agjërimi dhe njëkohësisht ndihmon shoqërinë që në ditën e Bajramit, aspekti material të mos jetë arsye për mos gëzimin e besimtarëve. Të gjitha udhëzimet hyjnore na orientojnë që të kemi një shoqëri të lumtur, veçanërisht në ditët e festave, konkretisht në festat e bajrameve.

Të nderuar besimtarë,

Vlerën dhe pozitën e Ramazanit, e ngritin dhe e bëjnë të paharrueshme edhe ngjarjet e shumta të cilat ndodhen në këtë muaj. Historia na tregon se në këtë muaj, besimtarët, filluan të mbrojnë apo edhe të kthejnë pasurinë e tyre të uzurpuar padrejtësisht, edhe pse kjo ju imponoi ballafaqimin ushtarak në fushëbetejën e Bedrit. Më pastaj ata gradualisht qëndrimet e tyre filluan t’i ndërtojnë mbi parimin e reciprocitetit. Ky angazhim për avancim, i cili kërkonte, guxim, trimëri, dhe vendosmëri në mënyrë të vazhdueshme, duke mos u dëshpëruar asnjëherë, u kurorëzua me fitoren e çlirimit të atdheut, vendlindjes së tyre, vendit më të dashur për ata dhe besimtarët, çlirimin e Mekës. Andaj, përmes Ramazanit, besimtari mësoi se si të jetë i dashur i Krijuesit, dobishëm dhe produktiv për krijesat, qëllime këto që i përmban agjërimi, dhe se kjo përgatitje shpirtërore dhe dashuri shoqërore ndërmjet qytetarëve, duhet të shërbejë në mbrojtje dhe zhvillim kombëtar e shtetëror të shtetit tonë, saktësisht, si vepruan bijtë dhe bijat e këtij vendi për mbrojtjen e atdheut. Edhe pse në shumë etapa të rezistencës ndaj okupatorit, shumë nga qytetarët e vendit tonë ishin agjërueshëm, armiku nuk kurseu t’i sulmonte edhe në Ramazan, sa që te disa nga ata heronj të cilët ishin agjërueshëm, u gjenden hurma për iftar. Këta heronj iftarin e tyre e bënë te Zoti i Gjithësisë, duke rënë dëshmorë, për të mos të vdekur kurrë. Shpërblimin e sakrificës së këtyre dëshmorëve do ta ketë edhe çdo person që me qenien,



vendosmërinë dhe sinqeritetin e tyre ishin së bashku me ata dëshmorë për mbrojtjen e atdheut. Qëllimi i agjërimit ishte përcaktuar nga Allahu, i cili ajetin përmbyllës të agjërimit e kishte përfunduar me shprehjen: “...Me qëllim që të bëheni të devotshëm.” (El Bekare, 183). Andaj nga ne kërkohet që përfundimi i Ramazanit të na gjejë të devotshëm. Zoti xh.sh. në Kuran thotë: “Ky është Libër në të cilin nuk ka dyshim, Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (El Bekare, 2).

Njeriu do të gjejë qetësi, kënaqësi dhe siguri aq sa i beson dhe i mbështet Krijuesit. Prandaj, që të keni një jetë të lumtur dhe një të ardhme të sigurt, besoni sinqerisht Zotin Një, duke u angazhuar në adhurimin e tij, sepse kështu do t’ju mëshirojë dhe lumturojë Furnizuesi i Gjithësisë.

Sot duhet të jetë ditë feste dhe urimi, të tejkalohen ngatërresat e hidhërimet, ta falim njëri-tjetrin, t’i vizitojmë e bashkojmë familjet tona. Kush jeton jetën duke qenë i kujdesshëm dhe i angazhuar si në Ramazan, fundin dhe botën tjetër do ta ketë Bajram.

- 1 Muslim, ibën el Haxhaxh en Nejsaburi, *Sahih Muslim*, (Dar Ihja et Turath el Arabij) vëll.2, fq. 705, nr. 1151.
- 2 Et Tirmidhi, Ebu Isa, Suneni i Tirmidhiut, (Dar el Garb el Islami, Bujrut) vëll. 4, faq.36, nr. 2166.
- 3 Sahih El Buhari, vëll.3, faq.62, nr. 4091.
- 4 Hanbel, Ahmed bin, *Musnedi i Ahmed ibën Hanbelit*, (Bejrut, Mesesetu er Rrisaleh 2001) vëll.52, fq.524. nr. 15284. Hadithi i saktë.

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Fet'h (4)

GJURMËT E PAQES SË HUDEJBIJES PËR BESIMTARËT, MYNAFIKËT DHE IDHUJTARËT

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ لِيَرْتَدَّوْا إِيمَانًا مَعَ إِيْمَانِهِمْ وَلِلَّهِ جُنُودُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٤﴾ لِيَدْخُلَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَيُكَفَّرُ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَكَانَ ذَلِكَ عِنْدَ اللَّهِ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٥﴾ وَيُعَذِّبُ الْمُنَافِقِينَ وَالْمُنَافِقَاتِ وَالْمُشْرِكِينَ وَالْمُشْرِكَاتِ الظَّانِّينَ بِاللَّهِ ظُنَّ السُّوءِ عَلَيْهِمْ دَائِرَةُ السُّوءِ وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَلَعَنَهُمْ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَهَنَّمَ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿٦﴾ وَلِلَّهِ جُنُودُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَكَانَ اللَّهُ غَنِيًّا حَكِيمًا ﴿٧﴾

“Është (Allahu) Ai, që zbriti qetësinë (prehen) në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë. Ai (Allahu) ka për t’i futur besimtarët dhe besimtare të kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përjetësisht dhe Ai do t’ua falë gjynahet e tyre. Kjo, tek Allahu, është një fitore e madhe. Dhe Ai (Allahu) do t’i ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtare, që kanë mendim të keq për Allahun. Ata do të rrethohen nga e keqja. Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe ua ka përgatitur Xhehenemin. Eh, sa vend i shëmtuar është ai. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë! - (El-Fet’h, 4-7).

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT (5)

- Transmetojnë Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Hakimi dhe Ibn Merduveji nga Enesi r.a. të ketë thënë: “I ka zbritur Pejgamberit a.s. ajeti: “që Allahu të t’i falë gabimet e mëparshme dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Vet ndaj teje dhe të të udhëzojë në rrugë të drejtë” – (El-Feth, 2), në të kthyer nga Hudejbija, ndërsa i Dërguari i Allahut në lidhje me këtë pati thënë: “Më ka zbritur një ajet, që për mua është më i dashur se krejt çka ka në Tokë”¹, Kur i Dërguari i Allahut ua lexoi sahabëve këtë ajet, ata thanë: “I lumi ti (të urojmë) për këtë o i Dërguari i Allahut. Allahu e paska sqaruar se çfarë do të veprojë me ty, po a thua çfarë do të veprojë me neve?”, me ç’rast zbriti ajeti: “Ai (Allahu) ka për t’i futur besimtarët dhe besimtare në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përjetësisht dhe Ai do t’ua falë gjynahet e tyre. Kjo, tek Allahu, është një fitore e madhe.”²



LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, pamë shumë prej mirësive me të cilat u bekua i Dërguari i Allahut, siç ishte fitorja e madhe diplomatike me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Hudejbijes, pastaj nderimi i Muhamedit a.s. nga ana e Allahut me faljen e mëkateve-lëshimeve si të kaluarat, ashtu edhe të ardhmet, dhe plotësimi i mirësive të tjera, duke i dhënë forcë dhe ndihmë për fitore e ngadhënjim ndaj armiqve, tash në këto ajete shohim mirësitë që Allahu xh.sh. ua dhuroi besimtarëve, duke zbritur qetësi në zemrat e tyre, duke ua forcuar imanin dhe njëkohësisht duke iu premtuar atyre shpërblimet e Xhenetit, si meritë për besnikërinë dhe imanin e palëkundur në Zotin Fuqiplotë. Në këtë grup ajetesh, po ashtu flitet edhe për hipokritët dhe për idhujtarët, dhe dënimin të cilin ata do ta përfetojnë për shkak të dyfytërisë dhe idhujtarisë së tyre.

KOMENT:

4. Është (Allahu) Ai, që zbriti qetësinë (prehjen) në zemrat e besimtarëve, për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.

Allahu i Madhërishëm nga mëshira e Tij, në çastet më kritike për besimtarët, kur në Hudejbije po zhvilloheshin negociata për një marrëveshje paqësore në mes myslimanëve dhe idhujtarëve, zbriti qetësi dhe prehje shpirtërore në zemrat e myslimanëve, për t'ua forcuar edhe më shumë imanin e tyre të palëkundur. Sahabët e kishin dëshmuar me vepra stoicizmin e tyre kur iu besatuan të Dërguarit të Allahut në atë që sot njihet si "Bej'atu-r-Rridvan" se do të luftonin përkrah tij deri në fitore. Për ta më nuk kishte alternativa të tjera, ose do të ngadhënjenin duke çliruar Mekën, ose do të vdisnin, e ta arrinin gradën e shehidllëkut.

Fjala "Es-Sekinetu" - që nënkupton qetësinë, prehjen shpirtërore, sigurinë, mëshirën, nderimin dhe forcimin e besimtarëve për fitore, është përmendur gjithsej gjashtë herë në Kuran; një herë në suren El-Bekare, ajeti 248, dy herë në suren Et-Tevbe, ajetet 26 dhe 40, dhe madje tri herë në këtë sure, El-Fet'h, ajeti, 4, ajeti 18 dhe ajeti 26.

Të përmendurit e qetësisë shpirtërore tri herë vetëm në këtë sure, pa dyshim që bart me vete një urtësi të madhe hyjnore. Myslmanëve, kjo qetësi shpirtërore u erdhi pikërisht në kohën e duhur, kur ata kishin më së tepërmi nevojë që t'u

"Imani as nuk shtohet me kryerjen e obligimeve e as nuk pakësohet me mëkatim, sepse në pyetje është vërtetimi (tasdiku-besimi) me zemër në të cilin nuk ka mangësi e as shtesë.

Imam Ebu Muin
en-Nesefiu

ngrihej morali luftarak, dhe që i Madhërishmi t'ua qetësonte zemrat e tyre të thyera, pasi që u ndaluan dhe u penguan nga vizita e Shtëpisë së shenjtë, për ta kryer umren.³

Ata, pa qenë të vetëdijshtëm se Marrëveshja e Hudejbijes, në fakt ishte një fitore madhështore për ta, në fillim ishin demoralizuar dhe nuk po mund të pajtoheshin se po ktheheshin në Medinë, pa e kryer umren dhe pa i prerë therë kurbanet e tyre. Vetëm, pasi Allahu kishte zbritur qetësi në zemrat e tyre, ata e kishin kuptuar largpamësinë e veprimeve të Pejgamberit a.s., në të cilin dimension ata nuk kishin qasje.

Kur jemi te pjesa e ajetit: "për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën", Allahu xh.sh. na tregon se pasi që në zemrat e besimtarëve zbriti qetësinë, atyre iu shtua apo forcua edhe më tepër bindja dhe besimi, se krejt atë çka ua ka premtuar Allahu, do të realizohet, pa kurrfarë dyshimi. Kjo qetësi shpirtërore, bëri që ata të shtojnë edhe më shumë veprat e mira, të cilat i afrojnë tek Allahu i Gjithë-mshirshëm.

Kurse sa i përket çështjes nëse imani shtohet dhe pakësohet, dijetarët e shkollave akaidologjike kanë dhënë interpretime të ndryshme. Një pjesë e dijetarëve, që ajeteve kuranore iu qasen më sipërfaqësisht nga aspekti etimologjik, mendojnë se imani shtohet dhe pakësohet, duke u thirrur në shumë ajete kuranore si ky ajete, i 4-t, të cilin jemi duke e komentuar dhe të ngjashëm me të. Megjithatë, kolosët e Ehli Sunetit në këtë çështje akaidologjike, mendojnë pak më ndryshe. Imam Ebu Hanifeja në lidhje me këtë është shumë i prerë kur thotë: "Imani i banorëve të qiellit dhe të tokës as nuk shtohet e as nuk pakësohet. Besimtarët janë të barabartë në iman (besim të plotë dhe të prerë në Allahun) dhe tevhid (në deklarin e Njeshmërisë së Allahut). Ndërsa ata (mund të) kanë epërsi (ndryshim) në mes vete vetëm nga aspekti i veprave."⁴

Gjithashtu edhe Imam Maturidiu është i mendimit të Ebu Hanifes se në esencë, imani as nuk shtohet e as nuk pakësohet.⁵

Kolosi i madh i shkollës Maturidite, Imam Ebu Muin en-Nesefiu, pasi që i parafrazon mendimet e Ebu Hanifes dhe të Maturidiut, në lidhje me shtimin apo pakësimin e imanit thotë: "Imani as nuk shtohet me kryerjen e obligimeve e as nuk pakësohet me mëkatim, sepse në pyetje është vërtetimi (tasdiku-besimi) me zemër në të cilin nuk ka mangësi e as shtesë. Pra këtu kemi të bëjmë me vërtetim (tasdik) që nënkupton imanin-besimin, dhe me përgënjeshtrim (tekdhëb), që nënkupton kufrin-mosbesimin."⁶

Ajeti përfundon me fjalët: “Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë”.

Kjo nënkupton se çdo gjë në këtë ekzistencë është krijim i Tij, dhe çdo gjë vetëm Atij i nënshtrohet. Ushtritë e Allahut janë të shumta, e për to ne dimë shumë pak. Përveç engjëjve, xhinëve dhe njerëzve të zgjedhur, gjithashtu edhe stuhitë shkatërruese, uraganet, cunamit gjigantë, rrëshqitjet dhe dridhjet e Tokës, vullkanet, etj., që të gjitha këto fenomene natyrore hyjnë në sferën e këtij emërtimi, nëpërmjet të cilave, Allahu xh.sh. ka ndëshkuar popujt jobesimtarë. Myslimanët, disa herë gjatë betejave të tyre ushtarake kundër kufrit dhe mizorisë, kanë qenë të fuqizuar me ushtri të tilla të padukshme, si në luftën e Bedrit, në atë të Hunejn, dhe përgjatë shumë betejave të lavdishme nëpër shekuj. Allahu ua ka premtuar këtë ndihmë besimtarëve të sinqertë, përdërisa ata janë në luftë për lartësimin e Fjalës së Allahut, teksa thotë: “Është detyrim Yni të ndihmojmë besimtarët.” - (Er-Rrum, 47).

Kjo pjesë e ajetit bart një mesazh madhështor, se po të donte i Madhërishmi do ta ndihmonte të Dërguarin e Vet, duke i shkatërruar armiqtë e tij me ushtri të padukshme, por Ai dëshiroi diçka tjetër. Ai deshi që kjo fitore të vinte pikërisht nga këta njerëz të zgjedhur që u besatuan në Bej'atu-rr-Ridvan, për t'i futur në Xhenet e për t'i shpërblyer me mirësitë e Tij të pakufishme.⁷ S'ka dyshim se në këtë qëndron një urtësi e madhe, sepse Allahu xh.sh. e përfundon këtë ajet pikërisht me fjalët se Ai është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë në çdo veprim të Tij, teksa e drejton dhe e mbikëqyr tërë këtë ekzistencë madhështore.

5. Ai (Allahu) ka për t'i futur besimtarët dhe besimtare në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përjetësisht dhe Ai do t'ua falë gjynahet e tyre. Kjo, tek Allahu, është një fitore e madhe.

Ashtu siç pamë edhe nga shkakut e zbritjes së këtij ajeti, Allahu i Madhërishëm i nderoi edhe sahabët duke ua premtuar si shpërblim Xhenetin me të gjitha mirësitë dhe begatitë e tij, në të cilat begati do të qëndrojnë përjetësisht. Allahu për hir të imanit të tyre, do t'ua falë gjynahet, dhe kush e arrin këtë gradë, vërtet është më fatlumi në të dy botët, sepse kjo është një fitore e madhe.

Allahu xh.sh. i ka veçuar besimtarët dhe besimtare me lloj-lloj nderimesh në këtë dynja, por mbi të gjitha me shpërblime në Ahiret. Ai i zgjodhi këta njerëz, burra e gra, që ta bartnin nëpër shekuj dritën e Islamit, e cila do të qëndrojë si fanar i pa fikur deri në ditën e Kiametit. Në Kuran, në shumë vend, Allahu i ka përmendur besimtarët e këtij ymeti, sidomos përshkrimi në ajetin e 29, ajetin e fundit të kësaj sureje *El-Fet'h*, është i mahnitshëm: “Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të (sahabët), janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar mirësi prej Allahut dhe kënaqësinë e Tij. Në fytyrat e tyre shihen gjurmët e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Tevrat, ndërsa në Ungjill, ata përshkruhen si një farë e mbjellë që nxjerr filiz, e forcohet, pastaj trashet dhe qëndron e fortë në kërcellin e vet, duke i gëzuar kështu mbjellësit. Me ta, Ai ua shton mllëfin jobesimtarëve. Kurse atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh.”



Shpërblimi i besimtarëve me Xhenet, është diçka madhështore, sepse ata që u besatuan në Hudejbije, do të hyjnë triumfalisht në Xhenet, në cilësinë e muxhahidëve-luftëtarëve në rrugën e Allahut, e jo vetëm pse e merituan këtë me besim dhe me vepra të tjera të mira. Allahu tashmë ua ka falur atyre gabimet e kaluara dhe kjo për ta është fitorja dhe suksesi më i madh.⁸

6. Ai (Allahu) do t'i ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtarët, që kanë mendim të keq për Allahun. Ata do të rrethohen nga e keqja. Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe ua ka përgatitur Xhehenemin. Eh, sa vend i shëmtuar është ai.

Pasi që i Lartmadhërishti i përgëzoi besimtarët me Xhenete, të rrethuar me lumenj e kënaqësi të pafundme, duke qenë i kënaqur ndaj tyre, tash u kthehet dy grupeve, të cilat e kanë merituar hidhërimin e Allahut dhe ndëshkimin me zjarr të Xhehenemit. I Plotfuqishmi ajetin e fillon së pari me përmendjen e hipokritëve-mynafikëve, për të dhënë shenjë të qartë, se këta njerëz dyfityrësh, janë më të rrezikshëm dhe më të këqij sesa idhujtarët.⁹ Ky grup njerëzish, e të tillë do të ketë në çdo kohë, janë më të dëmshëm për ymetin islam, për vetë faktin se shtiren si myslimanë, e në fakt, veprojnë kundër tyre në fshehtësi. Për këtë arsye, Allahu xh.sh. na ka treguar se këta nesër do të jenë në humnerën më të thellë të Skëterrës: “Vërtet, hipokritët do të jenë në më të poshtmen thellësi të Zjarrit.” - (En-Nisa, 145).

Pas tyre vijnë idhujtarët, të cilët mohuan Njëshmërinë e Allahut duke besuar zota të rremë. Këta po ashtu do të jenë në Skëterrë, sepse nuk e ndoqën dritën e udhëzimit, në të cilën e thirri i Dërguari i Allahut. Një pjesë e madhe e këtyre të fundit parapëlqyen kufrin dhe errësirën, duke ia vulosur vetes fatin e zi, dhe do të jenë përjetësisht banorë të zjarrit.

Që të dyja këto grupe do të jenë të rrethuara nga e keqja, nga ajo e keqe të cilën ua mendonin dhe dëshironin besimtarëve, duke pasur mendime të këqija edhe ndaj Allahut. Për këtë arsye, Allahu është i hidhëruar në ta, i ka larguar nga mëshira e Tij, i ka mallkuar dhe do t'i ndëshkojë në Xhehenem, me vuajtje të njëpasnjëshme, përjetësisht.¹⁰

7. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë!

Ashtu si në ajetin e 4-t, edhe tash në këtë ajet, i Plotfuqishmi, tregon se vetëm të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës, në të cilat ushtri siç kemi theksuar më parë, bëjnë pjesë: engjëjt, njerëzit, xhinët, fenomenet natyrore, e shumë gjëra të tjera në të cilat dimensionet hyjnore nuk kemi qasje.

Dallimi i vetëm në mes dy ajeteve është pjesa e fundit e tyre. Në ajetin e 4-t ka ardhur: “Ve kane Allahu Alimen, Hakima - Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë”, kurse tash në fund të këtij ajeti, të 7-të, ka ardhur në formën: “Ve kane Allahu Azizen, Hakima - Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë”.

Arsyeja pse më parë u përmend emri i Allahut “I Gjithëdijshtëm” e tash në këtë ajet ka ardhur “I Plotfuqishëm” është se të Allahut janë ushtritë e mëshirës e edhe ato të ndëshkimit. Nga urtësia e Tij absolute, Ai kur flet për mëshirën që ka ndaj besimtarëve, thotë se është I Gjithëdijshtëm dhe i Urtë, ndërsa pasi që në ajetin e 6-të foli ashpër kundër hipokritëve dhe idhujtarëve duke i kërcënuar me zjarr të Xhehenemit, në të cilin do të jenë përjetësisht, tash në ajetin e 7-të, thotë se Ai është i Plotfuqishëm, për të na bërë më dije se ka fuqi dhe kompetencë absolute për të ndëshkuar keqbërësit dhe mohuesit e Njëshmërisë.¹¹

POROSIA E AJETEVE (4-7)

- Allahu xh.sh., përveç mirësive ndaj Pejgamberit a.s. që ia dhuroi pas Marrëveshjes së Hudejbijes, i përshkoi me mëshirën e Vet të pakufishme edhe sahabët që ishin të pranishëm në besatimin e “Bejatu-r-Rridvan”, duke zbritur qetësi e prehje shpirtërore në zemrat e tyre, duke ua forcuar edhe më bindjen dhe imanin, duke ua falur mëkatet dhe duke ua premtuar atyre Xhenetin si shpërblim.

- Edhe për idhujtarët dhe mynafikët, kjo Marrëveshje pati ndikim dhe impenjim të madh. Allahu për shkak të kufrit dhe hipokrizisë së tyre, do t'i ndëshkojë ata me zjarr të Xhehenemit. Është i zemëruar me ta, i ka larguar nga mëshira e Vet dhe i ka mallkuar.

- Përmendja e kësaj fraze: “Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës...” në ajetet 4 dhe 7, është një frikësim dhe kërcënim i hapët ndaj idhujtarëve dhe mynafikëve, se po të dojë Allahu i Madhërishtëm t'i shkatërronte ata, asgjë nuk do ta pengonte në realizimin e këtij kërcënimi hyjnor, sepse të Tij janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës, por nga mëshira e Tij, i lë ata edhe për një kohë në këtë jetë, derisa të vdesin e të dalin para Tij në llogarinë e fundit të tyre.

- vijon -

1 Imam Sujutiu, *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzuli*, f. 237.

2 Muhamed Muhamed Salim Muhajsin, *Fet'hu -r-Rrahman fi esbab nuzuli-l Kuran*, Kajro, 1999, f. 129-130.

3 Dr. Hasen Muhamed Baxhudeh, *Lemehat fi i'xhaz suretil Fet'h*, Mekë, 2001, f. 7.

4 Për më gjerësisht lidhur me këtë çështje shih: Dr. Orhan Bislimaj, *Akaidi Hanefij*, botuar nga Forumi i të Rinjve Muslimanë me seli në Sent Galen-Prizren, 2008, ff. 407-446.

5 Imam Maturidiu, *Te'vilatu-l Kurani*, Stamboll, 2007, vëll. XIV, f. 13. (redaktuar nga Muhamed Ma'sum Vanlioğlu dhe recensuar nga Dr. Bekir Topaloğlu).

6 Ebu Muin en-Nesefij, *Tebisiretu-l edil-leti fi Usuli-d-din*, Kajro, 2011, vëll. I, f. 112. (redaktuar nga dr. Muhamed el Enver Hamid Isa)

7 *Tefsir suretil Fet'h*, f. 57.

8 *Et-Tahriru ve-t-Tenviru*, vëll. XXVI, f. 152.

9 Muhamedin el Emin bin Abdullah el Arumij, *Hadaiku r-rrevhi ve-r-rejhan fi revabi ulumi-l Kuran*, Bejrut, 2001, vëll. XXVII, f. 236.

10 Mustafa el Mensuri, *El-Muktetafu min Ujuni-t-tefasir*, Damask-Bejrut, 1996, vëll. 5, f. 41. (Redaktuar nga Muhamed Ali es-Sabuni).

11 *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. XXVI, f. 483.

Ruajtja dhe kultivimi i asaj që e përvetësuam në Ramazan

Mr. Muharrem Bryma

Kujdesi i shtuar i besimtarit që të përvetësojë sa më shumë nga dhuntitë, mirësitë, shpërblimet e muajit Ramazan, doemos e bën atë edhe më të interesuar që t'i ruaj dhe t'i kultivojë ato. Dhuntitë e shumta që posedon muaji Ramazan dhe shpërblimet superiore që ka, na shtojnë dëshirën që t'i përgjigjemi Krijuesit në adhurimet e kërkuara, si namazi, agjërimi, leximi, dhikri etj.. Gjithashtu edhe angazhimi ynë në vepra të mira vullnetare ishte maksimal, vetëm e vetëm që të arrijmë qëllimet e agjërit, si devotshmëria, falja, mëshira etj.. Rritja e ndërgjegjësimit tonë fetar u bë vazhdimisht gjatë këtij muaji përmes zbatimit të programit hyjnor. Andaj shumë vepra të mira, si namazi, agjërimi, leximi, dhikri, iftaret, lutjet, vizitat, preciziteti, përmbajtja nga fjalët e kota, sinqeriteti, ndershmëria, toleranca, humaniteti, mirëkuptimi, respekti, e shumë të tjera janë bërë pjesë e pandashme e karakterit tonë. Preokupimi fillon këtu, si t'i ruajmë dhe t'i kultivojmë, e assesi të mos i anashkalojmë që të zhduken nga personaliteti ynë? A mund të ndihemi të motivuar edhe në muajt e tjerë jashtë Ramazanit? Ky preokupim për besimtarin shfaqet menjëherë pasi të kaloj muaji Ramazan.

Gjithsesi se për mirësitë dhe margaritarët që përvetësuam gjatë Ramazanit duhet të bëjmë përpjekje dhe përkushtim të vazhdueshëm që t'i ruajmë dhe atë duke filluar me:

LUTJE DREJTUAR TË LARTMADHËRISHMIT. Ngritja e duarve lart, drejtuar të Madhit Allah, pas përfundimit të veprimit të besimtarit është proces i njohur te të gjithë myslimanët. Me këtë i drejtohem Krijuesit për pranimin e veprave, adhurimeve e kontributeve. Ibrahim i a.s. ishte urdhëruar nga i Madhi Allah ta ndërtonte Qabënë së bashku me të birin e tij, Ismailin. Pasi ngritën themelet e saj, iu drejtuan Atij që i kishte urdhëruar, të Madhit Allah me lutjen e tyre, që përshkruhet në Kuran, ku Allahu thotë: “Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabesë

- luteshin): *Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!*” (El Bekare, 127). Ky ishte urdhër nga Vetë Krijuesi, drejtuar një të dërguari me vlera shumë të larta për të ndërtuar shtëpi të Zotit, në vendin më të shenjtë, dhe prapë pasi e përfundoi, ngriti duart dhe u lut me të birin e tij. Mësim ky për të gjithë ne!

Gjithashtu është e njohur çështja që transmetohet se gjeneratat e para, muajt të tërë pas Ramazanit luteshin që Allahu t'ua pranonte agjërimin dhe adhurimet e tjera të bëra gjatë Ramazanit. Ashtu sikur që luteshin muajt të tërë para Ramazanit që Allahu t'ua bëjë të mundur të arrijnë muajin Ramazan.

LARGIMI NGA VEPRAT E LIGA DHE TË KOTA. Veprat e liga mund të kenë pasoja të dëmshme për jetën dhe përkushtimin e besimtarit. Vepra e ligë mund të mos mjaftojë me kaq, mund të shkaktojë edhe humbje të asaj që është ndërtuar më herët, të dridh themele të fortifikuara, të luhatë njerëz që kanë qenë të njohur gjithnjë me përkushtim e fetarësi të mirëfilltë. Prandaj besimtari duhet të largohet sa më shumë nga veprat e liga dhe të kota. Se si mund të shkaktojë prishje imazhi, privim nga shpërblimet e mëherëshme e asgjësim të punëve të mira, këtë na e përshkruan me shembull figurativ Allahu në Kuranin fisnik ku thotë: “Mos u bëni si ajo (grua) që e prish tjerrin e saj pasi ta ketë dredhur fort...”, (El Nahl, 92).

Veprat e liga
mund të kenë
pasoja të
dëmshme për
jetën dhe
përkushtimin
e besimtarit.

VAZHDIMËSIA NË PASTËRTI DHE SHMANGIA NGA MËKATET. Ne shpresojmë se gjatë Ramazanit, i Madhi Allah të na ketë falur mëkatet e bëra më herët. Ebu Hurejre transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: “Kush agjëron Ramazanin me besim, duke qenë i bindur në shpërblimin e Zotit, atij i falen gabimet e kaluara.”¹ (Buhariu, 1901). Ndjesia e njeriut se posedon pak mëkate është madhështore. Kjo ndjesi e motivon besimtarin për një jetë më të qëndrueshme. Idealisht, një mëkat duhet të ndodhë vetëm një herë, sepse besimtari nuk duhet të bjerë në të njëjtin mëkat dy herë. Ai e di mirë se gabimet, mëkatet, janë pjesë normale dhe e pandashme e jetës, por, gjithashtu ai e di mundësinë që i Madhi Allah na e dhuroi në Ramazan, që ne ta pastrojmë dosjen tonë nga mëkatet. Kjo na bënë të kuptojmë se në bagazhin tonë të veprimeve ka më shumë vepra të mira dhe shumë më pak mëkate. Detyrimisht, kujdesi ynë duhet të shtohet më shumë, që dosja jonë të ketë sa më pak njolla. Ky sukses i arritur nga ne, i jep kuptim jetës, na bënë më produktiv dhe më vizionar përball sfidave dhe vështirësive.

Cilësitë dhe shprehjet e shumta që besimtari i përvetësoi nga Ramazani, kërkohet nga ai, jo vetëm t'i ruaj, por edhe të kultivojë ato. Gjithashtu ai duhet të angazhohet në përvetësimin edhe të mirësive të tjera që nuk i posedon e që i kanë hije dhe është i denjë për to. Mësimet islame shumë qartë na ndihmojnë e na e lehtësojnë këtë, andaj do t'i përmendim disa detaje në këtë aspekt:

AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË MUAJIT SHEVAL - Ebu Ejub el Ensariju transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: “Kush agjëron Ramazanin, e pastaj e përcjellë atë me gjashtë ditë tjera nga muaji sheval, konsiderohet sikur të ketë agjëruar tërë vitin.”² (Muslimi, 1164). Agjërimi i tërë muajit Ramazan, natyrisht i dhuron mirësi të shumta besimtarit, por këto mirësi të pafundme nuk duhet të ndërpriten. Allahu vazhdon t'i dhurojë besimtarit mundësi të shumta, ku përmes tyre mund të shtojë dhe kultivojë nga ato që posedon dhe nga ato që nuk posedon. Ky margaritar i mundësohet besimtarit me agjërim të vetëm gjashtë ditëve, gjatë këtij muaji, muajit sheval, pa e ngarkuar besimtarin që t'i agjërojë ato radhazi e pa ndërprerë, pra thjesht renditjen e tyre e ka lënë në dëshirën e tij.

VAZHDIMËSIA NË PUNË TË MIRA ËSHTË E LAVDËRUAR, jo e kundërta. Nga besimtari kërkohet që të jetë i angazhuar vazhdimisht me gjëra që i sjellin dobi atij si individ, por edhe familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. Veprimtaria e besimtarit duhet të jetë e qëndrueshme, vizionare, e planifikuar dhe e menaxhuar mirë, e jo euforike, e vrullshme, e periodike. Një besimtar i formuar drejt, në jetën dhe veprimtarinë e tij, nuk duhet të ketë angazhime maksimale për një kohë të caktuar sado e shkurtër apo e gjatë të jetë ajo, e pastaj një kohë tjetër me zero angazhime. Allahu në Kuranin fisnik thotë: “Prandaj kur ta kryesh (obligimin nga punët e ndryshme) përpiku fort (në adhurime)” (Inshirah, 6). Andaj edhe ne, pasi kaluam muajin Ramazan me angazhime maksimale, nuk duhet të lejojmë të zbresim në angazhime



minimale ose më keq. Fushëveprimi në punë të mira është aq i gjerë, saqë asnjë kategori njerëzore nuk privohet prej saj. Nuk është e thënë që punët tona të mira doemos duhet të jenë madhështore, mjaftojnë të mos jenë periodike, sezonale, por të jenë të vazhdueshme. E në lidhje me këtë, Muhamedi a.s. ka thënë: “Punët më të dashura tek Allahu, janë punët e vazhdueshme, edhe nëse janë të pakta.”³ (Buhariu, 6464).

TË JEMI FALËNDERUES - përjetimi i muajit përplot shpërblime, natyrisht se është dhunti nga i Madhi Allah për secilin nga ne që tashmë kemi hyrë në muajin sheval. Për këtë mundësi të dhuruar nga Allahu, ne duhet të jemi falënderues dhe mirënjohës përgjithmonë e në vazhdimësi, zaten ky është edhe objektivi e synimi fisnik i agjërimit. Përshtrohet në ajetet e agjërimit ku Allahu thotë: “...që të bëheni falënderues”, (El Bekare, 185). Besimtari duhet doemos të posedojë këtë cilësi në personalitetin e tij. Duhet të jemi falënderues e mirënjohës për të gjithë kontribuuesit, si në familje ashtu edhe në shoqëri, e të cilët kontribuuan e sakrifikuan për të mirën e njerëzimit. Duhet të jemi falënderues e mirënjohës për prindërit, mësuesit, intelektualët, e shumë të tjerë që pamë hair prej tyre. Gjithsesi falënderues e mirënjohës edhe për Absolutin, të Gjithëpushtetshmin, Allahun Mëshirëplotë, për çdo dhunti e mirësi që kemi prej Tij. E si të mos jemi të atillë? Allahu edhe Musait a.s. iu drejtua duke i thënë: “O Musa, Unë të gradova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit Tim. Merre atë që të dhashë dhe bëhu falënderues (mirënjohës).” (El Araf, 144). O Zoti im, Ti na ke dhënë shumë dhunti e mirësi, na bëjë nga ata që i ruajnë dhe i kultivojnë ato, e dhe na bëj nga ata që Ty të falënderojnë pandërprerë, dhe sa të kemi frymë e të jemi gjallë!

- 1 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Rijad, Dar Es-Selm, 1999), 306.
- 2 Muslim b. el-Haxhaxh el Kushejri, *Sahihul Muslim*, (Shkup, Aj-Graf Matbaa, 2022), III/536.
- 3 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Rijad, Dar Es-Selm, 1999), 1121.

Shtatë myftilerët më të shquar në mesin e sahabëve

Shejh Muhamed Hasenejn Makhluuf

Hz. Aliu r.a. transmeton se Resulullahu a.s. ka thënë: “Ai që jep fetva pa dije, e mallkojnë melekët e qiejve dhe të tokës.” (Ibën Asakir)

Myftilerët e periudhës së parë (të Islamit) e kuptuan rrezikun e postit, të cilin e kishin pranuar mbi supe dhe, ia dhanë hakun e tij në kulmin e ruajtjes dhe frikës së Allahut.

I pari person në Islam që e kreu këtë detyrë të ndershme ishte zotëria i të dërguarve, hz. Muhamedi a.s., i cili jepte fetva në emër të Allahut nëpërmjet shpalljes hyjnore, që konsiderohej argument dhe fjala e fundit.

Pas tij, ata që dhanë fetva ishin sahabët e tij, të cilët, siç i përshkruan Imam Ibnul-Kajim, ishin “ushtarët e Kuranit, të nënshtruarit e Mëshiruesit, më zemërbutët e ymetit, më të thelluarit në dituri, më të thjeshtit, më elokuentët, më besimtarët, më këshilluesit, më të afërtit me Allahun”, në mesin e të cilëve kishte prej atyre që jepnin shumë fetva, pak e mesatarisht.

Numri i atyre që kanë dhënë fetva në mesin e sahabëve, është rreth 130 e ca persona, burra e gra, Allahu qoftë razi me ta!

Ata që shquhen si fetvadhënësit më të mëdhenj, janë shtatë: Omer ibnul Hatabi, Ali ibën Ebi Talibi, Abdullah ibën Mesudi, Aisheja, Zejd ibën Thabiti, Abdullah ibën Abasi dhe Abdullah ibën Omeri, Allahu qoftë razi me ta!

Ebu Muhamed ibën Hazmi ka thënë: “Nga fetvatë e secilit prej tyre, mund të mblidhet një vëllim i madh!”

Ndërkohë, Imam Ebu Bekër ibën Muhamed ibën Musa ibën Jakub, i biri i prijësit të

besimtarëve El Memun (që ishte një nga imamët e fesë islame në dije e në hadith), kishte grumbulluar fetvatë e Ibni Abasit, në 20 libra!

E, për sa i përket hz. Omerit r.a., ai ishte personi për të cilin hz. Muhamedi a.s. kishte thënë: “Pasha Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, sa herë që shejtani të takon, teksa ti ecën në një rrugë, do të marrë një rrugë, që nuk është rruga jote!”

Ibni Mesudi r.a., në ditën që ndërroi jetë hz. Omeri, tha: “Them se Omeri iku me 9/10 e diturisë!” Dhe thoshte: “Sikur të vendoset dija e Omerit në njërën anë të peshores dhe dija e krejt botës në anën tjetër, dija e Omerit do të peshojë më rëndë!” Ndërsa Said ibnul-Musejjib thoshte: “Nuk e di se është dikush më i ditur, pas Resulullahut a.s., sesa Omeri!”

Ndërsa hz. Aliu r.a. është personi, të cilit Resulullahu a.s. i tha: “Ti je prej meje dhe unë jam prej teje!” Ndërsa hz. Omeri r.a. ka thënë: “Ndërroi jetë Resulullahu, duke qenë razi me të!”

Ai ishte një det i thellë në dituri. Ai ka dhënë fetva, që edhe sot merren për shembull, saqë njihet shprehja e tyre: “Çështje që nuk i jep drejtim Ebu Hasani?!” d.m.th, hz. Aliu r.a..

Ndërsa hz. Abdullah ibën Mesudi r.a., ishte i gjashti, ndër gjashtë myslimanët e parë! Ai ishte një ndër lexuesit më të shquar të Kuranit, prej atyre që e mësuan përmendësh Kuranin në kohën e Resulullahut a.s.. Ai emigroi në të dy hixhretet, sikurse u fal drejt të dyja kibleve. Ishte

Aisheja r.a., nëna e besimtarëve, ishte gruaja e Resulullahut a.s., prej të cilit mësoi shumë, saqë thuhet se $\frac{1}{4}$ e vendimeve islame janë transmetuar prej saj.



pjesëmarrës në Bedër, në Uhud dhe në Hudejbije. Ndërroi jetë në vitin 32 h. dhe u varros në Bakia. Xhenazen e tij e drejtoi hz. Othmani r.a..

Ndërsa Aisheja r.a., nëna e besimtarëve, ishte gruaja e Resulullahut a.s., prej të cilit mësoi shumë, saqë thuhet se $\frac{1}{4}$ e vendimeve islame janë transmetuar prej saj. Për të, dijetari i shtresës së tabiinëve, i quajtur Atâu, ka thënë: “Aisheja ishte fakihja më e madhe, më e ditura, më e shquara për mendimet e saj ndër njerëz!”

Ndërsa Urve ibni Zubejr r.a. ka thënë: “Nuk kam parë njeri më të ditur në çështjet e fikhut, në mjekësi dhe në poezi, sesa Aisheja!” Ndërsa Zuhriu thoshte: “Po të mblidhet dituria e Aishes, në krahasim me diturinë e krejt grave të Resulullahut a.s., dija e saj ishte më e dalluar!”

Ndërroi jetë në Medine, në një moshë rreth të shtatëdhjetave, natën e martë, më 17 Ramazan 58 h.. Xhenazen e saj e drejtoi Ebu Hurejra r.a..

Ndërsa Zejd ibën Thabit el Ensari r.a., konsiderohej më i dituri i sahabëve në çështjet e ndarjes së trashëgimisë (El-feraid), sikurse ishte njëri ndër hafëzët e Kuranit në kohën e Resulullahut a.s.. Ndërroi jetë në Medine, në vitin 45 h.. Xhenazen e tij e drejtoi Mervan ibnul-Hakem.

Ndërsa Abdullah ibën Abasi r.a., ishte personi, të cilin Resulullahu a.s. e quajti: “Terxhumani i Kuranit”, d.m.th. përkthyesi dhe komentuesi i Kuranit. Për të ishte lutur: “O Allah, mësoja urtësinë, o Allah, bëje të ditur në fe dhe mësoja komentimin e Kuranit!”

Ai lindi tre vjet para hixhretit. Për të, hz. Omeri r.a. thoshte: “I riu ndër të moshuar, ka një gjuhë që veç pyet, një zemër që veç kupton!”

Ndërsa Tavusi, prej shtresës së tabiinëve, ka thënë: “Kam parë pesëdhjetë sahabë, që kur konsultoheshin me Ibni Abasin dhe e kundërshtonin, ai këmbëngulte me ta, derisa përfundonin te mendimi i tij!”

Ndërsa Mervani thoshte: “Kur e shihja Ibën Abasin, ishte më i bukuri ndër njerëz, kur fliste, më elokuenti dhe, kur komunikonte, më i dituri ndër ta!”

Ndërroi jetë në Taif, në moshën 91 vjeç, në vitin 68 h.. Xhenazen e tij e drejtoi Muhamed ibnul-Hanefije r.a..

Ndërsa Abdullah ibni Omeri r.a., ishte dijetar prej dijetarëve të shquar të Islamit. Ai ishte imam në asketizëm, i ruajtur dhe ndjekës i gjurmëve të Resulullahut a.s.. Emigroi drejt Medinës me babanë e tij, kur ishte 10 vjeç. Pas Bedrit dhe Uhudit, ai ishte pjesëmarrës në të gjitha betejat. Ishte 15 vjeç, kur mori pjesë në betejën e Hendekut. Dijetar, muxhtehid, respektues i përpiktë i traditës profetike, i distancuar nga risitë, këshillues i ymetit. Kur diçka nga pasuria e tij i pëlqente, e jepte sadaka. Fare pak flinte natën, teksa pjesën tjetër e kalonte në adhurim. Resulullahu a.s. e kishte përshekruar në këtë mënyrë: “Ai është një njeri i mirë!”

Jetoi 86 vjet dhe dha fetva për 60 vite. Ndërroi jetë në fillim të vitit 73 h., në kohën e Haxhaxh ibën Jusuf Thekafiut.

** Nga vëllimi i parë me fetva, i dijetarit të shquar, (dy herë Myfti i Egjiptit), Shejh Muhamed Hasenejn Makhluf (1890-1990)*

*Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Muhamed B. Sytari*

Të shpallurit e një personi si jobesimtar (kafir)

Mufti Muhamed Teki Usmani

Ishte pothuaj fundi i rebiul evelit të vitit 1427 h., që korrespondon me prillin e vitit 2006, kur unë pranova një letër personale nga ekselencia e tij, princi Gazi bin Muhamed, lajmëtar personal dhe këshilltar special i Lartësisë së tij, Mbretit të Mbretërisë Hashimite të Jordanisë, në të cilën m'i kishte parashtruar disa pyetje në lidhje me tekfirin (të shpallurit e dikujt si jobesimtar). Unë iu dhashë përgjigje atyre pyetjeve në disa detaje, të cilat ekselencia e tij, Princi Gazi, i publikoi në një libër, si dhe në internet. Ato pyetje dhe përgjigje tani do të publikohen edhe më poshtë, duke shpresuar që të përfitojnë sa më shumë njerëz.

LETRA E PRINCIT GAZI BIN MUHAMED

Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ju

I lutemi Allahut Te'ala që kjo letër t'ju arrijë duke qenë ju në një gjendje të mirë shëndetësore dhe në mirëqenieje. Do të dëshiroja që ekselencës suaj t'ia parashtroja tri pyetje në këtë korrespondencë, duke shpresuar që ekselencia juaj do të japë përgjigje vendimtare rreth tyre:

1. Neve na kanë arritur shumë pyetje, edhe nga myslimanët edhe nga jomyslimanët, lidhur me sferën (teologjike dhe sociale) islame dhe me marrëdhëniet në mes shkollave juridike islame (medhhebeve). Ne do të donim që juve t'ju referonim këto pyetje me qëllim shpjegimi dhe korrigjimi nga ana juaj: A është korrekte që t'i konsiderojmë ato shkolla juridike që nuk janë pjesë e Islamit suni si pjesë të Islamit aktual? Me fjalë të tjera, a është korrekte që ta konsiderojmë për mysliman secilin person, i cili e pason dhe mbështetet te njëra nga katër shkollat juridike sunitë ose te shkolla juridike dhahirite, xhaferite, zejdite apo ibadite?

2. Pyetja e dytë, e cila ka lidhje me të parën është: Cilët janë perimetrat në të konsideruarit dhe shpallurit e dikujt si *kafir* (jobesimtar) në këtë ditë dhe epokë? A lejohet që një mysliman t'i shpallë për jobesimtarë ata që mbështeten te ndonjëra nga shkollat juridike tradicionale islame ose atë i cili pason teologjinë *esharite*? Për më tepër, a lejohet që të

konsiderohen si *kuffar* (jobesimtar) ata që ndjekin rrugën e *sufizmit* të vërtetë ose ata që pasojnë pikëpamjen korrekte *selefiste*?

3. Kush mund të konsiderohet si *mufti* i vërtetë në Islam? Cilat janë cilësitë esenciale, të cilat e bëjnë një person të aftë për të marrë përgjegjësinë e dhënies së *fetvave* dhe të të udhëhequrit e njerëzve në të kuptuarit korrekt të Islamit dhe drejt ndjekjes së Sheriatit Islam?

Ne e çmojmë tepër faktin që na dhatë këtë mundësi për të përfutur nga dija dhe ekspertiza juaj e gjerë.

Përsëritet shumë të ngrohta,

Princi Gazi bin Muhamed

PËRGJIGJJA E MEULANA MUFTI MUHAMED TEKI USMANIT

Përgjigjja e pyetjes së parë

Para se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje në disa detaje, do të doja që ta përmendja tërthorazi një fenomen vërtet për keqardhje të madhe, të cilin ne po e dëshmojmë në rrethe të ndryshme



të vendeve tona myslimane. Ai fenomen është që shumë njerëz kanë shkuar në ekstrem për sa i përket kësaj çështjeje, saqë ata ose i kapërcejnë kufijtë ose dështojnë (në dhënien e opinionit të drejtë). Kjo qëndron kështu, ngaqë nga njëra anë disa prej tyre nguten shumë në të konsideruarit si jobesimtar secilin person që nuk e pason opinionin e tyre në çështjet sekondare/të dorës së dytë (ar. *fer'ijje*¹), ku çështjet e tilla nuk janë pjesë të besimit fundamental të *dinit* (fesë). Më saktë, për to ka derë të hapur për *ixhtihad* dhe dallimi akademik i opinionit rreth tyre ka ekzistuar që nga epokat e hershme të Islamit. Kjo gjë e paraqet Islamin sikur ai të jetë një oborr i vogël dhe i ngushtë, ku nëse një person del prej tij qoftë edhe sa maja e gishtit, ai shkëputet nga rrethi i Islamit. Në anën tjetër, ekzistojnë disa të tjerë që pranojnë deklarinimin e secilit që e shpall Islamin. Ata nuk lejojnë që një person i tillë të konsiderohet si *kafir* në asnjë gjendje, edhe nëse ai person i mohon besimet fundamentale të *dinit*, të cilat e ndajnë Islamin nga religjionet e tjera. Kjo gjë e paraqet Islamin sikur ai nuk e posedon një realitet të themeluar e të përforcuar dhe se ai është thjesht një copë e leckosur robe, e cila mund të zbukurohet nga secili besim i rremë dhe destruktiv, për aq kohë sa dikush të pretendojë se është mysliman. Të dy këto pikëpamje janë të pabaza dhe kanë provokuar trazirë dhe kundërshtime në mes myslimanëve. E vërteta mbi këtë çështje është ajo se Islami ose imani është një realitet i rrënjësor dhe i definuar, i cili duhet të provohet dhe të vërtetohet në mënyrë që dikush të konsiderohet dhe të shpallet si mysliman. Ky realitet i rrënjësor dhe i përforcuar akomodon shumë dallime në çështjet *fer'ijje*, të cilat vetë Islami i ka lejuar, prandaj nuk lejohet që dikush të shpallet si jobesimtar thjesht në bazë të dallimeve të tilla *fer'ijje*. Ngjashëm, ky realitet nuk humbet nga një person që thjesht bën gabime të caktuara rreth çështjeve joparimore në veprimet ose besimin e tij, derisa ai të besojë në fundamentet rreth të cilave rrotullohen Islami dhe kufri. Andaj, nëse ne dëshirojmë që t'i bashkojmë myslimanët, atëherë është e domosdoshme që t'i distancojmë te dyja tipat e ekstremeve. Kështu që sikur që do të na duhet të distancohemi nga ata që i shpallin për jobesimtarë njerëzit thjesht në bazë të dallimeve *fer'ijje*, po ashtu do të na duhet që të distancohemi edhe nga ata që dëshirojnë të fusin në Islam çdo besim të tillë të rremë, i cili i kundërshton fundamentet e *dinit*, të themeluara me shekuj.

...sikur që do të na duhej të distancohemi nga ata që i shpallin për jobesimtarë njerëzit thjesht në bazë të dallimeve sekondare (*fer'ijje*), po ashtu do të na duhej që të distancohemi edhe nga ata që dëshirojnë të fusin në Islam çdo besim të rremë....

Kjo vjen si rrjedhojë ngase neve na duhet që ta definojmë këtë realitet që quhet Islam, në mënyrë që të jemi në gjendje për t'u mbajtur në qëndrimin e matur, i cili neve na dallon nga të dyja llojet e ekstremeve. Definicioni i Islamit nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, për të cilin ekziston konsensus të ymetit islam është: "Të besuarit në atë, lidhur me të cilën dihet me siguri absolute se i Dërguari i Allahut a.s. ka ardhur me të."²

Andaj, secili që përfshihet në këtë definicion është mysliman, të cilin nuk lejohet ta konsiderojmë dhe shpallim si *kafir* (jobesimtar).

SHKOLLAT (MEDHHBET) APO EDHE FRAKSIONET MUND TË JENË TRI LLOJESH:

Në llojin e parë hyjnë ato që pohojnë se janë myslimanë, mirëpo i mohojnë disa aspekte, për të cilat dihet fare mirë dhe pa dyshim që janë pjesë të *dinit*. Për shembull, nëse ato besojnë që pejgamberia ka vazhduar edhe pas Pejgamberit tonë të dashur a.s. dhe besojnë në njërin nga ata gënjeshtarë të mëdhenj që kanë pretenduar pejgamberinë pas Vulës së pejgamberëve a.s., siç janë *kadijanitë*; ose besojnë se

Kurani, i cili gjendet sot para nesh të jetë manipuluar, Zoti na ruajtë, dhe se nuk është Kurani i vërtetë, siç kanë pohuar disa *shija* ekstremistë rrejshëm; ose besojnë se hyjnizimi ose disa karakteristika të veçanta të tij gjenden te ndonjë person, gjë e cila iu atribuohet *alevijve* dhe disa të tjerëve. Të gjithë këta janë jomyslimanë dhe është e nevojshme që të konsiderohen dhe shpallën *kuffar* (jobesimtarë).

Në llojin e dytë hyjnë ato shkolla/medhhebe që besojnë në gjithçka për të cilat dihet fare mirë që janë pjesë të *dinit*, përveç se ato shkolla dallojnë në çështje juridike ose në detaje të imëta të disa aspekteve të akides (besimit), për të cilat ka derë të hapur për studim - *ixhtihad*. Pavarësisht këtyre dallimeve *fer'ijje*, secila shkollë nga ky lloj është në rrugë të drejtë në përputhje me *ixhtihadin* e vet dhe asnjëra nga to nuk është e gabuar, lëre më të jetë jashtë Islamit. Në këtë lloj përfshihen të gjitha shkollat juridike, brenda të cilave ekzistonin dallime në mes sahabëve dhe tabinëve siç është ajo që është transmetuar nga *muxhtehidë* të tjerë qofshin ata nga *ehli hadithi*, *ehli re'ji* ose *ehli dhahiri* siç është Shabiu, Hasan el Basriu, Seid bin Musejjebi, Seid bin Xhubejri, Muhamed el Bakiri, Xhafer es Sadiku, El Evzaiu dhe El Lejth bin Sadi, hyn në këtë lloj. Po ashtu në këtë lloj përfshihen edhe maturiditë dhe esharitë, Allahu i pastë mëshiruar që të gjithë. Parakusht i të përfshirit në këtë kategori është që të mos konsiderohen



dhe shpallen shkollat e tjera juridike si jobesimtarë ose mëkatarë (fasikunë) dhe që të mos fyhet asnjëra prej tyre.

E vërteta e çështjes është ajo se argumentet që kanë zërë vend në mes këtyre shkollave juridike islame kanë qenë akademike, pra pjesë e studimit shkencor (ixhtihad), të cilat kanë çuar në të zhvilluarit e mendimit dhe idesë dhe kanë hapur mundësi në gjetjen e zgjidhjeve ndaj problemeve të jetës. Kjo është ajo se pse është thënë që këto dallime akademike janë mëshirë për *ymetin*. Pozicioni korrekt lidhur me secilën nga këto shkolla juridike është ai që secili pasues ose ndjekës duhet ta konsiderojë shkollën e tij respektive si korrekte me mundësi të të qenit në gabim, ndërsa shkollën tjetër se është në gabim, por me mundësi të të qenit korrekte. Kjo është çfarë dijetarët e këtyre shkollave juridike shumë qartë e kanë konstatuar në librat e tyre. Për shembull, Al'lame Haskafi r.a. konstaton në hyrjen e *Ed Durrul Muhtar*, 1:48:

“Kur ne pyetemi në lidhje me shkollën tonë juridike (medhhebin) duke e krahasuar me shkollën juridike të atyre që nuk pajtohen me ne, ne duhet patjetër të përgjigjemi se: shkolla jonë është korrekte me mundësi të të qenit në gabim, ndërsa shkolla e atyre që nuk pajtohen me ne është në gabim me mundësi të të qenit korrekte.”

Ky pozicion në të vërtetë bazohet në këtë thënie të të Dërguarit Muhamed a.s.: “Kur një gjykatës (hakim) vendos një aktgjykim dhe bën përpjekje (të duhur) duke e vendosur më pas një vendim korrekt, ai i meriton dy shpërblime; e nëse ai e kalon një aktgjykim dhe bën përpjekje (të duhur) e pastaj gabon, ai e meriton një shpërblim.”

Në llojin e tretë hyjnë ato shkolla, besimet e të cilave nuk janë të barasvlershme me mosbesimin, meqë ato nuk mohojnë ndonjë aspekt, i cili dihet fare mirë që është pjesë e *dinit*. Megjithatë, mospajtimi i tyre nuk kufizohet në çështje *ixhtihadike* dhe *fer'ijje*. Më saktë, mospajtimi i tyre përfshinë edhe aspekte të rëndësishme të besimit. Secila nga këto shkolla beson se është në të drejtën, ndërsa ato që nuk

pajtohen më atë janë në gabim, ndonëse mospajtimi i saj nuk është i barasvlershëm me mosbesimin. Kjo është sikurse mospajtimi në mes *Ehli Sunetit* dhe *shijave* të matur, të cilët nuk besojnë se Kurani fisnik është manipuluar dhe që nuk mohojnë ndonjë aspekt tjetër që njihet pa kurrfarë dyshimi se është pjesë e *dinit* (fesë). Ngjashëm është rasti i mospajtit në mes *Ehli Sunetit* dhe *shkollës Zejdite* ose *Ibadite*, për aq kohë sa ato të mos mohojnë diçka, për të cilën dihet shumë qartë dhe sigurt se është pjesë e *dinit*.

Prandaj, është i dukshëm fakti që të gjitha këto shkolla nuk janë në pozitë të barabartë kur vjen në pyetje të prezantuarit e Islamit të vërtetë. Megjithatë, të gjykuarit për mosbesim dhe dalje nga Islami nuk vjen në shprehje, përveçse për kategorinë e parë, e cila mohon aspekte që janë shumë sigurt dhe shumë qartë pjesë të fesë - *dinit*.

PËRGJIGJJA E PYETJES SË DYTË

Në përgjigjen e pyetjes së parë, ne përmendëm se është e palejueshme të shpallurit e dikujt, i cili nuk mohon ndonjë aspekt për të cilin dihet shumë sigurt se është pjesë e *dinit*, si *kafir* (jobesimtar). Prandaj, nuk lejohet që t'i konsiderojmë dhe shpallim si jobesimtarë pjesëtarët e atyre shkollave tradicionale myslimane, të cilat përfshihen në grupin e dytë dhe të tretë. Po ashtu përmendëm se cilat nga shkollat-medhhebet të mirënjohura të sotme përfshihen në këto dy kategori.

Sa u përket *sufinjëve*, në mesin e tyre ekzistojnë shkolla të ndryshme juridike. Në mesin e tyre ekzistojnë ata që e kufizojnë veten në vetëreformim, në mënyrë që të jenë në gjendje të ndjekin Sheriatin në përputhje me njërën nga shkollat e pranura juridike islame. Ata nuk ngjiten pas ndonjë besimi, i cili kundërshtohet me *dhahir-in* e (vendimet, normat e jashtme të) Sheriatit, e as që praktikojnë diçka që është në kundërshtim me ligjet sheriatike. Mirëpo ata koncentrohen në reformimin dhe edukimin e karakterit të

një personi përmes metodave që i lejon Sheriati. Llojet e ngjashme me këtë model përfshihen në shkollat juridike të kategorisë së dytë. Pastaj, ekzistojnë disa grupe që e quajnë veten *sufinj*, por ngjiten pas besimeve, përmes të cilave ata e mohojnë ndonjë gjë që dihet fare mirë dhe qartë që është pjesë e *dinit*. Për shembull, ata i mohojnë normat dhe ligjet e jashtme shariatike dhe shpikin ligje të caktuara nga vetvetja, të cilat nuk kanë kurrfarë baze në Kuran dhe Sunet. Këta përfshihen në kategorinë e parë. Në mesin e tyre ka edhe të atillë, të cilët nuk i mohojnë normat praktike e as ndonjë aspekt që dihet fare qartë se është pjesë e *dinit*, mirëpo ata kanë shpikur disa risi në veprimet ose besimin e tyre, të cilat vijnë në kundërshtim me shumicën e ymetit. Të tillët përfshihen në kategorinë e tretë dhe nuk lejohet që t'i shpallim jobesimtarë.

Sa u përket *selefinjëve*, në mesin e tyre ka të atillë që pasojnë *Ehli Hadithin*, ndërsa nuk janë të parespektueshëm ndaj imamëve muxhtehidë e as ndaj atyre që i pasojnë këta imamë. Të tillët përfshihen në kategorinë e dytë. Megjithatë, në mesin e tyre ka edhe të atillë, të cilët besojnë se shkollat e pranuar juridike islame janë falsë dhe gabim, ku si pasojë secilin person që nuk pajtohet me ta e fyejnë dhe e ofendojnë, madje edhe nëse ai mospajtim është rreth çështjeve të dorës së dytë (fer'ijje). Të tillët përfshihen në kategorinë e tretë. Gjithsesi, në të dyja rastet nuk lejohet që ata t'i konsiderojmë dhe shpallim si jobesimtarë.

PËRGJIGJJA E PYETJES SË TRETË

Islami nuk e njeh e as e pranon hierarkinë priftërore, e cila është prezentë brenda Krishterimit dhe religjioneve të tjera. Sovraniteti i takon tërësisht Allahut të Lartmadhërishtëm dhe Pejgamberit të Tij a.s.. Ulematë nuk krijojnë ligje. Ata thjesht e shpjegojnë dhe e sqarojnë atë që është themeluar nga Kurani fisnik dhe Suneti i pastër. Megjithatë, pavarësisht mohimit të hierarkisë priftërore, në mënyrë që të shpjegohen ligjet shariatike është e domosdoshme që personi që i shpjegon ato të posedojë disa kualifikime, të cilat ia mundësojnë që në mënyrë korrekte t'i kuptojë tekstet kuranore dhe sunetike. Prandaj, në Islam '*mufti*' nuk është ai që krijon ligje. Më saktë, mufti është thjesht ai që e shpjegon atë që Allahu xh.sh. e ka bërë ligj në Librin e Tij ose në Sunetin e të Dërguarit të Tij a.s. dhe që e shpjegon atë që është ngritur dhe përforcuar në Sheriat gjatë shekujve. Sipas fjalëve të Al'lame ibën Kajjim el Xhevzizijut r.a. mufti konsiderohet: "Ai i cili nënshkruan në Emër të Allahut të Madhërishtëm." Prandaj, nuk lejohet që secili Hasan e Hussejn, të jep fetva, meqë kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, e cila mund të përbushet vetëm nga dikush që ka përfituar dije shumë të thellë në shkencat islame të tefsirit, hadithit, fikhut (jurisprudencës) dhe akaidit (besimit), si dhe në parimet e këtyre shkencave nga duart e mësuesve ekspertë, të cilët e kanë trashëguar një dituri të këtillë gjeneratë pas gjeneratë. Ngjashëm, është e domosdoshme për një person që merr përsipër përgjegjësinë e të dhënit fetva të ketë kuptim të plotë

mbi rrethanat e njerëzve të kohës së tij, si dhe të rregullave dhe praktikave të tyre.

Metoda që është përcjell dhe të cilën ymeti e ka praktikuar shekuj me radhë është ajo se derisa një person nuk përgatitet dhe trajnohet nga një mufti, të cilin ulemaja e kohës e konsiderojnë të sigurt dhe të besueshëm, atëherë thjesht të studiuarit e shkencave islame nuk e shndërron atë në person të kualifikuar për lëshim fetvash. Kjo qëndron kështu, pasi që lëshimi i fetvasë kërkon mprehtësi të atillë fetare dhe një mjeshtëri dhe kontroll instinktiv mbi jurisprudencën, saqë këto kurrë nuk mund të arrihen thjesht me leximin e librave; më saktë, për këtë gjë është e nevojshme eksperiencia praktike. Mund të bëjmë një krahasim me një mjek, të cilit nuk i lejohet që të fillojë trajtimin e pacientëve thjesht sepse e ka studiuar mjekësinë. Ajo që i duhet atij është që të arrijë trajnim praktik nga duart e një mjeku ekspert, i cili posedon eksperiencë të gjerë në këtë fushë. Dijetarët që kanë shkruar libra mbi parimet e fetvasë vërtet e kanë theksuar këtë pikë.³

Fatkeqësisht, sot shumë njerëz e kanë injoruar këtë pikë. Secili person, emri i të cilit fiton popullaritet si udhëheqës politik ose udhëheqës i ndonjë lëvizjeje, nuk shqetësohet në dhënien e fetvave, pavarësisht që nuk e posedon kompetencën e kërkuar sipas Sheriatit. Njerëzit mashtrohen nga popullariteti i tij dhe pastaj fillojnë të punojnë sipas fetvasë së tij si normë shariatike, edhe pse ajo mund të jetë në kundërshtim me atë që ymeti e ka vendosur gjatë shekujve. Është e domosdoshme që t'i përjashtojmë fetvatë e tilla të çrregullta dhe anormale, të cilat vetëm se i rrisin mospajtimet dhe përçarjet në mes myslimanëve dhe e shqyejnë unitetin e myslimanëve, si dhe e thyejnë forcën dhe fuqinë e tyre, ndërsa i forcojnë komplotet e armiqve të tyre.

Kjo është ajo që unë kam kuptuar në saje të dritës kuranore dhe sunetike, si dhe të konsensusit të poseduesve të dijes së vërtetë nga ymeti Islam. Allahu i Lartmadhërishtëm e di më së miri dhe është vetëm Ai nga i Cili kërkojmë që të na drejtojë dhe të na udhëzojë, si dhe të na mbrojë nga çdo lloj largimi nga rruga e drejtë në mendimet dhe veprat tona dhe të na udhëzojë drejt asaj që Ai është i kënaqur. Lutem dhe kërkoj nga Allahu xh.sh. që të vazhdojë t'ju dhurojë juve aftësi fetare dhe sukses, si dhe t'ju sjellë mirësi njerëzve dhe vendeve përmes jush!

Mufti Muhamed Teki Usmani

12.04.1427 h.

Burimi:

www.muftitaqiusmani.com

Përktheu dhe përshtati nga anglishtja:

Daim Abazi

1 Kuptimi i fjalëpërfjalshëm është 'i lidhur me një fushë'. Këtu çështjet fer'ijje i referohen atyre çështjeve që janë nxjerrë nga Kurani dhe Suneti, ku në përcaktimin e kuptimit dhe aplikimit specifik të të cilave ekziston hapësirë për dallim mendimi nga dijetarët e kualifikuar për atë fushë.

2 Sherhul Akaidit lit Teftazani, f. 119 dhe Ruhul Me'ani, 1:110.

3 Shih për shembull Adabul Fetva lin Nevevij, 1:647 dhe Sherh Ukudi Resmil Mufti te Risailu Ibën Abidin, 1:15.

Agnostic

Religious

Atheist

Ateizmi, kauzë apo mohim?

Mr. Adnan Shala

Nëse e ripotencojmë se teizmi është besimi në Zot, i Cili është Një dhe i Vetmi, nuk ka nevojë për asgjë, por të gjitha krijesat kanë nevojë për Të dhe të besosh në një Zot të Plotfuqishëm, i Cili nuk lindi dhe nuk u lind dhe të qenit plotësisht i lidhur me Të me gjithë fuqinë dhe të gjitha grimcat e zemrës dhe trupit, atëherë ateizmi është e kundërta e kësaj, pra është mohim i vetëdijshëm. Në shkrimin paraprak trajtuam sfondin teorik të ateizmit dhe para se të flasim për llojet e ateizmit dhe pretendimet kryesore të tij, duhet të flasim për format e tjera të cilat ngjajnë me ateizmin dhe shpeshherë ngatërrohen me të. Ndër format më të hasura janë deizmi dhe agnosticizmi. Do të mundohemi shkurtazi t'i shoshitim këtu në mënyrë që ateizmi të kuptohet më drejt.

Si diskutimet mbi deizmin ashtu edhe diskutimet mbi agnosticizmin u zhvilluan në raport me doktrinën krishtere. Mendimtarët perëndimor nuk ishin të kënaqur me interpretimet e teksteve të shenjta po ashtu disa nga ata edhe dyshonin në autetencitetin e tyre. Këtij debati i ndihmoi edhe literatura e lindjes, e cila ishte referenca kryesore e tyre, mirëpo përfundimet e debatit ishin krejtësisht tjera nga ajo se çka ofronte literatura.

Nga pikëpamja historike nga dy konceptet, e para u shfaq deizmi e me pastaj agnosticizmi. Deizmi rrjedh nga fjala latine "deus" që do të thotë "Zot" dhe ka të njëjtin kuptim si teizmi, që vjen nga "theos" që do të thotë "Zot" në greqisht. Megjithatë, me

debatet filozofike dhe teologjike që filluan në botën e krishterë nga shekulli XVI, termi teizëm filloi të përdoret për njerëzit që mbronin besimet ortodokse dhe deizmi për mendimtarët që devijuan nga besimet tradicionale. Një nga përdorimet e para të fjalës deizëm e hasim të Pierre Viret. Viret foli për një grup filozofësh dhe letrarësh që morën emrin deistë për t'u dalluar nga ateistët dhe i akuzoi këta njerëz si ateistë që mohonin Jezu Krishtin dhe doktrinat e krishterimit, megjithëse ata besuan Zotin dhe besuan se Ai e krijoi botën.¹

Vendi ku deizmi ishte më i përhapur në Evropë ishte Anglia. Lordi Herbert Cherbury, i cili konsiderohet babai i deizmit anglez, besonte në Zot dhe në jetën tjetër, por kishte dyshime serioze për saktësinë e shkrimeve të shenjta, kritikoi ashpër institucionin e klerit dhe gjithashtu argumentoi se arsyeja do të mjafton për të kuptuar të vërtetat universale. Kjo qasje ishte pothuajse revolucionare për arsye se për herë të parë në botën perëndimore mund të pretendohet se e vërteta mund të njëjhej edhe pa ndërmjetësimin e kishës dhe klerit.

Këtë qasje e bazonin në një kryevepër të shkruar nga mendimtari Andaluzian ibën Tufejl. Lawrence Conrad thotë për këtë vepër, "Asnjë vepër tjetër nga trashëgimia letrare arabe nuk është përkthyer aq sa Hajj ibën Jakdhan, me përjashtim të "Një mijë e një netëve." Po ashtu shton se, "Kjo vepër tregoi se si mendja njerëzore mund të arrijë nivelet më të larta të njohurive, të cilat kishin një efekt pozitiv në iluminizmin anglez, ka të

"Thelbi i fesë qëndron tërësisht në përgjigjen e pyetjes: *Pse ekzistoj dhe cila është marrëdhënia ime me këtë univers të pafund që më rrethon?*

Prandaj, nuk është e mundur që njeriu të mos ketë zemër, e as të mos ketë fe.

Mund të jetë dikush që nuk e di se ka fe, ashtu si ai që nuk e di se ka zemër."

Tolstoi



ngjarë që John Locke dhe mendimtarët e tjerë të kenë ditur për këtë vepër sepse përkthimet e veprës ishin të disponueshme në gjuhët perëndimore”²

Edhe pse John Locke dhe Hume ishin empirikë, ekziston një probabilitet shumë i lartë që ata të ndikoheshin nga kjo vepër. Para së gjithash, është e mundur që ideja e “natyrës njerëzore” të vijë nga ky libër. Sipas Locke, nuk është e nevojshme të sjellësh koncepte të lindura ose informacion fillestar për të krijuar njohuri, sepse njerëzit për nga natyrshmëria e tyre mund të krijojnë njohuri nga përvoja duke përdorur mendjen e tyre. Pra është shumë lehtë e kuptueshme që ideja e “Natyrës (natyrshmëria) së Njeriut u formua nga ndikimi i veprës së Ibën Tufejlit në mendimin modern perëndimor.³ Ne kemi shumë shembuj të tillë ku mundemi ta bazojmë këtë mendim. Mirëpo ajo që dua të them është se modeli njerëzor në Hajj ibën Jakdhan është një nga arsyet e iluminizmit në mendimin modern perëndimor me interpretime të ndryshme. Mirëpo përfundimi që del nga vepra nuk i tejkalon kompetencat e njohjes, kurse njeriu në botën moderne synohet të paraqitet në një pozitë të vetëmjaftushmërisë. Sipas kësaj mendësie, Zoti edhe mund ta ketë krijuar universin, mirëpo për funksionimin e njeriut nuk është e nevojshme ekzistimi i Tij.

Në këtë kontekst mund të shihet edhe teoria e Njutonit për universin, i cili edhe pse është rregulluar nga Zoti, Ai nuk

Një dozë e shtuar e skepticizmit në qëndrimin deist mund të çojë në agnosticizëm.

ndërhynë në funksionimin e tij pasi ai tanimë punon si një orë e mrekullueshme. Pra, nëse Zoti nuk ndërhynë në mbarëvajtjen e funksionimit të universit, atëherë nuk ka nevojë për një fe e as për të dërguar. Këtij botëkuptimi i themi se është deizëm.

Deistët pretendojnë se njeriut i mjafton një fe natyrore të cilën njeriu e ka në vetën e vet, ku ajo fe është universale. Si udhërrëfyese e kësaj feje natyrore është vetë shkencë dhe të vërtetat shkencore. Njeriu është produkt i njohjes për shkak se ato mund të vërtetohen apo mohohen duke u testuar. Nëse besimi në Zot është njohuri që nuk mund të testohet, atëherë ajo është bindje të cilën

njeriu e beson, por nuk ja determinon mënyrën e jetës.

Koncepti i një Zoti i cili nuk ndërhynë në ligjet natyrore dhe se universi funksionin mbi një determinizëm absolut nuk e hasim vetëm në mendimin perëndimor, atë e hasim edhe në mendimin islam. Njeri ndër ata mendimtar i cili mund të llogaritet si një deist është Ebu Bekr er Razi, i cili beson në Zot, se Ai e krijoi botën, por mohon profecinë. Kishte edhe filozofë e mendimtarë të tjerë të cilët pretendonit se Zoti nuk merret me imtësi dhe si pasojë nuk ndërhynë në univers. Një dozë e shtuar e skepticizmit në qëndrimin deist mund të çojë në agnosticizëm.

Fjala agnosticizëm vjen nga fjala greke “agnostos”, që do të thotë “i panjohur”. Megjithatë, nuk është aq e lehtë të përkufizohet kjo fjalë si një term i filozofisë apo fesë. Sepse

kuptimi që i atribuohet agnosticizmit ndryshon nga filozofi në filozof dhe madje nga teologu në teolog. Sidomos përballë pyetjeve nëse agnostikët besojnë në Zot dhe cili është ndryshimi midis një agnostiku dhe një ateisti, shohim se termi agnosticizëm ka të paktën dy përdorime/ kuptime.

Në kuptimin popullor, një agnostik është ai që nuk ka besim apo mosbesim në Zot. Megjithatë, në kuptimin e ngushtë, agnosticizmi është pikëpamja se arsyeja njerëzore është e paafte të sigurojë baza të mjaftueshme racionale për të justifikuar ose besimin se Zoti ekziston ose besimin se Zoti nuk ekziston.⁴

Ekzistojnë dy forma të agnosticizmit: i dobët dhe i fortë. Forma e parë e agnosticizmit as nuk e pohon e as nuk e mohon ekzistimin e Zotit, pra sipas tyre është e panjohur për ta. Forma e dytë shton se nuk është e mundur të dihet për këtë arsye askush nuk mund të pretendojë ekzistimin apo mos ekzistimin.

Përveç kësaj, ka edhe nga ata që termin agnosticizëm e përdorin në një shtrirje më të gjerë dhe e ndajnë atë në lloje, si: teizmi agnostik, ateizmi agnostik, agnosticizmi indiferent, agnosticizmi pragmatik. Teizmi agnostik në këto klasifikime të fundit përdoret për njerëzit që besojnë në ekzistencën e Zotit, si Kierkegardi dhe Kanti, edhe pse ata pranojnë se ekzistenca e Zotit nuk mund të njihet dhe se njohuritë mbi këtë temë tejkalojnë aftësinë tonë për të ditur. Ka edhe nga ata që teizmin agnostik e quajnë agnosticizëm fetar.⁵

Ateizmi agnostik, nga ana tjetër, është qëndrimi i mendimtarëve, si Bertrand Russell, të cilët nuk e shohin të arsyeshme të besojnë në ekzistencën e Zotit, bazuar në parimin agnostik, i cili argumenton se nuk është racionale të besosh në ndonjë besim pa prova të mjaftueshme.⁶

Russell thotë se si filozof, duhet të them se nëse i drejtohem një audience të pastër filozofësh, e përshkruaj veten si agnostik. Sepse nuk mendoj se ka argument të fortë për të vërtetuar se Zoti nuk ekziston. Nga ana tjetër, nëse do të bëj përpjekje që njeriu në rrugë të ketë përshtypjen e duhur për mua, mendoj se duhet të them se jam ateist. Sepse kur them se nuk mund të vërtetoj se Zoti nuk ekziston, po ashtu nuk mund të vërtetoj se perënditë e mitologjisë greke nuk ekzistojnë.⁷

Agnosticizmi indiferent dhe agnosticizmi pragmatik në përgjithësi kuptohen si agnosticizëm i dobët. Në këto lloje të agnosticizmit, ekziston një gjendje e indiferencës së plotë

Deizmi thotë se Zoti ekziston, mirëpo ne nuk mund ta njohim. Kurse agnosticizmi thotë se ne nuk mund ta dimë se ekziston apo jo Zoti dhe në te dyja rastet Ai (Zoti) nuk është referencë e veprimeve të mija.

ndaj besimit në Zot dhe në fe. Ky qëndrim quhet edhe “apatizëm” (indiferencë).

Megjithëse Thomas Henry Huxley, ishte i pari i cili e përdori agnosticizmin si term, mendimtarët agnostikë sigurisht që ekzistonin edhe para tij. Nëse e konsiderojmë agnosticizmin si skepticizëm ndaj besimeve fetare, atëherë atë mund ta hasim edhe në kohët e lashta. Në këtë kontekst, mund të vlerësohet mendimtari i lashtë grek, Protogoras, si ndoshta mendimtari i parë agnostik. Ai tha për ekzistencën e Zotit: “Sa për perënditë, nuk gjeta asnjë mënyrë për të ditur nëse ekzistojnë apo jo. Si misteri i problemit ashtu edhe shkurtësia e jetës njerëzore mund të numërohen ndër shumë gjëra që pengojnë marrjen e informacionit për këtë temë.”⁸

Sipas agnostikëve, teisti edhe ateisti nuk janë mjaftueshëm skeptikë. Sipas tyre i vetmi qëndrim racional mbi ekzistencën e

Zotit është qëndrimi agnostik, i cili shmang gjykimin përfundimtar për këtë çështje.

Si deizmi ashtu edhe agnosticizmi mund të themi se janë forma tjetërsuara të ateizmit, edhe pse deizmi në shikim të parë mund të duket së është më afër teizmit. Përfundimi në të dy format është ateizëm. Deizmi, Zotin nuk e mohon direkt por nëpërmjet mundësisë se njohjes se Tij që është feja, kurse agnosticizmi e mohon Zotin duke e mohuar çdo lloj njohje e cila ka të bëjë me Zotin dhe çështjet metafizike.

Si përfundim mund të themi se deizmi thotë se Zoti ekziston mirëpo ne nuk mund ta njohim, kurse agnosticizmi thotë se ne nuk mund ta dimë se ekziston apo jo Zoti dhe në te dyja rastet Ai nuk është referencë e veprimeve të mija. Pra në te dyja rastet nuk kemi mohim të Zotit por kemi injorim të ekzistencës së Tij.

1 Üsameddin Erdem, “Deizm”, TDV İslâm Ansiklopedisi, <https://islamansiklopedisi.org.tr/deizm> (25.03.2023).

2 Samar ATTAR, *Ibn Tufayl's Influence on Modern Western Thought*, Lexington Books 2010 USA fq.2

3 Samar ATTAR, *Ibn Tufayl's Influence on Modern Western Thought*, Lexington Books 2010 USA fq.2

4 William L. Rowe, “Agnosticism” Routledge Encyclopedia of Philosophy, ed. by E. Craig, London, fq. 10

5 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 11

6 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 12

7 Ferit Uslu, “Agnostisizm”, *Hitit Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 2012, fq. 12

8 Diogenes Laertius, *Lives of Eminent Philosophers*, English Translation and ed. by R. D. Hicks, London: W. Heinemann - New York: G. P. Putnam's Sons, 1925, vol. II, Book IX, fq. 465

Dispozitat e qirasë sipas jurisprudencës islame

Dr. Flamur Sofiu

Në jurisprudencën islame, qirasë i është kushtuar kujdes i veçantë, duke shpjeguar dhe vendosur norma që kanë të bëjnë me të, ngase dihet qartë se qiraja është një kontratë e rëndësishme, por që dallon nga shitblerja, sepse kontrata e saj është e afatizuar në kohë.¹

Qiraja (إجارة) në kuptimin gjuhësor nënkupton dhënien e ndonjë malli-sendi që është i dobishëm për një kohë të caktuar me pagesë, ndërsa në kuptimin terminologjik sipas medhhebit hanefi, qiraja është një marrëveshje për shfrytëzimin e gjërave të dobishme me kompensim.²

Legalitetin e qirasë e hasim në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberi a.s.. Allahu i Lartësuar thotë: “E nëse ato u japin gjë fëmijëve tuaj, atëherë jepuani atyre shpërblimin që u takon”,³ po ashtu në Kuran përmendet tregimi i Musait a.s. me bijat e Shuajbit a.s. ku thotë: “O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim.”⁴

Po ashtu, qiraja është përmendur edhe në Sunetin e Pejgamberi a.s. si: “Jepini mëditësit pagën e tij para se t’i thahet djersja e tij.”⁵ “Kush punëson një punëtor, le t’ia paguajë atij rrogën e tij të plotë.”⁶

KONTRATA-MARRËVESHJA E QIRASË

Kontrata e qirasë është e njëjtë sikur të gjitha kontratat e tjera. Për të qenë kjo kontratë në rregull, duhet të plotësohen doemos dy elementet kryesore:⁷

1. Oferta,
2. Pranimi i ofertës.

Oferta e qirasë realizohet në atë mënyrë duke shprehur me fjalë se po kërkon të marrë diçka me qira ose

Oferta e qirasë realizohet në atë mënyrë duke shprehur me fjalë se po kërkon të marrë diçka me qira ose po ofron me dhënë diçka me qira.

po ofron me dhënë diçka me qira. E me pranimin e ofertës nënkuptohet se personi është i pajtimit me ofertën e dhënë. Pra, të thotë qiradhënësi apo qiramarrësi, e jap me qira, dhe marrësi të thotë, e pranojë atë.

Në rastin e kontratës së qirasë obligohen disa kushte, thuajse kushte të përgjithshme sikurse me kontratat në përgjithësi. Këto kushte janë:

1. Që kontraktuesi të jetë i mençur,
2. Që të jetë në moshën madhore,
3. Që kontrata të jetë e qartë dhe t’i dihet qëllimi.

Për të qenë kontrata legale kushtëzohen këto kushte:⁸

- Kushtet për mallin e dhënë me qira,
- Kushtet në vlerën e qirasë.

KUSHTET PËR MALLIN E DHËNË ME QIRA JANË:

1. Që malli i dhënë me qira të jetë prej gjërave të lejuara në aspektin e sheriatit islam, ngase nuk lejohet të jepet me qira ajo që është e ndaluar në fenë tonë⁹

2. Që malli i dhënë apo i marrë me qira duhet të jetë i njohur nga ana e kontraktueseve në atë nivel sa që të mos kenë paqartësi rreth mallit. Malli bëhet i njohur me këto mënyra¹⁰:

- a. Të caktohet koha e qirasë. P.sh. kur i jepet dikujt vetura me qira, i caktohet koha e përdorimit etj.
- b. Që të përcaktohet se çfarë lloji do të jepet apo merret me qira, si p.sh. të caktohet lloji i punës në ndërtimin e murit, të caktohet lloji i pambukut që do të jepet me qira etj.
- c. Që të sinjalizohet në mënyrën e veprimit, si p.sh. të jepet shenjë se në çfarë modeli të qepen rrobat etj.

KUSHTET E DHËNIES SË SHPËRBLIMIT-PAGËS¹¹

Dihet qartë se shpërblimi-pagesa bëhet për kryerjen e ndonjë punë apo për shfrytëzimin e ndonjë gjëje të dobishme. Kushtëzohet që në pagesën që duhet bërë, të jetë e precizuar mirë nga të dyja palët në kontratë. Në parim dihet që pagesa jepet pasi të kryhet puna ose pasi të jetë arritur përfitimi. Po ashtu mund të paguhet gjatë punës, pas përfundimit të punës dhe para fillimit të punës nëse për këtë janë të pajtimit të dy palët.¹²

Shënim: për disa llojet të pagesave nuk ka në nevojë të kihet njohuri paraprake se sa duhet të paguhet, ngase konsiderohen punë të lehta dhe se veprohet sipas traditës si p.sh. nëse i dërgojmë këpucët për t'i riparuar ato, apo e riparojmë ndonjë mbajtës të orës e të ngjashëm. Pra, në këtë rast, pagesa bëhet sipas zakonit të atij vendi.

ME ÇKA REALIZOHET PAGESA?

Zakonisht në kohën tonë është e njohur që pagesa të realizohet gjithmonë me monedha dhe se sasia dhe vlera e tyre janë të njohura nga të dy palët. Po ashtu ka mundësi të paguhet paga edhe me forma të tjera me ndonjë lloji të mallit apo me ndonjë gjë që ka vlerë.¹³

Shpërblimi në mall mund të jetë p.sh. rroba, grurë, vaj etj.. Në kohët e hershme në këtë mënyrë ka qenë zakon pagesa. Kur ndodh që të paguhet paga me mall nuk lejohet të jetë pjesë e kontratës si p.sh. nëse e ka punësuar kasapin për të therur lopën me kusht që lëkura e saj të jetë si pagë; ose t'i caktohet atij që e bluan miellin të marrë si pagë një pjesë të grurit etj.. Kjo nuk lejohet për shkak se lëkura nuk dihet se a do të jetë e padëmtuar, a do të jetë e trashë apo e hollë, ndërsa te gruri nuk dihet sa e ka peshën. Pra, pagesa në këtë mënyrë nuk lejohet ngase vlera e pagës është e panjohur. Pagesa me diçka që është përfitim

si p.sh. t'i jepet vetura për shfrytëzim si pagesë e qirasë së shtëpisë ku banon.¹⁴ Në këtë rast, sipas hanefitëve, kur të bëhet pagesë me diçka që është përfitim nuk lejohet të jetë me të njëjtin mall si p.sh. të bëhet pagesa e qirasë së shtëpisë duke i dhënë atij ndonjë shtëpi tjetër me qira. Kjo ndalesë është e atillë me qëllim që të mos bëhet kamati me vonesë për shkak të pagesës me lloj të njëjtë.

KUSHTET E QIRASË NË MALLËRA¹⁵

Qiraja për mallra, në të cilën bëjnë pjesë: qiraja për shtëpi, veturë, tokë, dhe mjete të ndryshme etj., duhet të plotësojë kushte të veçanta me qëllim që qiraja të jetë legale. Pra, këto kushte janë:

a. Që malli i dhënë me qira të dihet se cili është, si p.sh. nëse dikush posedon disa llojet të veturave, duhet të përcaktohet qartë se cila është ajo veturë që është dhënë me qira.

b. Që çmimi i qirasë të jetë i përcaktuar edhe po që se nuk është e përcaktuar koha e përfundimit të përdorimit.

Rreth këtij llojit të qirasë ka rregulla të shumta¹⁶, e ne do t'i përmendim disa prej tyre:

1. Qiradhënësi duhet t'ia dorëzoj pronën qiramarrësit pas bërjes së kontratës. Pra, duhet dorëzuar mallin qiramarrësit nëse mundet të merret me dorë t'i jepet në dorë apo t'i mundësohet që ai mall të jetë në përdorim nga ana e qiramarrësit. E kur ndodh që malli nuk është i atillë që mund të lëvizet si p.sh. shtëpia, atëherë duhet me i dhënë çelësin e saj, apo nëse ka dhënë tokën me qesim (qira), atëherë pas kontratës duhet t'i jepet leja qiramarrësit që ta fillojë punën në të. E kur i dorëzohet malli qiramarrësit, atëherë ai e ka për obligim dhënien e qirasë për të cilën janë dakord dhe se tash nuk ka rendësi se a e shfrytëzon mallin qiramarrësi apo jo.



2. Në momentin e dorëzimit, malli nuk duhet të ketë asnjë të metë që e pakëson apo e pengon mundësinë e shfrytëzimit në aspektin e dobisë. E, po që se ndodh që në të të ketë të metë që e pakëson mundësinë e shfrytëzimit dhe se qiradhënësi refuzon të përmirësoj atë mangësi, atëherë qiramarrësi ka të drejtë zgjedhje: nëse do e prish kontratën ose nëse do e vazhdon kontratën edhe me atë mangësi.

3. Kur ndodh që malli t'i merret me dhunë qiramarrësit, atëherë nuk jepet qiraja derisa malli është i uzurpuar, ngase uzurpimi dhe dhuna janë shkak që pengojnë shfrytëzimin e mallit, e që në këtë rast nuk jepet edhe qiraja.

4. Kur dikush merr ndonjë mall me qira, ai atë mall do ta shfrytëzojë vetëm ashtu si është kontraktuar, d.m.th. duhet të përcaktohet se për çfarë qëllimi do të shfrytëzohet malli apo mjete i marrë me qira. P.sh. kamioni si mjet transporti mund të bartë orendi, pambuk, miell, grurë etj. Gjithashtu mund të transportoj edhe gurë, hekur, dhe, etj.

5. Nëse një person e merr me qira ndonjë mall dhe se qiradhënësi nuk i kushtëzon atij që të mos ia jep tjetrit atë mall me qira, atëherë këtij i lejohej që atë mall t'ia jep tjetrit qoftë me qira apo qoftë si hua.¹⁷

6. Po që se ndodhë që qiramarrësi e dëmton, keqtrajton-shkatërron mallin dhe vepron në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga qiradhënësi dhe më pastaj i shkakton dëmtime apo shkatërrim mallit, atëherë qiramarrësi është i obliguar me kompensim.

7. Kur përfundon periudha e qirasë e ka për obligim qiramarrësi që të kujdeset për mallin dhe se duhet ta rikthej mallin ashtu si duhet dhe si e ka marrë nga qiradhënësi. Pra, duhet t'i kthehet malli pronarit në dorë ose në vendin ku e ka caktuar vetë ai.

8. Po që se ndodh që qiramarrësi kërkon nga prodhuesi që ta punojë vetë personalisht atë që i kërkohet, atëherë ai është i detyruar t'i përmbahet marrëveshjes dhe assesit t'ia dorëzojë kryerjen e punës diku tjetër.

Shënim: Nëse në mallin e dhënë me qira paraqitet një e metë e madhe gjatë periudhës së dhënies me qira, atëherë lind pyetja se kush duhet të marrë përgjegjësinë e përmirësimit, pronari apo qiramarrësi? Të metat e mëdha të mallit mund të përmbledhen në dy lloje:

a. Një lloj ku e meta paraqitet te malli natyrshëm jo për shkak të njeriut. Si p.sh. kur ndodh që të bije fasada e murit, apo të dëmtohet kulmi për shkak të reshjeve, apo tërmetit etj.. Atëherë në këtë rast pronari e ka për obligim përmirësimin dhe rregullimin e mallit të dëmtuar. E po që se ndodh që qiramarrësi e rregullon me vullnetin e vetë pa i marrë leje pronarit, atëherë ky veprim konsiderohet si kontribut vullnetar dhe se nuk ka të drejtë të kërkoj nga pronari shpërblimin për këtë kontribut vullnetar nëse pronari nuk ia paguan këtë kontribut.

b. Ndërsa lloji tjetër është kur paraqitet dëmtimi për shkak të përdorimit nga qiramarrësi si p.sh. prishja e ru-



bineteve të ujit në shtëpi dhe mbushja e shtëpisë me ujë e të ngjashme. Në këtë rast qiramarrësi është i obliguar të sanojë dëmet e tilla ngase kanë ndodhur për shkak të veprimeve të tij.

c. Kur ndodh që rrobaqepësi ka marrë nxënës për t'ua mësuar ndonjë profesion dhe gjatë mësimit ndodh që të dëmtohet materiali, atëherë rrobaqepësi e ka për obligim me e kompensuar dëmin, si p.sh. po që se nxënësi e dëmton pëlhurën gjatë qepjes, atëherë kompensimin e kësaj pëlhurë e ka për obligim rrobaqepësi¹⁸.

ARSYET PËR PRISHJEN E KONTRATËS SË QIRASË

Qiraja është kontratë që duhet të zbatohet derisa të plotësohet koha e saj, pos nëse janë të pajtimit të dy palët ta prishin atë.

Mund të prishet kontrata e qirasë me kërkesën e njërës palë kur ekzistojnë shkaqet e forta për prishjen e saj.

Shkaqet të cilat lejojnë apo edhe kërkojnë prishjen e kontratës së qirasë janë tri lloje:

1. Arsyet nga ana e qiramarrësit: kur ndodh që ai të falimentojë, apo e braktis profesionin e që për atë e ka marrë ndonjë mjet me qira apo transferohet në ndonjë vend tjetër. Po ashtu mund të prishjet marrëveshja e qirasë kur ndodh që kjo marrëveshje do të sjell dëm te qiramarrësi apo te pasuria e tij. Si p.sh. nëse dikush e ka marrë me pagesë dikë që ta prish një mur, por që në këtë rast kuptohet qartë se nëse prishet muri rrezikohet ndërtesa, pra në këtë rast lejohej të prishet kontrata e qirasë.

2. Arsyet nga ana e qiradhënësit: kur ndodh që qiradhënësi është në borxh dhe ka nevojë për shitjen e mallit të dhënë me qira që ta paguaj borxhin, apo nëse ndodh që qiradhënësi duhet doemos të udhëtoj dhe atë

që e ka me pagesë të punoj duhet t'i ndërpres punën e të ngjashme.

3. Arsytet që vijnë nga vetë malli i dhënë me qira: si p.sh. kur dikush e merr me qira një dyqan në ndonjë fshat, ndërsa banoret e atij fshati largohen prej fshatit; ose po qe se ndodh që dikush e merr me qira ndonjë vend punishte për të prodhuar një mall të caktuar, por që shteti e ndalon prodhimin e atij malli, apo shteti e ndalon atë veprimtari në atë rajon.¹⁹

DHËNIA E PAGËS

Me dhënien e pagës kuptohet pagesa e punëkryesit për punën e kontraktuar, si p.sh. nëse e merr dikë me qira për t'i bartur orënditë e shtëpisë me pagesë²⁰. Dhënia e pagës për punën e kryer ndahet në dy grupe:

1. Pagesa që e realizon punëkryesi nga shumë veta si p.sh. rrobaqepësi e realizon pagesën nga klientët. Kjo mënyrë e pagesës në të drejtën islame quhet (الأجير المشترك). Punëtorit të kësaj kategorie i bëhet pagesa kur ta kryej punën, ngasë kështu është marrëveshja. Mirëpo kur ndodh që punëtori ta realizojë punën duhet menjëherë t'i behet pagesa dhe assesi të shtyhet më vonë, përveç nëse kanë marrëveshje për këtë mes vete.

Po që se ndodh që në punën që e realizon punëtori ku ka dhënie të mundit si p.sh. qepja e pëlhurës (rroba), në këtë rast i lejohet punëtorit të mos ia dorëzojë mallin përderisa të paguaj punën punëtorit. E nëse ndodh që për ndonjë mall nuk ka dhënë mund punëtori dhe atë mall nuk ia rikthen pronarit dhe ndodh që ai mall të dëmtohet, atëherë punëtori në rast të dëmtimit është i detyruar ta kompensoj atë. Si p.sh. nëse dikush e ka dorëzuar pëlhurën për ta qepur të rrobaqepësi dhe se rrobaqepësi nuk ka qepur asgjë, por refuzon t'ia kthej pëlhurën klientit, e nëse ndodh që ajo të dëmtohet, atëherë rrobaqepësi është i detyruar ta kompensoj.

Shënim: po që se ndodh që i kërkohet punëtorit që ta ngjyrosë rrobën apo pëlhurën dhe se ngjyrosja dësh-ton, jo për fajin e punëtorit, apo të vidhet jo për shkak të neglizhencës së tij, në këtë rast nuk i bëhet pagesa për angazhimin që e ka bërë punëtori. Kur ndodh që gjatë punës punëtori e dëmton materialin që ka për ta punuar, sipas Ebu Hanifes, nuk duhet ta kompensoj vetëm nëse qëllimisht e ka dëmtuar apo nuk është kujdesur për ruajtjen e tij. Ndërsa dy nxënësit e Ebu Hanifes janë të mendimit se në këtë rast duhet të bëjë kompensimin e dëmit punëtori, pavarësisht se a e ka shkaktuar këtë nga pakujdesia apo mos kujdesi i duhur. E nëse ndodh që të dëmtohet materiali për shkak të fatkeqësive natyrore, atëherë punëtori-mjeshtri nuk e ka për obligim kompensimin e dëmit.

2. Pagesa që e realizon punëkryesi nga punëdhënësi. Kjo mënyrë e pagesës në të drejtën islame quhet (الأجير الخاص). Në këtë formë të pagesës bëjnë pjesë të gjithë të punësuarit që punojnë me kontratë në ndonjë institucion,

qoftë privat apo shtetëror.

Shënim:

Nëpunësit shtetëror pavarësisht kategorive dhe aftësive marrin pagën e kontraktuar dhe se këta bëjnë pjesë në grupin e pagesës الأجير الخاص. Nëpunësit janë të angazhuar me orar të caktuar varësisht prej natyrshmërisë së angazhimit, paguhen edhe për pushimin e festave që janë zyrtare, kanë të drejtë për pushim vjetor dhe mjekësor duke marrë pagë edhe për këto raste. Të gjitha këto veprime realizohen në bazë të marrëveshjes në mes të dy palëve dhe se në aspektin juridiko islam konsiderohen të drejta legale.

SINDIKATAT E PUNËTORËVE:

Në kohën tonë bashkëkohore, ekzistojnë organizata të cilat njihen si sindikatat e punëtorëve. Si zakonisht, këto lloje të organizatave kujdesen dhe i ruajnë të drejtat dhe interesat e punëtorëve.²¹ Veprimet e sindikatës konsiderohen legale, ngase është e themeluar me anë të zgjedhjeve nga vetë punëtorët. Detyra kryesore e sindikatës është ruajtja e interesave të punëtorëve dhe assesi nuk lejohet që prej buxhetit të punëtorëve sindikata të jep lëmshë apo ndihma humanitare.

1 Ibën Abidin, Redul Muhtar Ala Durri Muhtar, (Bejrut: boton Darul Fikr, 1412h/1992), v. VI fq. 3.

2 El Kasani, Bedaiu Sanaiu... (Bejrut: Darul Kutub el-Ilmijeti, pa vend botimi, 1424h/2003), v. IV, fq.174.

3 Et Talak, 6.

4 El Kasas, 26.

5 Transmetojnë Ibën Maxheh dhe El Bejhekiu.

6 Transmeton El Bejhekiu.

7 Muhamed Maxhid Iter, el Mufessal fil Fikhil Hanefij el Emvalu vel Muamelat el Malijjeti, (Haleb: Mektebetu Daril Mustakbel, pa vit botimi), fq.305.

8 Po aty

9 El Kasani, Bedaiu Sanaiu, v. IV, fq.179.

10 Ibnul Humam el Hanefij, Fet'hul Kadir, (Bejrut: Darul Kutub el-Ilmijeti, 1424h/2003), v. VII, fq.150.

11 El Kasani, Bedaiu Sanaiu, v. IV, fq.193, Ibnul Humam, Fet'hul Kadir, v. VII, fq.152.

12 Ibnul Humame el Hanefij, Fet'hul Kadir, v. VII, fq.152.

13 Muhamed Maxhid Iter, el Mufessal fil Fikhil Hanefij el Emvalu vel Muamelat el Malijjeti, fq.305.

14 Ez Zuhajli, El Fikhul Islamijj ve Ediletuhu, (Bejrut: Darul Fikr, Damask, pa vit botimi), v. IV fq. 752.

15 Muhamed Maxhid Iter, el Mufessal fil Fikhil Hanefij el Emvalu vel Muamelat el Malijjeti, fq.305.

16 Ibën Abidin, Redul Muhtar Ala Durri Muhtar, (Bejrut: Darul Fikr, 1412h/1992), v. VI fq.11.

17 Të këtij mendimi janë hanefitët. Por në ditët e sotme, një veprim i tillë assesi nuk lejohet, ku zakon mbizotëruen në kohët tona është se nuk i lejohet qiramarrësit që mallin e tillë t'ia jep me qira tjetrit apo si hua. Pra nëse në kontratë qiradhënësi i jep leje për një veprim të tillë, atëherë qiramarrësi mund të veprojë i lirë.

18 Muhamed Maxhid Iter, el Mufessal fil Fikhil Hanefij el Emvalu vel Muamelat el Malijjeti, fq.316.

19 Po aty.

20 Po aty.

21 Muhamed Maxhid Iter, el Mufessal fil Fikhil Hanefij el Emvalu vel Muamelat el Malijjeti, fq.321.

Funksioni i imamit në kohën e globalizmit

Bashkim Aliu¹

Veprimtaria e masës të cilës i drejtohet imami, nuk nënkupton vetëm fushën e ritualeve praktike, dhe interesimi i tyre nuk lidhet vetëm për këtë fushë, por edhe për shumë fusha dhe segmente të tjera, të cilat janë të domosdoshme për kohën dhe proceset shoqërore.

Globalizmi është një temë komplekse, pasi si proces, shtrihet në disa fusha dhe ka ndikim në disa segmente, me çka gjeneron rrjedha dhe ndërveprime të nivelit global, që prekin çdo shoqëri, si dhe çdo segment të veprimtarisë njerëzore. Apo, siç shprehet për globalizimin Matiç: “Globalizimi është një proces objektiv dhe kontradiktor i ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta botërore, i cili çon në riformulimin e ekzistueses në rend të ri botëror të reproduktimit, gjegjësisht çon në krijimin e shoqërisë botërore” (Matiç, 2004: 84).² Ky është edhe një nga definicionet për globalizmin. Këtu, nuk mbetet pa u prekur edhe veprimtaria e veprimtarëve dhe institucioneve fetare, ashtu që imponohet diskutimi për funksionin e imamit, si veprimtar dhe institucion i rëndësishëm, në kohën e globalizmit.

Funksioni i imamit dhe xhamisë në kohën e globalizmit, nuk duhet kuptuar thjesht vetëm në kontekst të përmbushjes së kërkesave të masës së caktuar, të cilës imami i shërben de jure, me kontratën e punës në xhami, edhe pse kjo është parimore dhe e rëndësishme, pa dyshim, si dhe as vetëm në korniza të zyrtares së tij si imam, në kohën e punës dhe brenda objektit të xhamisë, por ky funksion shtrihet shumë më gjerë duke përfshirë edhe shumë masa, forma, nevoja dhe fusha të tjera të aktivitetit, që në fakt na transferon në stadin e të qenit të detyrës së imamit mision, e jo thjesht profesion. Kjo, nisur nga fakti se edhe veprimtaria e masës të cilës i drejtohet imami, nuk nënkupton vetëm fushën e ritualeve praktike, dhe interesimi i tyre nuk lidhet vetëm për këtë fushë, por edhe për shumë fusha dhe segmente të tjera, të cilat janë të domosdoshme për kohën dhe proceset

shoqërore, si: çështjet ekonomike, financiare, biznesi, administrata, trashëgimia, jeta bashkëshortore, të arriturat shkencore, inxhinjeringu gjenetik, politika, marrëdhëniet ndërkombëtare, kultura, ekologjia, të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat, të cilat në fushën e të drejtës ndërkombëtare njihen si gjenerata e tretë e të drejtave të njeriut etj..

Kjo qasje ndaj funksionit të imamit dhe xhamisë në kohën e globalizmit, nuk duhet zbritur në nivelin e përgjigjes së domosdoshme ndaj sfidave të jashtme, të cilat, pa dashje i janë imponuar profilit të imamit dhe institucionit të xhamisë, dhe të kërkohet zgjidhje në adaptimin e kontrolluar ndaj situatës së krijuar. Kjo do të mund të detektohet si qasje e antiglobalizmit dhe tradicionalizmit të fortë, që promotorët e tij nuk mund të dyshohet se kalojnë faza të transformimeve të domosdoshme të amezës së tyre ideologjike dhe metodologjike në emër të kreativitetit brenda teksteve sipas mënyrës së tyre të kuptimit dhe interpretimit. Ngelja në proviniencën e adoptimit për t’iu përgjigjur, e jo bashkëveprimi konstruktiv, efektiv dhe inovativ, nuk do ta ngrenë, por do ta ulin, kurbën e kërkesave të kohës dhe ambientit për punën, të drejtat dhe hapësirën e imamit.

Kuptimi i drejtë i formësimit dhe transformimit të funksionit të imamit dhe xhamisë, na ngre në nivelin e këndvështrimit gjithëpërfshirës global, duke u nisur nga aktualiteti i proceseve integruese në rrjedhat globale, si nga brezat e rinj, po ashtu edhe nga institucionet e ndryshme shoqërore, duke mos anashkaluar në asnjë mënyrë ato religjioze, në këtë rast islame, që të mund të manovrohet në skenën globale me vlerat universale që i përmban Islami.

Globalizmi, është krejt e qartë, pati ndikim në zhvillime të dukshme brenda bashkësisë myslimane, jo vetëm në plan të brendshëm



lokal, por edhe në atë global. Koha e cila shënohet si e globalizimit, inicioi zhvillime thelbësore në institucionet relevante islame akademike dhe fetare, si në universitete dhe në ministritë e çështjeve fetare apo institucionet për fetva (çështje islame), si dhe në shoqëritë të cilat për një kohë janë etiketuar si tradicionale. Kështu, në listën e aktiviteteve të institucioneve islame has agjenda të dendura të komunikimit me palët e tjera, studime komparative nga fusha e së drejtës pozitive dhe e së drejtës islame, psikologjisë, sociologjisë, ekonomisë, etj., asaj që u quajt si “islamizim i dijes dhe shkencave”³, të drejtave të njeriut, shpjegimit shkencor të ajeteve kuranore⁵, shpjegimit të traditës profetike në kontekst bashkëkohor duke shpaluar aspekte të rëndësishme të saj me të drejtën ndërkombëtare, paqen, dialogun ndërkulturor, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e natyrës etj..

Nga ana tjetër, në shoqëritë që janë identifikuar si tradicionale dhe më të mbyllura, u hapën për debate që aspak nuk janë të natyrës tradicionale, ku në fokus i vunë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtat e grave, debatin për arsyeshmërinë e disa ndalesave të cilat edhe ashtu në disa vende nuk janë parë si të tilla nga establishmenti fetar, prezenca e femrës në jetën politike, në art, kulturë, media, liria e shprehjes, mendimi kritik, gabimet që janë bërë në të kaluarën në emër të fesë, ridefinimi i bidatit-risisë në fe, ekstremizmi, integrimi, etj.. E gjithë kjo, e mbështetur nga instrumentet “magjik” të globalizimit si: mediumet masive, rrjetet sociale, komunikimi elektronik, etj.. Për rrjedhojë, individi, familja dhe shoqëria, u gjetën para “stuhisë” së ndryshimeve që solli procesi i globalizimit edhe në shoqëritë tradicionale, duke i ngjyrosur ata jo vetëm me ngjyrën e tradicionales, por edhe të prirjes për t’u integruar në rrjedhat globale dhe për t’u akomoduar, si ata vetë, ashtu edhe ambienti ku jetojnë, me ndryshimet e shkaktuara nga procesi i globalizimit. Kjo nuk është vështirë të dallohet edhe në ambientet e tilla tradicionale, ku një lokal për qethje quhet

Xhems Dean, Pikaso, etj., por edhe brenda familjes, ku flitet çdo ditë e më tepër hapur për bloggerët, artin, realiti show, IT, botën virtuale, gjigantët si: Amazon, Google, Apple etj.. Në këtë kontekst, akomodimi me ndryshimet e procesit të globalizimit në njërën anë, dhe mostejkalimi i parimeve bazë të fesë në anën tjetër, që do të mund të komentohej si rrëshqitje nga parimet drejt përshtatjes me modernen, më qartë reflektohet në ligjërimin fetar të kohës.

- 1 Anëtar i Kryesisë Qendrore të Federatës së Organizatave Islame në Zvicër, dhe këshilltar fetaro-shkencor i kryesisë së Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër.
- 2 Matić, Petar, *Politika modernizacija u eri globalizacije*, Srpska politika misao, Beograd, 2004, f.84.
- 3 Pionieri i kësaj platforme në shekullin XX, Ismail Faruki, në lidhje me këtë, thotë: “Kjo pra është një detyrë e rëndësishme, e cila u takon intelektualëve dhe udhëheqësve myslimanë që, nga pikë qëndrimi i Islamit, t’i jepet një formë e re tërë trashëgimisë së diturisë njerëzore. Vizioni i Islamit nuk mund të jetë vizion i vërtetë, po që se nuk i përfaqëson përmbajtjet e veçanta, respektivisht: jetën, realitetin dhe botën. Brendësia është objekt studimi i disiplinave të veçanta. Dhënia e formës së re diturisë në kallëpin e Islamit, është e lidhur ngushtë me vizionin e Islamit. Është e domosdoshme të islamizohet dituria, respektivisht të ridefinohen dhe të rirenditen të dhënat, të rimendohet rezonimi dhe të ndërliken të dhënat; të rivlerësohen konkluzionet, të riprojektohen qëllimet dhe e tërë kjo të bëhet në aso mënyrë që do t’i bënte disiplinën ta pasurojnë vizionin dhe t’i shërbejnë kauzës së Islamit” (Faruki, Ismail R., *Islamizimi i diturisë: Parimet e përgjithshme dhe plani i punës*, përktheu: Urim Poshta, botim privat, Shkup, 1992, f.35).
- 4 Faruki, op. cit., f.31-35.
- 5 Shpjegimi shkencor i ajeteve të Kuranit ka ngjallur polemika mes dijetarëve islamë. Në këtë kontekst, do ta shënojmë më poshtë në pika të shkurtra fetvanë e dijetarit të shquar, Jusuf el Karadavi për çështjen në fjalë. Jusuf el Karadavi, duke u përgjigjur në një pyetje se a lejohet komentimi shkencor i ajeteve të Kuranit, në mes të tjerash, shënon: “Në vitet e pesëdhjeta të shekullit XX, u zhvillua një betejë polemikash dhe debat në faqet e gazetave egjiptase në mes dy grupeve të dijetarëve rreth kësaj çështje. Mendoj se kjo polemikë vazhdon edhe në ditët e sotme, gjegjësisht vazhdon të ketë të atillë që e mbështesin këtë lloj interpretimi dhe të atillë që e kundërshtojnë.

Qëndrimi të cilin e përzgjedhim:

Vërejmë se në këtë çështje, sikur edhe në pjesën më të madhe të çështjeve diskutabile shkencore, kemi tri pozicionime: dy skaje dhe mesin.

Në njërin skaj i hasim ata të cilët e refuzojnë në çdo mënyrë futjen e shkencave në fushën e interpretimit të Kuranit, duke dashur me këtë që ta largojnë Kurantin nga mundësia e ndryshimit, si rezultat i ndërrimit të rezultateve të këtyre shkencave.

Në skajin tjetër, i hasim ata të cilët e teprojnë me përdorimin e këtyre shkencave dhe e mundojnë veten duke u munduar ta paraqesin Kurantin si libër që i përfshinë të gjitha këto shkenca, dhe se u ka paraprir atyre në teoritë dhe të vërtetat. Ata orvaten ta theksojnë atë që e quajnë “mrekulli shkencore” me paramendime të shumta.

Por, ka një pozicionim mesatar, të drejtë, ndërmjet të dy palëve, pozicionim që nuk e tepron duke mohuar çdo gjë, por nuk i tejkalon kufijtë duke konfirmuar çdo gjë të kësaj natyre. Ky qëndrim mesatar, rrumbullakohet në disa rregulla dhe kushte... Këtë pikë do ta përfundoj duke i përmendur disa fjalë objektive të autorit të njohur prof. Mustafa Akad, të cilat fjalë i ka thënë kur ka folur për njeriun në librin e tij *Hakaiku-l-Islam ve ebatilu husumihi* (Të vërtetat e Islamit dhe të pavërtetat e kundërshtarëve të tij)... Prof. Akadi ka thënë: “Ne nuk duam që ta implikojmë Kurantin në shpjegimin e drejtimeve shkencore dhe teorive të ndryshme, ngase, sa herë që paraqitet një drejtim, i nënshtrohet debatit dhe përmirësimeve, apo sa herë që paraqitet një teori, disa njerëz e pranojnë e disa e refuzojnë. Sado që të jenë të vërtetuarat teoritë shkencore, ai vërtetim vlen për një kohë, pas një kohe, fillojnë të paraqiten rreth tij dyshime, bëhen përmirësime dhe korrigjime. Në kohën më të afërt, patëm rastin të shohim disa njerëz të cilët i komentojnë shtatë qiejt me shtatë planetët në sistemin diellor. Më pas, u vërtetua se ka më tepër se dhjetë yje, ndërkaq yjet e vegjël-satelitët, janë të shumtë, nuk mund të numërohen. Për atë, nuk është e drejtë që ta implikojmë fenë në shpjegimin e mendimeve dhe thëniesve të cilat nuk janë bazike në shkencat përkatëse, dhe nuk është në rregull që mbi to të ndërtohen baza. Fesë i mjafton ajo që nuk e pengon personin që të gjurmtojë në shkencë dhe ta pranojë mendimin i cili vjen si rezultat i zbulimeve dhe analizave. Në bazë të këtyre rregullave, myslimani kthehet në ajetet e Kuranit dhe thënieve profetike, dhe në to nuk sheh pengesë që e ndalon nga studimi dhe gjurmimi në fushat e ndryshme shkencore...” (Kardavi, Jusuf, *Fetva bashkëkohore*, përktheu nga arabishtja: Bashkim Aliu, Furkan ISM, Shkup, 2015, vëll. III, f.21, 30-31).

Arti dhe e vërteta

Besnik Jaha

Vetëm arti ia ruan unitetin absolut të vërtetës, duke e ruajtur të çiltër brenda vetes, ndërsa duke e shpërfaqur të kamufluar nga stolitë.

ARTI DHE HISTORIA

Përderisa e vërteta është historike kur tregon atë që ka ndodhur, arti, në dukje, është në konflikt të përjetshëm me të vërtetën. Thjesht, sepse arti e ka të vërtetën e vet. Atë që e krijon vetë, dhe që me fanatizëm insiston se duhet besuar se është e vetmja e vërtetë. Për këtë shkak shkarkon më shumë *patos*-ndjeshmëri, dhe përpiket t'i bëjë lajka *logos*-racionalitetit.

Historia edhe pretendon të ketë njëfarë të drejte mbi të vërtetën. Për këtë, si krahë të fortë ka dëshmitë dhe burimet. Arti nuk i duron pretendimet.

Diku kam pas shkruar se kur historiani shkruan histori, apriori i duhet të bazohet në burime e dëshmi. Sepse, në fund të fundit, historia nuk është letërsi (art).

Historia ka kohën. Arti jo. Apo, thënë më drejt, që të mbijetojë, arti duhet të jetë përtejhistorik; arti vetëm e përdor historinë, si burim, për ta realizuar veten dhe historinë e vet, ndërsa vetëm kur arrin t'i mbijetojë kohës, edhe mund të bëhet pjesë e historisë.

Sidoqoftë, edhe arti e përdor përvojën dhe përditshmërinë, e që mirëfilli janë burime esenciale të historisë. Megjithëse, përvojën e përditshme arti e shpërfill, ndërsa e përzgjedh vetëm përvojën dhe përditshmërinë cilësore. Atë që bëhet burim për të.

Kështu e shihte artin edhe John Dewey. Sipas tij (libri “Arti i Përvojës”), “arti është përvojë, dhe si i tillë, në procesin ndërveprues mes njeriut dhe natyrës, sjell elemente të reja konceptuale. Pra, sipas Deëy, përvoja artistike diferencohet nga

ajo e përditshme për faktin se në të (përvojën artistike) theksi bie mbi cilësinë. Dewey edhe është i bindur se “arti mund të përcaktohet si shprehje e dendësuar e përvojës së përditshme”.

Mund të duket paradoksale, mirëpo arti jeton as në “të vërtetën” e synuar, dhe as në “të vërtetën” e prezantuar. Sepse e para është hipotezë, ndërsa e dyta histori. E, arti nuk është as hipotezë, dhe as histori. Arti është një e vërtetë që jeton në një nga të vërtetat e mundshme.

ARTISTI DHE E VËRTETA

Gjithë përpjekja e artistit gjatë shprehjes së pastër të unit të vet (sipas konceptit të Giovanni Gentile për artin; arti është “forma e Unit si subjekt i pastër”¹⁾) është që ta tregojë të vërtetën. Atë që koha ka mundur ta mbulojë. Atë që historianët kanë mundur ta interpretojnë, dhe jo thjesht ta publikojnë si të vërtetë, duke i prezantuar dëshmitë. Atë që historia e ka shpërfillur. Atë që në forma të ndryshme ka mundur mos të kuptohet, ndërsa *doemos* duhej kuptuar.

Në fakt, siç thotë profesor Metin Izeti, “artisti shpeshherë e ka gjetur të vërtetën, e përjeton atë, mirëpo nuk bën zë, ndërsa vepra e tij bën zë gjatë historisë”²⁾.

Sipas këtij koncepti, artisti gjithmonë është në kërkim të formave të veçanta të shprehjes, figurave e simboleve, në mënyrë që përmes veprës së vet t'i flasë botës për të vërtetën, e cila për arsye të ndryshme s'mund të artikulohej sikurse përmes artit. Kjo sepse, në fund të fundit, vetëm përmes veprës artistike zëri i artistit do të jehojë përgjatë historisë, madje edhe kur ai nuk do të jetë pjesë e kësaj bote.



ARTI DHE SAKRIFICA PËR TË VËRTETËN

Arti dhe e vërteta mbajnë një lidhje korrespondence mes vete. Ata edhe janë të lidhur, mirëpo edhe duket se nuk janë bashkë. Vetëm arti ia ruan unitetin absolut të vërtetës, duke e ruajtur të çiltër brenda vetes, ndërsa duke e shpërfaqur të kamufluar nga stilitë. Dhe është pikërisht tendenca e ruajtjes së të vërtetës shkak i kamuflimit prapa ngjyrave, tingujve, figurave-simboleve a materialeve të ndryshme.

Përmes formës së realizimit arti gjithmonë synon ta tregojë një të vërtetë të mundshme. Qoftë në pjesë, qoftë në tërësi. Sepse synon të sinjalizojë kah e vërteta e plotë, mirëpo pa e thënë atë. Se, po ta thoshte, nuk do të ishte art, por retorikë ose histori.

Vepra e arrirë artistike është një sinkronizim tepër organik i një sërë figurash e simbolesh, idesh dhe temash, dhe si e këtillë ka për qëllim shfaqjen sa më të plotë të së vërtetës së synuar. Sasia e figurave nuk ka rëndësi, por tërësia e tyre e sistemuar sa më organikisht, ashtu që të na nxjerrë para të vërtetës së tërë, e që është pika themelore që synon vepra artistike.

Arti sakrifikon, mirëpo edhe sakrifikohet për të vërtetën. Për shembull, teatri. Aktori që del në skenë sakrifikon identitetin e tij unik, unin e tij origjinal, që, bashkë me kënaqësinë, publikut t'ia ofrojë edhe një të vërtetë tjetër të mundshme.

Aktori që del
në skenë
sakrifikon
identitetin e tij
unik, unin e tij
origjinal, që,
bashkë me
kënaqësinë,
publikut t'ia
ofrojë edhe një
të vërtetë tjetër
të mundshme.

mundshme. Një të vërtetë të mundshme të fatit të tij, përkatësisht të fatit të tyre. Vetëm e vetëm që t'i edukojë. Që e ardhmja mos t'u vijë paradoksale.

Në formën e vet më ideale, arti sakrifikon gjithçka për të vërtetën absolute. Sepse vetë e vërteta absolute është burimi i çdo arti dhe arti superior. Atje shpirti i artistit, pas heqjes dorë nga çdo e mirë materiale dhe përkushtimit në përjetim shpirtëror, identifikohet me Krijuesin, *fenalilah*, duke e përkujtuar Atë gjithmonë.

Duke jetuar në këtë frymë, artisti dallohet për modesti dhe shpirt që kënaqet me pak. Sepse, sikurse arti, që sakrifikon çdo gjë për të vërtetën, edhe ai heq dorë nga çdo gjë vetëm për të vërtetën dhe të Vërtetin. Po në këtë kontekst, Xhenab Shahabeddini thoshte se *artit i ka hije kursimi, e jo shpenzimi i tepërt*.

Njeriu, po diti ta njohë artin, do të dijë ta njohë edhe të vërtetën. Sepse arti jo vetëm që synon të vërtetën, por edhe e përfaqëson atë denjësisht, shpeshherë më mirë sesa historia, e cila zakonshëm mund të jetë interpretim i të vërtetës. E, në anën tjetër, arti gjithmonë është ikonë e të vërtetës.

1 Stefan Çapaliku, *Hyrje në estetikë*, Bard Books, 2022, Prishtinë, f. 58.

2 Metin Izeti, *Pasqyra estetike e traditës perenniale*, Vizioni M, Shkup, 2018, f. 12.

Metodologjia e Pejgamberit a.s. në zgjidhjen e problemeve

Isa Tërshani

Të nderuar besimtarë!

Islami është feja e shpirtit dhe trupit, feja e xhamisë dhe e rrugës, feja që të gjendet në rast gëzimi dhe në rast hidhërimi. Shkurt, Islami është feja e njeriut si krijesë, i cili ka të mira e të këqija, ka dobësi, probleme dhe halle; Islami është feja e natyrës së vërtetë njerëzore. Nuk ka pasur pejgamber, që përveç ftesës për besim të pastër në Zotin e Madhërishëm dhe paralajmërimit që të mos i bëhet ortakëri Atij, e që nuk e ka pasur për detyrë edhe zgjidhjen e problemeve sociale të kohës së tij.

S'ka dyshim se shoqëria njerëzore ka ndryshuar shumë, së këndejmi edhe shoqëria e sotme nuk është ajo e kohës së Muhamedit a.s.. Nga ana tjetër, të mos harrojmë se njeriu është po ai njeri, me të njëjtin shpirt, nefs e dëshira dhe, në esencë, problemet janë pak a shumë të njëjtat, edhe pse në dukje të ndryshme. Prandaj, metodologjia e Pejgamberit a.s., në trajtimin e këtyre problemeve do të mbetet më e sakta dhe më e mira, se fundja ai ishte pejgamber i Zotit, dhe si i tillë i korrigjonte dobësitë dhe të metat e njerëzve.

Si i zgjidhte Muhamedi, a.s. problemet e njerëzve:

Zoti i Madhëruar në Kuran na porositë që të ndjekim shëmbëlltyrën e Pejgamberit a.s., duke thënë: *"Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut..."*¹

Në vazhdim do të përpiqemi t'i përmendim disa veçori të metodës pejgamberike në trajtimin e problemeve sociale, që të na shërbejnë si një rrugë për ne dhe problemet e shoqërisë sonë.

1. BESIMI NË ZOT ËSHTË ILAÇI MË I FORTË

Pejgamberi a.s., e dinte se e mira dhe e keqja burojnë nga brendia e njeriut, e dinte se edhe reforma duhet nisur dhe zhvilluar po brenda njeriut. Ai e dinte mirë se çdo njeri ka një derë nga mund të depërtosh në brendësinë e tij, ashtu siç çdo derë e ka një çelës.

Dera që përdori i Dërguari i Zotit ishte zemra e njeriut dhe çelësi që e hap atë derë, pa qenë nevoja ta thyesh, është besimi i shëndoshë në Zotin xh.sh.. Mos të harrojmë për asnjë çast, se shoqëria ku jetonte Pejgamberi a.s., nuk ishte pa probleme sociale! Njerëzit që e rrethonin, pos tjerash, ishin viktimat e gjakmarrjes qindravjeçare; burrat e asaj kohe ishin të varur nga alkooli dhe vera që konsumoheshin pa masë, gratë dhe vajzat shiheshin më shumë si barrë e sikletshme e familjes dhe e shoqërisë, sesa si njerëz me shpirt. Në atë shoqëri kishte jo pak imoralitet, lojëra bixhozi, fajde, konflikte dhe hasmëri. Mirëpo Pejgamberi a.s., gjithë betejën e nisi nga mbjellja e besimit të shëndoshë. Ai u tregoi atyre se kush ishin ata e kush ishte Krijuesi i tyre, pse kishin ardhur në këtë botë e ku do të shkonin pas vdekjes... Kur ky besim filloi të mbijë e të lulëzojë, ata vetë e braktisën alkoolin,² për arsye se e kuptuan që është nëna e të këqijave,³ e lanë hasmërinë që ua kishte prishur jetën dhe në vend të saj pranuan vëllazërinë,⁴ braktisën bixhozin e kamatën dhe i hynë punës, iu larguan imoralitetit⁵ dhe iu afruan më shumë familjes...

Duke u bazuar mbi këto fakte të prekshme, edhe njerëzit tanë, kur ta hapin derën e besimit, doemos pastaj do të shpëtojnë njëherë e mirë nga alkooli dhe droga, sepse diçka tjetër do t'ua mbushë jetën. Kështu, do t'i trajtojnë ndryshe prindërit e tyre, kur ta marrin vesh se pas respektit të Zotit vjen respekti ndaj prindërve,⁶ do t'i zgjidhin më me qetësi problemet e familjes, pa përdorur dhunë e konflikt, sepse do ta kuptojnë që familja është gjëja më e shtrenjtë, dhe të shtrenjtën duhet ta mbash e jo ta thyesh...

2. MËSIMI PARA QORTIMIT

Pejgamberi a.s., ishte mësues, dhe mësuesi shpjegon para se të qortojë. Ai ishte dërguar "mëshirë"⁷ dhe i mëshirshmi mundohet të rregullojë, e jo të prishë e demaskojë. Kur njerëzit i shfaqnin gabimet para tij, ai ishte mësuesi e mjeku, që në fillim ua shëronte mendjen me sqarim, e pastaj zemrën me lutje dhe dua. Kështu e bindi djalin e ri i cili kërkonte t'i

lejohej imoraliteti, duke i thënë se çdo grua është nëna, motra, halla apo tezja e dikujt⁸ dhe ky “dikushi” nëse është normal, nuk e dëshiron imoralitetin në rrethin familjar. Kështu e mësoi beduinin arab që urinoi në xhaminë e tij⁹ duke i thënë se xhamitë janë ndërtuar për adhurim dhe lutje e jo për kryerje nevojash personale. Edhe burrave që e kishin për turp kur ju lindte vajzë, duke ju thënë se ai njeri që rrit dhe edukon vajza, ai meriton xhenetin e Zotit... Pejgamberi a.s., ua ndryshoi konceptet atyre që abuzonin me pasurinë e jetimit, duke ju thënë se kush mbështet jetimin, qoftë dhe me një ledhatim në kokë, do të jetë përkrah Pejgamberit a.s. në xhenet, duke e demonstruar me dy gishtërinjtë.¹⁰ Pra, kështu gjithmonë duke i mësuar njerëzit se ajo që po bëjnë nuk ishte e drejtë, dhe se Zoti dëshironte për ta diçka më të mirë, Pejgamberi a.s., u bë mësuesi e mjeku i secilit.

Prandaj, edhe në shoqërinë tonë, një fjalë e ngrohtë e një këshillë e sinqertë, që ju thuhet njerëzve me probleme sociale, do të ketë ndikim për të mirë, shumë më tepër sesa fjalë të këqija, që mesa duket po kanë efekt nxitës për keq dhe efekt jo parandalues. Sado e vogël qoftë, e mira shpërblehet. Sigurisht se është gjë e bukur kur Zoti të mundëson të bësh një të mirë, e është edhe më bukur kur me atë të mirë ke zgjidhur hallin e dikujt tjetër...Kështu ke kënaqur Zotin dhe e lehtëson jetën e njeriut...

Abdullah ibën Mubareku ishte dijetar dhe pasanik i madh... Çdo dy vjet ai shkonte në haxh. Në një nga udhëtimet drejt shtëpisë së Zotit, pasi kishte kaluar një distancë të madhe nga rruga, e pa një grua që kishte mbështjellë nën sqetull një pulë të ngordhur...Ibën Mubareku e ndali dhe e pyeti gruan pse po e bënte një gjë të tillë, ajo iu përgjigj se fëmijët e saj kishte kohë që e kishin harruar aromën e mishit të zier në shtëpi...Dijetari, që njihnte drejt qëllimet madhore të fesë dhe e kuptonte se kur e mira kishte më shumë vlera, pa hezitur urdhëroi shërbëtorët që të mbajnë aq para sa për t’u kthyer në shtëpi e të gjithë pjesën tjetër t’ia jepnin asaj gruaje...Pastaj, ai ngriti duart drejt qiellit dhe u lut: “O Zot! Pranoje prej robit Tënd haxhin e këtij viti”.

3. NEVOJA PËR ALTERNATIVË

Njeriu është i tillë që, nëse nuk angazhohet me punë të mira, do angazhohet me të këqija. Zemra e njeriut është si ena, që nëse nuk mbushet me vlera, vetvetiu do mbushet me antivlera, mirëpo bosh nuk mbetet asnjëherë. Për këtë arsye, fryma që ka përdorur Kurani famëlartë dhe metodologjia e Pejgamberit a.s., ka qenë mosmjaftimi me ndalesa, ashtu që sjellja gjithmonë të jetë një alternativë më e hairit nga ajo që është ndaluar. Kur Zoti ndaloi alkoolin, i lejoi me dhjetëra a qindra pije të tjera që nuk dehin. Kur Pejgamberi a.s., kritikoi “lyppen” dhe shtrirjen e dorës, mori në dorë një sëpatë, pasi e kishte rregulluar vetë ai dhe ia dha lypësit, që me atë sëpatë



të punoj, të paktën për dy javë rresht. Kur ndaloi kamatën nxiti tregtinë, kur ndaloi imoralitetin nxiti për martesën. Po ashtu, kur ndaloi racizmin urdhëroi për drejtësi të preکشme sociale, e kështu me radhë. Njerëzit, shpesh edhe vetë e konstatojnë të mirën, por janë të dobët për ta pranuar, si dhe shpesh e konstatojnë të keqen, mirëpo janë të dobët për ta braktisur. Atij që është duke u mbytur nuk i mjafton vetëm qortimi pse hyri në ujë kur s’dinte të notonte, por i duhet një dorë që e tërheq dhe e shpëton nga rreziku. Mendoj se kjo është fryma kuranore dhe profetike dhe kjo duhet të jetë metoda që duhet të përdorim në trajtimin e problemeve tona sociale...

Në fund, po e mbyll me dua që Zoti të na ndihmojë të gjithëve, të jemi çelës për të mirën dhe të dobishëm, gjithmonë për krijesat e Tij, si dhe zgjidhës për halle dhe lehtësues për dhimbjet! Amin!

1 El Ahzab, 21

2 El Maide, 90.

3 El Bejhkeij, në Shu’bul iman, 5586.

4 El Huxhurat, 10.

5 El Isra, 32.

6 En Nisa, 36.

7 El Enbija, 107.

8 Ahmedi, 256

9 Buhariu, 221.

10 Tirmidhiu, 1918.

Tri cilësitë e Uvejs el Karnit

Florim Zejnullahu

Uvejs el Karni, siç njihet në historinë islame, jetoi në kohën e Pejgamberit a.s., mirëpo pamundësia që ta shihte Pejgamberin a.s., bëri që ai të mbetej prej brezit të dytë të myslimanëve, tabinëve.

Rendi botëror po kalon nëpër një fazë të re zhvillimore dhe bashkë me të edhe risitë e njëpasnjëshme janë duke e dominuar çdo kulturë, traditë e zakon. Kemi filluar të hyjmë me një rrugë të re, duke mos e ditur se ku është destinacioni ynë, e as stacioni i parë i kësaj rruge. Parimet kryesore të këtij civilizimi janë dy: faktorizimi i materies dhe mospërfillja totale e anës shpirtërore.

Më herët është paralajmëruar se ideologjia e materializmit nuk njeh tjetër pos të prekshmes, të gjithë ne myslimanët kemi qenë të kujdesshëm që të mos krijojmë mani e të bëhemi robër të anës materiale e të mos ecim në rrugën e atyre që u mahnitën me botën materiale e harruan atë fizike.

E arsyeja që po e bëjmë këtë lloj hyrjeje është mjaft soditëse, ngase para vetes kemi një personazh që jeta e tij prej një asketi e një njeriu të virtytshëm na rrëfen se njerëzit e mëdhenj në histori balancuan aspektin shpirtëror me atë material. Apo edhe më tepër, ata iu përkushtuan më tepër anës shpirtërore se sa asaj materiale. Personazhi ynë që është në fokus të trajtesës sonë është i mirënjohuri tabin, Uvejs el Karni.

I Dërguari ynë i fundit, Muhamedi a.s., na ka treguar për Uvejs el Karnin. Nje tabin modest, i devotshëm dhe i panjohur për njerëzit ne tokë.

Transmetohet nga Usejr ibën Amëri, e i thuhet se Ibën Xhabiri ka thënë: Umer ibën

el Hatabi ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. se do t’iu vjen juve Uvejs ibën Amiri nga Jemeni, i cili ka qenë i sëmurë nga lebroza (sëmundja e lëkurës) e pastaj është shëruar, e ka një nënë ndaj së cilës sillet shumë mirë, nëse i lutet Allahut për diçka, Allahu menjëherë ia pranon.”¹

Hadithi i Pejgamberit a.s. është më i gjatë dhe qëllimi nuk është të nxjerrim çaste historike apo personalitete, mirëpo e rëndësishme është që ne të përfitojmë nga ky mesazh, dhe të kuptojmë se çka ishte ajo që e ngriti këtë tabin të devotshëm, saqë është përmendur nga goja e bekuar e Pejgamberit a.s.. Pra kemi të bëjmë me një personalitet, i cili për atë kohë ishte i panjohur për rrethin e tij (familjar, fisnor) dhe i cili ishte i nënçmuar po nga rrethi i tij.

Është e çuditshme se sot shumë pak përkujtohet jeta dhe vlera e këtij njeriu nëpër ligjërata e minbere. Ndoshta sepse kemi filluar të heqim dorë nga ana shpirtërore dhe nga kërkesa për t’iu afruar Zotit tonë nëpërmjet veprave të sinqerta dhe qëllimeve te pastra.

Uvejs el Karni, siç njihet në historinë islame, jetoi në kohën e Pejgamberit a.s., mirëpo pamundësia që ta shihte Pejgamberin a.s., bëri që ai të mbetej prej brezit të dytë të myslimanëve, tabinëve.

Ky njeri, bëri që me veprat e tij të ngritët fama e tij deri te banorët e qiejve, saqë çfarëdo lutje që ia bënte Allahut xh.sh., Ai ia pranonte. Pa asnjë dilemë, Uvejsi, Allahu qoftë i kënaqur me të, mbetet prej brezit të tij në gradën më të lartë dhe

më të ndritur, sepse përmendet me emër e mbiemër në hadithin e Pejgamberit a.s..²

Do të ishte shumë e ndershme, e rëndësishme dhe shumë e vlefshme për kohën tonë aktuale që të mbaheshin ligjërata, seminare dhe hytbe për këtë njeri dhe për veprën e tij, si dhe të analizohej rreth asaj se edhe ne sot mund të jemi çdo njeri Uvejs el Karni, e pastaj cilat ishin ato virtyte që i kishte, nga e trashëgoi atë potencial të karaktereve të larta. Do të na shërbente pas një studimi psikologjik, shkencor, ndoshta edhe social të rregullimit tonë shoqëror, për t'i zgjidhur shumë probleme psikologjike-sociale.

Si u bë që Uvejsin mos ta njihnte familja e tij, rrethi i tij, vendi, ndërsa ta njihnte Allahu lart në qiell, engjëjt e Tij dhe krejt banorët e qiellit!?

Një njeri i thjeshtë, i panjohur në tokë por shumë i rëndësishëm në qiell. Një njeri që të gjithë e nënçmonin dhe e përqeshnin, mirëpo i lavdëruar nga fjalët e Pejgamberit a.s.. Kur ta analizojmë jetën e tij, themi se Uvejsi u ngrit tek Allahu xh.sh. mes të tjerash, nëpërmjet tri cilësive - veçorive që i kishte dhe të cilat e kanë bërë model për ne sot.

Tri cilësitë që e ngritën lart këtë tabin të ndershëm dhe që bënë që ky njeri të jetë i njohur tek Allahu xh.sh. ishin:

1. Respekti, dashuria dhe përkujdesja ndaj nënës së tij,
2. Altruizmi,³
3. Derti i tij ishte: "Çfarë pozite kam unë tek Allahu xh.sh.?"

Tiparet e tij na e rikthejnë vëmendjen tonë te cilësitë e munguara në shoqëritë bashkëkohore njerëzore, por edhe ato myslimane. Virtyti i respektimit të prindërve si një vlerë e munguar në epokën e tanishme është kryefjala e personalitetit të këtij njeriu të shquar. Ai na e rikthen vëmendjen në madhësinë e porosive kuranore dhe të haditheve profetike që trokasën në vëmendjen tonë e tërheqin vërejtjen për mosrespektimin e prindërve ose moskujdesin ndaj të moshuarve.

Kjo dukuri tani vërehet se ka tendencë rritjeje te brezi i ri, dhe ne duhet inkurajuar ata që të marrin modele të tilla si shembuj e jo ata që kanë harruar çdo vlerë e etikë në familje e shoqëri. Kjo e rikthen vëmendjen te kërkesat e habitshme të gruas që në aktin e kurorëzimit ndoshta kërkon nga burri i saj që ai të jetojë jetën larg prindërve të tij. Kjo bëhet me pretekste nga më të ndryshmet, por që të gjitha në fund kanë një rezultat, braktisjen e prindërve dhe kthimin e shpinës për ata në moshën kur ata më së shumti kanë nevojë për kujdesin e fëmijëve të tyre.

A thua vallë çfarë islami e përfaqësojmë ne?

Nga kush po informohemi ne rreth fesë sonë?

A e kemi kuptuar ne më mirë islamin apo Ebu Bekri, Othmani e Aliu dhe të tjerët, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata, që ishin njerëz të ngritur tek Allahu, jetuan së bashku me Pejgamberin a.s., kohën e artë, të përgëzuar me Xhenet, me kushte të rënda sociale/ekonomike, dhe



Nuk ka
rendësi se si të
shohin
njerëzit, se si
të vlerësojnë,
apo se si nuk
të respektojnë.
Rëndësi ka se
si je ti tek
Allahu, Zoti
yt.

asnjëherë nuk u ndalën në humanitet, bamirësi dhe punë të dobishme.

Pra cilësia e parë që e ngriti Uvejsin ishte respekti ndaj nënës së tij: e ushqente, e veshte dhe nuk e la të vetmuar asnjëherë.

Cilësia e dytë ishte altruizmi. Në kohën tonë moderne, ky tipar gjendet shumë rrallë dhe me keqardhje themi se më shumë gjendet te popujt e tjerë jo islam se sa te ne myslimanët.

Allahu në Kuran, në suren Hashr, në ajetin e 9, i përmendi altruistët që i dhanë përparësi kërkesave të vëllezërve të tyre më shumë se vetvetes, duke i quajtur ata të shpëtuarit.

Pra, dhënia përparësi tjetrit përpara vetes tënde në çdo aspekt të mundshëm: në ushqim - duke i afruar anëtarit të familjes përpara vetes; në punësim - duke i dhënë përparësi shokut/kolegut; në komunikim etj..

Kjo cilësi është e vështirë për t'u arritur, mirëpo ajo bëri që Uvejsi, i cili ishte prej fukarenjve më të mëdhenj të rrethit të tij, nga të ardhurat që merrte të gjitha i shpërndante te nevojtarët, saqë edhe fukarenjtë u çuditën me të, duke i thënë: O Uvejs, po ti ke nevojë më shumë se ne, mirëpo ai e ndante vetëm një pjesë gote qumësht gjatë ditës për ta ushqyer nënën e tij dhe veten.

I tillë ishte Uvejsi.

Cilësia e tretë ishte një brengë e tij: A thua vallë, çfarë pozite kam unë tek Allahu?

Kur e kërkonte Umeri r.a. në mesin e jemenasve Uvejsin, fisi i tij që e njihnin u munduan ta fshehin Uvejsin, duke i thënë Omerit se çka po të duhet ty Uvejsi, i cili është njeri i gjorë, i nënçmuar, fukara etj.

Ja ku na ke ne, njerëz me pushtet me pozitë me pasuri. Ndodhi e papritura për ta, përkundër kësaj, këmbëngulja e Omerit r.a. ishte më e madhe, sepse Uvejsi ishte përmendur në hadithin e Pejgamberit a.s..⁴

Për këtë arsye, turma të mëdha njerëzish filluan të shkojnë drejt tij për t'i kërkuar që Uvejsi ta luste Allahun për falje. Mirëpo kjo nuk i pëlqeu Uvejsit, sepse këtu kishim të bëjmë me famën e popullaritetin, veti këto që Uvejsi nuk ishte



mësuar me to dhe ai i urrente. Madje ishte pikërisht urrejtja që kishte për famën e pozitën, që e kishin ngritur kaq lart tek Allahu dhe që e inspiruan të ikte për të mos u dukur më kurrë.

MËSIMET E NXJERRA NGA RRËFIMI PËR UVEJS EL KARNIN

-Nuk ka rendësi se si të shohin njerëzit, se si të vlerësojnë, apo se si nuk të respektojnë. Rëndësi ka se si je ti tek Allahu, Zoti yt.

-Brenga e njerëzve sot është tejet shqetësuese. Kjo brengë e gabuar te ne sot, se a thua vallë si po dukem përpara njerëzve, para publikut. A thua vallë a do t'ju pëlqej veshja ime të tjerëve, vetura apo shtëpia ime, këto pyetje e shmangin njeriun nga brenga kryesore që duhet të na brengoste të gjithëve: a thua vallë çfarë pozite kam unë tek Zoti im?!

-Do të ishte një përmirësim i raportit prind - fëmijë, rritja e respektit për të moshuarit, kujdesi ndaj tyre, ngritja e vlerës së familjes, pastaj shërimin e shumë sëmundjeve psikologjike, si vesveset zilinë, lakminë, stresin, depresionin e shumë probleme të tjera.

Mbesim me shpresë se ajo që ekziston në teori, në porositë e marra nga rrëfimi i Uvejs el Karnit, do të na kalojnë edhe në praktikë.

1 Muslimi, Sahih Muslim, nr: 2542.

2 Dr. AbdulBarij Davud , Uvejs el Karni, Kajro, Dar El Ahmedij, 1999, 24-32.

3 Heqja dorë nga dëshirat individuale dhe dhënia përparësi kërkesave dhe nevojave të të tjerëve.

4 Muslimi, Sahih Muslim, nr: 2542.

Benefitet e ujit Zemzem

MSc. Njomza Sadriu

dhe unë po e pi atë që të mos kem etje Ditën e Ringjalljes!” Ky hadith është i vërtetë.

Uji Zemzem është një ujë i bekuar që myslimanët e përdorin për qëllime fetare dhe mjekësore. Miliona haxhilerë e pinë atë dhe e sjellin si dhuratë për të afërmit dhe miqtë e tyre kur kthehen në shtëpi. Uji Zemzem, i furnizuar nga pusi i Zemzemit është i disponueshëm përmes çezmave dhe kontejnerëve që shpërndahen në Mesxhid al Haram në Mekë. Uji Zemzem është gjithashtu i disponueshëm në formë shishe për të lehtësuar transportin ajror për haxhilerët që dëshirojnë, pasi qeveria saudite ka ndaluar eksportin komercial të ujit Zemzem.

Uji Zemzem është ujë i mirë, i pastër, i dobishëm, i dashur dhe i çmuar që gjendet mbi tokë.

Uji Zemzem është ujë që Allahu xh.sh. ia dhuroi Haxheres dhe birit të saj, Ismailit a.s., pranë Qabesë së bekuar, në kohën kur Haxherja r.a. po kërkonte ujë duke vrapuar disa herë sa në kodrën Safa dhe sa në kodrën Merve për Ismailin a.s., të cilin e kishte marrë etja nga thatësira.

Haxherja pasi bëri këtë rrugë disa herë mes Safasë dhe Merves, gjatë kthimit për te vendi ku e kishte lënë Ismailin, pa se aty kishte filluar të dalë ujë. Në atë çast, Haxherja menjëherë vrapon për te vendi ku po dilte uji dhe e rrethon me dhe, në mënyrë që të mos ikë uji. Pas kësaj merr një enë dhe e mbush për t'i dhënë të birit të pinte. Ky ujë shuan etjen e Ismailit a.s. dhe prej atëherë e deri më sot buron ende si ujë të cilin Allahu xh.sh. ia ka dhuruar besimtarëve të Tij si shërim për çdo gjë.

Uji Zemzem është ujë i mirë, i pastër, i dobishëm, i dashur dhe i çmuar që gjendet mbi tokë. Pusi i Zemzemit u hap nga vetë Xhibrili a.s., dhe nga uji i tij piu profeti Ismail a.s., ashtu siç e përmendëm më lartë.

Në dy sahihët tregohet se Pejgamberi a.s. i tha Ebu Dherrit, që ndenji në Qabe dyzet ditë rresht pa bukë, duke pirë vetëm ujë Zemzemi: “*Ai është ushqim i mirë.*” Ndërsa Muslimi i shton këtij hadithi pjesën: “*...dhe ilaç për sëmundje.*”

Ibën Maxhe shënon se Xhabir ibën Abdullahu përcjell që Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Uji Zemzem është për çdo gjë që synohet me pirjen e tij.*”

Gjithashtu përcillet, se Abdullah ibën Mubareku njëherë tha: “O Allah! Ibën Muamili na ka treguar se Muhamed ibën Munkediri ka përcjellë nga Xhabiri se Pejgamberi yt a.s. ka thënë: “*Uji Zemzem është për çdo gjë që synohet me pirjen e tij,*

PËRBËRJA KIMIKE E UJIT ZEMZEM - STUDIM KRAHASUES ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË UJIT TË PIJSHËM

Vlerësimi i burimeve ekzistuese të ujit të pijshëm është një temë interesante për shkak të efekteve të tyre të mundshme shëndetësore.

Studimi që është bërë kohëve të fundit i përbërjes së ujit Zemzem, të marrë nga rubineti dhe në shishe, duke krahasuar cilësinë e tij sipas udhëzimeve ndërkombëtare të ujit të pijshëm ka rezultuar me një përmbajtje të pasur kimike të elementeve biogjene.

Studimi arriti në përfundimin se uji Zemzem ka përbërje kimike të pranueshme duke përfshirë arsenikun – As në nivelin e lejuar, me përjashtim të TDS (Totali i lëndëve të ngurta të tretura) që tejkalon kufirin e lartë të pranueshëm të pazbatueshëm sipas EPA.

Parametri	Njësia	Uji Zemzem nga pusi	Uji Zemzem nga shishja	Kufijtë maksimal të lejuar	
				OBSH	EPA
pH	-	7.65 ± 0.1	7.6 ± 0.1	6.5–9.5	6.5–8.5
T.D.S.	mg L ⁻¹	814.0 ± 13.2	812 ± 14	1000	500
Na	mg L ⁻¹	119.6 ± 17.3	$72.5 \pm 6.8^{**}$	-	-
K	mg L ⁻¹	37.5 ± 4.0	30.8 ± 3.3	-	-
Mg	mg L ⁻¹	20.5 ± 1.7	18.5 ± 1.4	-	-
Ca	mg L ⁻¹	71.5 ± 6.0	74.0 ± 7.3	-	-
Fe	µg L ⁻¹	80.8 ± 5.9	86.5 ± 6.3	300	300
Cu	µg L ⁻¹	1.8 ± 0.4	$1.1 \pm 0.3^{*}$	1000	1300
Zn	µg L ⁻¹	13.7 ± 2.9	10.5 ± 2.1	5000	5000
Cd	µg L ⁻¹	BDL	BDL	3	5
Pb	µg L ⁻¹	0.65 ± 0.11	0.54 ± 0.08	50	15
Mn	µg L ⁻¹	1.70 ± 0.22	1.71 ± 0.24	100	50
Al	µg L ⁻¹	28.4 ± 3.3	20.1 ± 2.8	200	200
As	µg L ⁻¹	BDL	BDL	10	10
Cl ⁻	mg L ⁻¹	158.7 ± 7.1	149.5 ± 6.5	250	250
SO ₄ ⁻²	mg L ⁻¹	110.8 ± 15.8	96.5 ± 13.0	-	250
HCO ₃ ⁻	mg L ⁻¹	177.2 ± 10.8	184.0 ± 11.6	-	-
PO ₄ ⁻³	mg L ⁻¹	0.11 ± 0.02	$0.06 \pm 0.01^{*}$	-	-

Pusi i Zemzemit është rreth 30,5m i thellë me diametër nga 1,08 deri në 2,66m. Pusi ndodhet tani në katin e parë të rrethuar me pllaka xhami që lejojnë një pamje të qartë të brendshme. Uji tërhiqet nga pompat elektrike për t'u bërë i disponueshëm në çeçmat e shpërndara në zona të veçanta në xhami.

Në vitin 1976, Shoqata Amerikane e Burimeve Ujore, botoi artikullin e parë ndërkombëtar rreth përbërjes kimike të ujit Zemzem. Për këtë temë u kryen edhe studime të tjera dhe rezultatet ishin kontradiktore, veçanërisht në lidhje me arsenikun. Shkencëtari Basem Shomar, në analizën që i bëri ujit Zemzem, gjeti nivele të larta të arsenikut (As), nitrateve (NO₃⁻), kalciumit (Ca) dhe kaliumit (K) në mostrat e ujit Zemzem të mbledhura nga haxhilerët pas kthimit të tyre nga Meka.

Në vitin 2011, lajmet e BBC njoftuan në mënyrë interesante shitjen e paligjshme të ujit të pijshëm Zemzem të kontaminuar me arsenik në dyqanet e Mbretërisë së Bashkuar Arabe.

Anasjelltas, anketa gjeografike saudite thotë se ka një qendër të dedikuar (Qendra e Studimeve dhe Kërkimeve të Zemzemit), e cila analizon dhe monitoron mirë pronat e Zemzemit. Alfadul dhe Khan konfirmuan se përqendrimi i arsenikut ishte brenda kufijve të pranueshëm të miratuar nga komitete të ndryshme.



Megjithatë, studimet shkencore mbi ujin Zemzem janë të pakta dhe ky studim i fundit ka të bëjë me eksplorimin e përbërjes kimike të ujit Zemzem.

Të gjitha matjet u kryen sipas protokolleve APHA.

PH u mat duke përdorur pH metër dixhital, totali i lëndëve të ngurta të tretura (TDS) u përcaktua me metodën gravimetrike. Kationet kryesore (Natriumi-Na, Kaliumi-K, Mangnezi-Mg dhe Kalciumi-Ca) dhe elementët gjurmë (Hekuri-Fe, Bakri-Cu, Zinku-Zn, Kadmiumi-Cd, Plumbi-Pb, Mangani-Mn, Alumini-Al dhe Arseniku-As) u përcaktuan sipas metodës standarde (APHA 3120) me emetim plazmatik-optik të çiftuar në mënyrë induktive.

Kromatografi jonik ICS-2000 (Thermo Scientific, Waltham, MA, USA) i pajisur me kolonën Dionex Ion Pac AS 14 është përdorur për përcaktimin e klorureve-Cl⁻ dhe sulfatëve-SO₄⁻².

Bikarbonati-HCO₃⁻ u përcaktua me procedurën e titrimit sipas metodës standarde APHA 2320. Për përcaktimin e fosfatëve-PO₄³⁻ u përdor metoda e acidit askorbik (APHA 4500 P-E). Analiza e tretësirave standarde dhe mostrave u krye në tre kopje. Të dhënat u shprehën si Mesatarja ± devijimi standard (SD).

Përqendrimet e të gjithë analitëve së bashku me standardet e ujit të pijshëm të OBSH dhe EPA janë paraqitur në tabelën 1. Të gjithë parametrat ishin brenda kufijve të pranuar të institucioneve ndërkombëtare, përveç TDS që ndikojnë vetëm në shijen e ujit dhe nuk kanë ndikime të rëndësishme shëndetësore. Vlerat mesatare të TDS ishin 814 dhe 812 mg L⁻¹ në mostrat e mbledhura dhe të ambalazuara.

Nga ana tjetër, përqendrimet e As dhe Cd në të gjitha mostrat ishin (3.3 dhe 0.2 µg L⁻¹ për As dhe Cd, që janë më të ulëta se standardet e OBSH dhe EPA. Kjo tregon se përqendrimet e As dhe Cd në të gjitha mostrat e analizuar janë gjithashtu nën kufijtë e maksimal të lejuar të OBSH dhe EPA.

Tabela 1. Përqendrimet e të gjithë analitëve së bashku me standardet e ujit të pijshëm të OBSH dhe EPA në ujin Zemzem.

Studimi u krijua për të ardhur deri te një përfundim në lidhje me mendimet e ndryshme rreth sigurisë së ujit Zemzem dhe për t'u dhënë siguri miliona myslimanëve që pinë pak nga ai ujë i bekuar. Rezultatet e këtij studimi treguan se përbërja kimike e ujit Zemzem është e pranueshme sipas udhëzimeve të OBSH dhe EPA për ujin e pijshëm.

Studimi tregoi se përqendrimet e arsenikut-As ishin nën kufirin instrumental të zbulimit në të gjitha mostrat e ujit Zemzem (mostrat e ambalazuara dhe të mbledhura nga rubineti). Përqendrimi i arsenikut në ujin Zemzem pati rezultate kontradiktore në literaturë. Në studimin e tij të mirë-projektuar, Basem Shomar, raportoi nivele të larta arseniku (përqendrimi mesatar = 27 µg L⁻¹) në mostrat e ujit Zemzem që u sollën ose u shitën në Gjermani. Nga ana tjetër,

Al-Barakah, raportuan për nivelet e arsenikut që janë brenda kufijve të lejueshëm [0,006–7,728] në ujin Zemzem të mbledhur dhe analizuar në Arabinë Saudite. Dallimet midis studimeve mund të shpjegohen nga shumë faktorë duke përfshirë dallimet në metodat laboratorike të përdorura për analizën e ujit si dhe në materialin e përdorur për shkak të mostrave të ndryshueshme të ujit dhe mënyrave të grumbullimit. Përveç kësaj, është e mundur që përqendrimi i arsenikut në ujin Zemzem është dinamik duke u ndikuar nga aktivitetet civile në afërsi të pusit.

Studimi tregon se uji Zemzem ka një profil të pranueshëm kimik. Megjithatë, nevojiten studime më të mëdha për përbërjen e tij. Përveç paragjyqimeve që do të ndikojnë në studimin e një lënde të tillë fetare dhe shpirtërore, edhe faktorë të tjerë mund të ndikojnë në rezultatet e studimeve të ujit Zemzem. Këto përfshijnë shumë destinacione të ujit Zemzem, metoda të ndryshme të analizës dhe aktivitete të mëdha civilizuese rreth pusit. Prandaj, shpallja periodike e rezultateve të analizës së ujit Zemzem nga autoritetet lokale pritet të jetë mënyra më e saktë për të eksploruar natyrën e ujit Zemzem.

Referencat

- Shahzad G., Rehan R., Fahim M. Rapid performance evaluation of water supply services for strategic planning. *Civil Engin. J.* 2019;5(5):1197–1204. [Google Scholar];
- Mjekësia e Pejgamberit (s.a.u.s.) - Ibn Kajim El-Xhezuije;
- Hussain T.S., Al-Fatlawi A.H. Remove chemical contaminants from potable water by household water treatment system. *Civil Engin. J.* 2020;6(8):1534–1546. [Google Scholar];
- Zamzam Studies and Research Centre Saudi geological survey. <http://www.sgs.org.sa/Arabic/zamzam/Pages/default.aspx>;
- The ministry of hajj and umrah (pilgrimage) <https://www.haj.gov.sa/ar/InternalPageCategories/Details/49>;
- Holy Bible NIV . 1978. NIV® Copyright ©1973. 1984, 2011 by Biblica. [Google Scholar];
- Khalid N., Ahmad A., Khalid S., Ahmed A., Irfan M. Mineral composition and health functionality of zamzam water: a review. *Int. J. Food Prop.* 2014;17(3):661–677. [Google Scholar];
- Al-Ansi S.A., Othman A.A., Al-Tufail M.A. Bromate pollutant in ozonated bottled Zamzam water from Saudi Arabia determined by LC/ICP-MS. *J. Environ. Sci. Healt. Part A.* 2011;46(13):1529–1532. [PubMed] [Google Scholar];
- Shomar B. Zamzam water: concentration of trace elements and other characteristics. *Chemosphere.* 2012;86(6):600–605. [PubMed] [Google Scholar];
- Alfadul S.M., Khan M.A. Water quality of bottled water in the kingdom of Saudi Arabia: a comparative study with Riyadh municipal and Zamzam water. *J. Environ. Sci. Healt. Part A.* 2011;46(13):1519–1528. [PubMed] [Google Scholar];
- Al-Barakah F.N., Al-jassas A.M., Aly A.A. Water quality assessment and hydrochemical characterization of Zamzam groundwater, Saudi Arabia. *Appl. Water Sci.* 2017;7(7):3985–3996. [Google Scholar];
- Lynn G. Contaminated 'zam zam' holy water from Mecca sold in UK. BBC news. <https://www.bbc.com/news/uk-england-london-13267205>;
- Google map. <https://www.google.com/maps/p>

Si mund të arrihet bashkëpunimi shkollë - familje për edukimin moral?

Melihate Zeqiri

Duke qenë se koha që fëmija kalon në shkollë është më e shkurtër se sa koha që kalon në familje, mësuesit e shkollës e kanë të nevojshme mbështetjen e prindërve.

Duan apo nuk duan ata, prindërit janë mësuesit e fëmijës së tyre. Shkolla u jep fëmijëve edukimin që nuk mund ta marrin në shtëpi, por nuk mund ta zëvendësojë kurrësi rolin e prindërve në edukim. Me fjalë të tjera mësuesi plotëson edukimin e prindërve. Për këtë duhet patjetër bashkëpunimi i shkollës me familjen. Komunikimi i vendosur midis familjes dhe shkollës mbështet dhe i shërbejnë zhvillimit të fëmijës. Duke qenë se koha që fëmija kalon në shkollë është më e shkurtër se sa koha që kalon në familje, mësuesit e shkollës e kanë të nevojshme mbështetjen e prindërve. Një familje që siguron mbështetjen e fëmijës bën të mundur suksesin e tij edhe kur gjendja socio-ekonomike mund të mos jetë e mjaftueshme. Duke rritur suksesin në shkollë të fëmijës, edukimin e vlerave kulturore dhe kombëtare, shkolla dhe familja realizojnë objektivin e tyre. Për të arritur objektivin preferohet që këto dy institucione të bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt dhe të përshtatshme¹.

Dërvodeli (2011), në tekstin “Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe”, flet për rolin e familjes për përgatitjen e fëmijëve në nisjen e shkollës. Ai thekson se edukimi i fëmijëve në familje është një parakusht më se i nevojshëm për zhvillimin dhe formimin e drejtë të fëmijës. “Fëmijëve që u ka munguar një edukatë e shëndoshë në familje, janë adaptuar pastaj me vështirësi në mjedise të reja, sidomos në shkollë”².

Ato duhet të jenë në një bashkëpunim të tillë, që të krijojë mjedis të qëndrueshëm dhe krijues, të ekuilibruar, social, të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për të rritur individin. Për të siguruar këtë, si fillim, familja duhet të njoh shkollën dhe pastaj shkolla familjen, për tema të caktuara duhet të jenë bashkëpunues dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën³.

Në monografinë e dr. sc. Afërdita Deva-Zuna: “Edukimi i parashkollorit në familje”, autorja i qaset kryesisht edukimit të fëmijës së moshës parashkollore në gjirin familjar. Meqenëse autorja ka përdorur një numër të madh e literaturë të pasur, duke shfrytëzuar mendimin pedagogjik të pedagogëve e psikologëve më të shquar botërorë, ajo jep një pasqyrë të qartë të vlerës që ka familja në edukimin e drejtë të fëmijës parashkollor. Roli dhe rëndësia e prindërve në zhvillimin dhe edukimin mendor të fëmijëve të moshës parashkollore në familje është i pamohueshëm, duke marrë parasysh plasticitetin, ndjeshmërinë, aftësinë e tyre për të kuptuar shpejt aktivitetin e tyre⁴.

Për të fituar sjelljen e dëshiruar dhe për të pasur sukses fëmija, faktorët si familja, shkolla dhe mjedisi, zënë një vend të rëndësishëm. Familjet që bashkëpunojnë me shkollat duke u interesuar për fëmijën, duke zgjidhur problemet, arrijnë sukses më të madh te fëmija se sa familjet që nuk veprojnë në të njëjtën mënyrë. Roli i bashkëpunimit të familjes me shkollën është jashtëzakonisht i rëndësishëm

në ndikimin që ka shkolla në zhvillimin social, emocional dhe akademik të fëmijës⁵.

Ndjekja e procesit të zhvillimit të fëmijës nga prindërit dhe institucionet arsimore, ndërhyrja kur është e nevojshme, si dhe gjetja e zgjidhjes kur haset një problem arsimor apo sjelljeje, realizojnë qëllimin e dëshiruar të palëve. Prandaj, qëllimi kryesor i shkollës nuk është vetëm ndërhyrja për të pasur sukses akademik, por në të njëjtën kohë duhet të kujdeset që të rrisë një njeri të mirë⁶.

Përgjegjësitë e mësuesit dhe aktivitetet që realizojnë komunikimin me familjen janë këto:

Mësuesi: Modeli i një mësuesi të mirë dhe të zgjuar, që sillet me nxënës me dashuri dhe respekt, mbështet sjelljet pozitive sociale. Është një shembull i mirë, korrigjon sjelljet e dëmshme dhe debatet në klasë. Kur është e nevojshme i udhëzon nxënësit një nga një. Nëse mësuesi u tregon respekt një e nga një nxënësve dhe i mbron një e nga një ata, e ndjenë se ata i japin vlerë dhe përgjegjësi, kështu që, atëherë formohet një komunitet moral.

Rregullat e klasës formohen bazuar te forca e gjykimit moral të nxënësve, ndërkohë që ata u përshtaten rregullave vullnetarisht, shihen raste të respektimit të të tjerëve me sjellje që burojnë nga zhvillimi i karakterit.

Programet mësimore të lëndëve të tjera akademike si: letërsia, historia, shkenca, apo etika sqarohen në mënyrë po aq të pasur sa edhe temat morale, për të mësuar vlerat përdoren mjete të zgjedhura, përmes kësaj kurrikule shpjegohen vlerat universale (Facing, History and Ourselves and The Heartwood Ethics Curriculum)

Nxënësit mësojnë të aplikojnë mendimet e të tjerëve, t'i japin rëndësi pikëpamjeve të të tjerëve, arritjes së qëllimeve të përbashkëta, mësojnë të bashkëpunojnë me qëllim që të punojnë së bashku për të zhvilluar aftësitë.

Për të zhvilluar mendimet morale te nxënësit ata ndihmohen duke lexuar libra, duke bërë kërkime, duke shkruar kompozicione, duke mbajtur ditarë dhe duke zbatuar teknika debati.

Nxënësit mësohen se si të zgjidhin mosmarrëveshjet me qëllim fitimin e vlerave dhe aftësive themelore të moralit.

Për të përvetësuar vlerat që mësojnë në klasë zhvillohen sugjerime të përbashkëta në të gjithë shkollën. Për shembull, drejtori ekzekutiv zhvillon kulturë morale pozitive duke u sjell në përputhje me rregullat disiplinore, tregon qasje komunitare në të gjithë shkollën etj..

Sigurojnë nxënësit dhe familjet e tyre se janë mësuesit e tyre me moral të parë e të rëndësishmit. Zhvillojnë vlerat themelore morale duke afruar mënyra të ndryshme për përmirësimin e vlerave dhe zhvillimin e shoqërisë, rregullave fetare etj. Duke kërkuar edhe ndihmën e medias mundohen



të ndihmojnë familjet dhe bashkësitë në zhvillimin moral dhe të karakterit.

Nëse një mësues sillet në mënyrë të sjellshme, është fisnik, bamirës dhe i respektueshëm edhe familja medoemos e imiton atë. Shkolla, mësuesi dhe familja janë elementë të pashmangshëm në edukimin moral të fëmijës. Nëse do të kishin mundësi, prindërit duhet ta zgjedhin vetë mësuesin e fëmijës së tyre. Duke i kushtuar vëmendje të madhe bashkëpunimit shkollë-familje, prindërit duhet që t'i vizitojnë fëmijët e tyre në shkollë dhe të takohen rregullisht me mësuesin e tyre.

Prindërit nuk duhet t'i neglizhojnë mbledhjet e prindërve, orarin e vajtje-ardhjes në shkollë, shokët apo shoqet më të cilët fëmija shoqërohet, duhet të jenë gjithmonë nën vëzhgimin e tyre. Gjithashtu duhet kushtuar një kujdes dhe vëmendje e posaçme që fëmija i tyre të krijojë raporte konstruktive dhe të drejta me shokët e shkollës, e për çdo sukses që arrijnë duhet të shpërblehen në mënyrën e duhur. Duke mbajtur kontakt me mësuesin duhet të zbatohen porositë dhe propozimet e tij në lidhje me fëmijën⁷.

1 Bandura, A. (2000). Self-Efficacy: The Exercise of Control. W.H. Freeman and Company, New York. Tutkun dhe Köksal, 2000: 220.

2 Dërvodeli, 2011: 38.

3 Oğuzkan dhe Oral, 1997: 105.

4 Po aty: Deva dhe Zuna, 2003: 234.

5 Bey, M. S. (2002). Eğitim ve Toplumsal Sorunlar Üzerine Konferanslar. Ed: Osman Kafadar dhe Faruk Öztürk, Kültür Bakanlığı Yay., Ankara. Rosenblatt dhe Peled, 2002: 349-367.

6 Bacanlı, H. (2006). Duyuşsal Davranış Eğitimi. Nobel Yay., Ankara. Dagget, 2003: 12.

7 Aydın, M. Z. (2012). Ailede Ahlak Eğitimi. Timaş, İstanbul, fq. 183.

Shamia – obligim, liri dhe sfidë

Dr. Violeta Smajlaj

Mbulimi i trupit me veshje dhe i kokës me shami është pjesë integrale dhe obligative e besimit islam. Është një mburojë e intimitetit të femrës nga syri i publikut.

Nisur nga emërtimi, temën do ta shtjelloj duke u përgjigjur në obligueshmërinë e mbulesës edhe në kohët moderne, dhe duke arsyetuar se pse shamia në kohën tonë është liri, por edhe një sfidë.

Pyetja e parë:

PSE MBULESA VAZHDON TË JETË OBLIGIM EDHE NË KOHEN BASHKËKOHORE?

Islami nuk merr në konsideratë vetëm të vërtetën epistemologjike, as vetëm të drejtën ose vetëm etikën, ai bën fjalë edhe për estetikën. Të gjitha këto i vë në një cikël vlerash. Veshja në suaza të besimit islam, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, paraqet një obligim fetar me konsensus të të gjithë dijetarëve të hershëm myslimanë. E meqenëse te gjinia femërore është më e theksuar prirja për zbulim, saqë mund të llogaritet ndër veçoritë psikologjike që kanë femrat, krahasuar me meshkujt, përveç aspekteve të tjera funksionale, ajo që thekson feja është domosdoshmëria e balancimit të animet kah kjo prirje, duke e plotësuar me prirjet tjera psiko-fizike të personalitetit femëror. Prandaj, mbulesa hyn te dispozitat estetike, si aparençë, që luan rolin e saj në etikën e devotshmërisë.

Dëshira për t'u dukur bukur është krejtësisht e natyrshme, megjithatë edukimi që marrim, si dhe kultura e vendit dhe kohës ku jetojmë, kanë rol në zmadhimin e këtij aspekti, aq sa mund ta nxjerrin njeriun

nga të mbajturit e vetes me elegancë deri te të shfaqurit me ekstravagancë.

Nisur nga ky realitet, veshja islame, në radhë të parë, është petk i modestisë dhe privatësisë, që i përgjigjet të gjitha kohërave. Femra në moshë të rritur veshë pjesën më të madhe të trupit, përveç fytyrës dhe duarve, në bindje ndaj Zotit. Lidhur me obligueshmërinë e mbulimit të trupit, duke përfshirë edhe shaminë e kokës, Kurani thotë: *“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin bukuritë e tyre qëllimshëm, përveç atyre që janë të dukshme vetvetiu (fytyra dhe duart), andaj le t'i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre (të kokës).”* (En Nur, 31).

Ky ajet nënkupton se mbulimi i trupit me veshje dhe i kokës me shami është pjesë integrale dhe obligative e besimit islam. Është një mburojë e intimitetit të femrës nga syri i publikut. Sjellja dhe veshja e saj modeste por elegante, shërben si një pengesë e pakalueshme që frenon shikimin e shthurur të meshkujve, i cili tenton të bredhë lirshëm mbi trupin femëror në kërkim të ëndjes.

Lidhur me këtë, Kurani famëlartë thotë: *“O Profet, thuaju grave dhe vajzave tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”* (El Ahzab, 59).

Pyetja e dytë:

ÇKA PARAQET MBULESA PËR NJË GRUA MYSLIMANE?

Nisur nga pjesa e ajetit të sipërpërmendur, ku u tha se “kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët” mund të nënkuptojmë se veshja flet shumë edhe për vlerat identitare të një individi. Veshja, në suaza të vlerave morale që ka një grua, i kujton asaj vlerat e besimit që ajo praktikon, i lë tjetrit përshtypjen se çfarë ajo mund të pranojë apo refuzojë, si dhe jep një mesazh të qartë se nuk toleron ngacmime imorale apo sjellje të pahijshme nga të tjerët, duke i paralajmëruar që të sillen në mënyrë të përgjegjshme ndaj saj. Pra, veshja dinjitoze e një gruaje, reflekton llojin e personalitetit dhe vlerat personale, neutralizon ndikimin e pjesëve femërore atraktive kur është në publik, duke stabilizuar elementet që theksojnë feminitetin vetëm si trup tërheqës dhe nxjerr në pah njerëzoren e gruas se është mendje krijuese e aftë për të punuar, pa u kufizuar nga meshkujt në suaza të pritshmërive biologjike.

Kjo që themi, edhe pse është e vërtetë, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se një femër e pa shami dëshmon për të kundërtën, as nuk është e drejtë të mendojmë apo ta themi këtë, sepse njeriun e dallojnë në radhë të parë qëllimet dhe punët e mira, dashuria për Krijuesin dhe krijesat, solidariteti ndaj njerëzimit dhe bashkatdhetarëve, përkushtimi për të kontribuar në mjedisin ku jeton, veçanërisht në familje. Edhe vetë të mbuluarat me veshje islame mund të kenë qenë pa këtë veshje një kohë të gjatë dhe vazhdojnë të kenë farefis, mikeshë, kolege dhe shoqe që janë ende ashtu. Veshja thjesht reflekton në të jashtmen bindjen që mban zemra për këtë mësim të veçantë të besimit, e nuk nënkupton kurrësi mos prezencë të vetë besimit dhe të moralit.

Pyetja e tretë:

A ËSHTË MBAJTJA E MBULESËS SFIDË NË KOHËN BASHKËKOHORE?

Mund të themi se është sfidë, edhe pse do të duhej të ishte diçka krejtësisht normale në një shoqëri pluraliste, si shoqëria e jonë e pasluftës. Mendoj se mbajtjen e mbulesës e bëjnë sfidë dy gjëra kryesore: a) praktika shtetërore dhe b) qasja mediale paragjyuese (islamofobia).

Praktika shtetërore: Fakti që sot, në shekullin XXI, ende ka shtete që adoptojnë sjellje përjashtuese, rasti konkret në vendin tonë, duke i penguar vajzat e mbuluara nga e drejta e vijimit të mësimin të mesëm, apo e punësimit shkaku i veshjes së tyre modeste, është një akt i ulët e diskriminues, që nuk përkon aspak me realitetin e kohës dhe të instancave drejt të cilave Kosova synon të integrohet. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, bën pjesë të kushtetutat demokratike. Në preambulën e saj, ajo ndërmerr një zotim për ndërtimin e një



shteti demokratik të së drejtës, që do të thotë se qeveriset mbi parimin e sovranitetit të popullit, që në thelb ka pluralizmin e ideve dhe se bazë e kufij të veprimtarisë së tij ka të drejtën, në zemër të së cilës qëndrojnë disa vlera universale të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme.

Këto vlera janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, arsyeja e vetë ekzistencës së kushtetutës, të cilat përbëjnë bërthamën dhe frymën e saj. Në mënyrë të veçantë theksohet liria e besimit dhe e manifestimit të tij si një prej elementëve më thelbësorë në sendërtimin e personalitetit njerëzor.

Të kujtojmë këtu treshen e lirisë fetare: të drejtat, përgjegjësitë dhe respektin:

Të drejtat: Liria fetare është një e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme, e bazuar në dinjitetin e paprekshëm të personit.

Përgjegjësitë: Liria fetare nuk është vetëm një e drejtë universale, por edhe një përgjegjësi universale për të respektuar këtë të drejtë për të tjerët, duke i trajtuar të tjerët ashtu si dëshirojmë të trajtohem vetë. Të gjithë qytetarët duhet të njohin lidhjen e pandashme midis ruajtjes së të drejtave të tyre dhe përgjegjësisë për të mbrojtur ato të drejta për të gjithë të tjerët.

Respekti: Mendimet ndryshe janë pikënisje për të zhvilluar një debat, megjithatë nëse duam të jetojmë me dallimet tona, mënyra se si debatojmë dhe jo vetëm ajo që debatojmë, ka një

rëndësi kritike. Në zemër të një qytetarie të mirëfilltë, është një angazhim i fortë ndaj vlerave qytetare që u mundësojnë njerëzve me perspektiva të ndryshme fetare dhe filozofike të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt dhe civilizim.

Prandaj, bazuar në këto tri parime, duhet shqyrtuar shamia apo shalli i kokës. Tek e fundja, secili kundërshtues mund të pyes veten se çfarë ndryshimi të papranueshëm përbën shalli i kokës prej shallit të hedhur rreth qafës që ai e pranon.

Qasja mediatike paragjyquese (që për fat të mirë është në zbutje)

MBULESA MUNDËSON SHTYPJEN E GRUAS?

Nisur prapë nga pjesa e ajetit të sipërpërmendur “kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët”, del në pah se një grua nuk e vë mbulesën për të qëndruar brenda shtëpisë, sepse në familje të ngushtë nuk ka nevojë të mbahet fare mbulesa, por e vë në publik me qëllim që të vazhdojë ndërtimin e karrierës dhe përmbushjen e synimeve të saja.

Karakteristikë e mbulesës është vetëm mbajtja e elegancës në atë mënyrë veshjeje që reflekton dinjitetin dhe shmang ngacmimin dhe provokimin. Kjo tregon qartë se gratë myslimane nuk duhet të ndihen të penguar apo të paafta në punën e tyre të përditshme dhe të kontribuojnë denjësisht në zhvillimin e shoqërisë dhe vendit, ngase Islami vë theksin te njeriu si qenie humane, e jo te diçka tjetër e lindur si gjinia, ngjyra apo etnia. Femrës i lejohet të ushtrojë detyra edhe jashtë shtëpisë, të punojë dhe të fitojë për nevojat e veta, të

Një shami që gruaja e vë në kokë nuk e bën më perfektë, e as doemos njeri më të drejtë, por, është një rikujtuese e mirë e vlerave të besimit që praktikon

manifestojë publikisht bindjet, të zgjedhë dhe të ushtrojë profesionin që do, në mënyrë që të jetë pjesëmarrëse aktive në jetën publike të shoqërisë.

Islami jep udhëzime të hollësishme që u nevojiten femrave për të ndërtuar karakterin dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre. Diku mbi 300 thënie profetike flasin për ndikimin e faktorit grua në sfera të ndryshme të jetës në kohën e Pejgamberit a.s.. Kjo do të thotë se gruaja që trason rrugën e Profetit a.s. duhet të jetë aktive dhe efektive në çka i shërben zhvillimit shoqëror.

Pra, mënyra se si vishemi, duhet të shërbejë për çlirimin e gruas nga zakonet kufizuese dhe për fuqizimin e rolit të saj në shoqëri.

Shamia u përket shumë kombeve, kohërave dhe feve. Ajo nuk ishte as nuk duhet të jetë simbol i përlules së femrës ndaj mashkullit, por thjesht manifestim i hapur i përkushtimit.

Në shqiptari, si kudo në botë, shamia është mbajtur me mijëra vjet. Ajo është mbajtur nga pellazgët, nga ilirët, nga arbëreshët, mbahet edhe nga ne sot. Në tërë historinë e popullit tonë, ka qenë pjesë e kostumit kombëtar. Në sheshet e qyteteve tona shohim bustin e Nënës Terezë me shami, në kishat e bashkëkombësve tonë gjejmë portretin e të devotshmes Mari me shami. Në muzeun kombëtar, në të gjitha fotografitë e vjetra, si dhe në ekzemplarët e veshjeve tradicionale kombëtare, të të gjitha krahinave dhe besimeve, e gjen shaminë. Nënë Zahide, heroinën tonë që rriti heronjtë e lirisë dhe çlirimit nga okupimi, e kishim me shami. Kjo, ngase populli ynë ka besim të rrënjësor mirë, i njeh dhe çmon vlerat dhe frytet e besimit.

PËR FUND

Për të rrumbullakuar botëkuptimin për mbulesën, them se ky petk i përkushtimit dhe devocionit e ndihmon gruan të mbajë në harmoni bukurinë dhe elegancën me thjeshtësinë dhe modestinë, i jep lirinë dhe komoditetin e nevojshëm për të mbajtur komunikim korrekt me të tjerët, si një qenie e barabartë me të gjithë njerëzit që kanë trup, mendje dhe shpirt, pa patur nevojë të nxjerr në pah më shumë se gjithçka tjetër femnitetin.

Kjo nuk do të thotë se femrat me shami nuk gabojnë si gjithë të tjerat, nuk janë ndryshe prej si motrave të tyre pa shami, as më pak e as më shumë. Një shami që gruaja e vë në kokë nuk e bën më perfektë, e as doemos njeri më të drejtë, por, është një rikujtuese e mirë e vlerave të besimit që praktikon dhe njëherësh e mbanë të vetëdijshme për karakterin që mbanë dhe shembullin moral që konkretizon.



Mësoni nga fëmijët para se t'i mësoni ata!

Dr. Naif Isa Sheda

Prej fëmijëve mësoni këmbënguljen, shpejtësinë në vendimmarrje, zemërbardhësinë, injorimin e të keqes dhe tradhtisë, kureshtjen për dije dhe argëtimin pa hile...!

Ata janë të lumtur në ritmin e tyre, të natyrshëm në sjelljet e tyre. Ai që luan me ta kënaqet skajshmërisht, ata edhe në rast të grindjes, prapë bashkohen dhe ndahen miqësisht.

Shokun që mungon në lojë, e arsyetojnë, ndërsa të pranishmin asnjëherë nuk e paragjykojnë.

Sekreti i buzëqeshjes së tyre është të kënaqurit me atë që atyre ju ofrojmë.

Ata mblidhen pa interes, luajnë për qejf. Nuk i ndan zemërimi. Flenë lehtë kur lodhja i kaplon, dhe gëzohen me më të voglën lojë.

Ata nuk ndihen pesimistë për gjënë e humbur, dhe nuk preokupohen për atë që mund ta humbin. Nuk i dëshpëron e kaluara

Ata duan me seriozitet dhe harrojnë me sinjeritet. Vrapojnë për te ju sa herë që buzëqeshni, dhe largohen nëse me ashpërsi i qortoni.

dhe nuk i preokupon e ardhmja. Qeshin me sinjeritet, kurse qajnë kur padrejtësia i godet. Ata lëndohen lehtë, por kurrë nuk mbajnë inat. Ata harrojnë shpejt kur ju bëhet padrejtësi, dhe falin me shumë lehtësi. Në rikthimin e marrëdhënieve dhe rregullimin e raporteve, nuk gjejnë pengesë dhe vështirësi, përmirësojnë raportet siç kanë qenë, dhe edhe më të mira se ç'kanë qenë.

Mësoni nga ta çiltërsinë e zemrës dhe thjeshtësinë e sjelljes. Merrni nga ta pastërtinë e qëllimeve dhe ruajtjen e fshehtësive!

Ata duan me seriozitet dhe harrojnë me sinjeritet. Vrapojnë për te ju sa herë që buzëqeshni, dhe largohen nëse me ashpërsi i qortoni. I bashkon vendi dhe loja, dhe nuk brengosën nëse kalon koha. Gëzohen me dhurata, nuk ju intereson çmimi dhe as marka.

E njohin mirë vetveten dhe injorojnë ata që duan vetëm vetveten. Përfetojnë çastin me hollësitë e tij, duke mos u thelluar se ç'ka përtej tij. Nuk njohin gjuhën e dredhisë, dhe nuk ju bëjnë përshtypje komplimentet rreth mirësisë. Zemrat i gëzojnë, shpirtrat i qetësojnë, kur mrekullueshëm buzëqeshin dhe qetë komunikojnë. Engjëj njerëzorë i cilësojmë, atë që duan e pranojnë nga të gjithë, edhe atë të cilën të tjerët e injorojnë dhe nuk e pranojnë.

Ata shpresojnë pa ngurrim, japin pa hezitim, pyesin pa ngurrim dhe nuk duan turpërim, mësojnë pa nxitim, reformojnë pa lodhje, hulumtojnë me durim, nuk vrapojnë pas luksit, nuk duan armiqësitë, dhurojnë nga shpirti dhe xhepi, nuk i preokupon ç'shko i dhe ç'mbeti...

Kështu ishte edhe ti dikur, mund të jesh përherë, dhe nuk është e vështirë të kthehesh si atëherë...

Nëse do...!

Përshtati: Ramize Zeqiri - Mehani

Marrë nga revista elektronike "El Jevm", të datës 05.11.2021



Vepra “El Hidaje” e Imam Merginanit

Blerton Bahtiri

Periudha e selxhukëve, nga ana tjetër, u shndërrua në lloj medreseje institucionale. Në këtë periudhë, informacioni i fikhut më së shumti u transmetua nga libri “El Hidaje”. Në Perandorinë Osmane, libri “El Hidaje” mësohej në të gjitha periudhat.


VENDI DHE EMRI I VEPRËS

Libri “El Hidaje” i Imam Merginanit u lshkrua gjatë periudhës Karakhanide. Si vepër, “El Hidaje”, ka një vend të posaçëm në medhhebin hanefi. Nëse flasim për rëndësinë e saj, dihet se libri “El Hidaje” është përdorur si tekst shkollor në medrese, madje edhe në medresetë e shekujve të fundit. Libri “El Hidaje” u mësua jo vetëm në Gadishullin Arabik, por edhe në kontinente të tjera. Për shembull, mësohej në medresetë e Azisë Qendrore. Meqenëse ky libër është shumë i njohur, ai është përkthyer edhe në gjuhë të ndryshme.¹

Libri “El Hidaje” u përdor si tekst shkollor në medresetë osmane për vite me radhë. Disa kanë thënë për “El Hidaje”: “Ai është një libër i vlefshëm me një sekondë të barabartë të kohës së tij”. Për këtë arsye, libri “El Hidaje” u mësua në medresetë selxhuke dhe osmane dhe u bë libri më i rëndësishëm i fikhut. Në periudhën osmane mësohej më së shumti gjatë sundimit të Sulltan Mehmet Fatihut. Pasi Sulltan Fatihu themeloi medresetë sahn-i seman, ai u kujdes personalisht për mësimet e kësaj medreseje dhe u përfshi vetë në program. Këtë libër si burim e përdornin qofshin kaditë apo myfititë. Para se të jepnin një fetva, ata fillimisht shikonin “Hidajen” dhe më pas jepnin një fetva (dekret).²

ARSYEJA E SHKRIMIT

Libri “El Hidaje” është një nga tekstet më të besueshme të fikhut hanefi. Është komenti i “Bidajetu’l-Mubtedi” duke i bashkuar të gjitha çështjet në formë të shkurtuar (Muhtasar) të Imam Kuduriut dhe “Xhami-u’s-Sagir” të Imam Muhamedit. Imam



Merginani r.a. fillimisht filloi të komentojë këtë libër që ne përmendëm, përkatësisht “Bidajetu’l-Mubtedi”, me emrin “Kifajetu’l-Muntehi”, por për shkak se ky koment ishte shumë i gjatë dhe e mërzit lexuesin, ai e la këtë koment dhe kaloi në një koment tjetër. Emri i komentimit ishte “El Hidaje”. Siç dihet, Imam Marginani r.a., përveç Ebu Hanifes, Ebu Jusufit, Imam Muhamedit, Imam Zuferit, Hasan b. Zijad, Ibën Semaa, Imam Tahavi, Imam Kerhi, Imam Xhessas dhe Imam Serahsi, shpesh citon pikëpamjet e Imam Shafiut dhe nganjëherë Imam Malikut. Por jo edhe mendimet e Imam Ahmed b. Hanbelit, ai nuk citoi asnjë mendim të tij. Nëse Imam Marginani sjell mendimin e Imam Shafiut në “El Hidaje”, ai menjëherë më pas sjell mendimin e hanefive.

AUTORËT DHE KOMENTET E VEPRËS

Në literaturën hanefite, “El Hidaje” ka qenë një libër referimi për të gjithë. Nëse flasim për ndikimin e librit, ai filloi nga rajonet e Transoksianës gjeografikisht dhe u shtri në rajonet e Anadollit në Damask, Aleppo, Bagdad.³

1. “Hashijetu’l Hidaje”, autori është Habbazi (v. 691/1292), përmendet në burimet në të cilat Habbazi shqyrton shumë thellësisht metodën e fikhut. Nga ana tjetër, Imam Lekneviu, në librin e tij thekson se Habbazi ka marrë mësim nga Abdulaziz el Buhariu. Ai trajtoi veprat e “El Muğni fi Usuli’l-Fikh”, “Sheerhu’l-Hidaje” dhe “El Hadi fi Usuli’d-Din.”⁴

2. “Kitabu’l Gaje”, autori i saj Shemsuddin Ebu’l-Abbas es-Serugji (v. 710), njihet si gjykatës në Egjipt dhe në të njëjtën kohë ka dhënë fetva.⁵ Serugji më tepër njihet në relacion me gjykatësit dhe gjykatën. Ai sa ishte gjykatës, ishte shumë i guximshëm dhe nuk frikësohej nga askush, nuk pranoi dhurata dhe nuk i kushtoi rëndësi pozitës së tij. Një nga librat e tij më të rëndësishëm ishte “Edebu’l-Kadi.”

3. “Kitabu’n Nihaje”, autori i saj Husameddin el-Husein es-Signaki (v. 738), është jurist hanefi dhe dihet se ai ishte profesor në Meshhed-i Ebi Hanife në Bagdad.

4. “El Vikaje”, emri i plotë i veprës është “Vikajetu’r-Rivaje min Mesaili’l-Hidaje”, Ajo u trajtua nga Mahmut b. Ubejdullah el Mahbubi. “Vikaje”, është një vepër tjetër në shkollën hanefite, autori gjithashtu mori disa nga çështjet që përzgjedhi nga “El Hidaje”. Ekziston një vepër tjetër e këtij autori që e citon Ibën Kutlubuga. Emri i veprës është “El Kifaje.”⁶

5. “Miraxhu’d Diraje”, autori i këtij komenti është Kivamuddin el Kaki ed Dariri (v. 749/1384). Ai ka edhe vepra si “Xhamiu’l Esrar”, “Ujuni’l-Medhheb fi’l-Furui’l-Fikhi’l-Hanefi.”⁷ Vepra është në 4 vëllime dhe jep pamje të sakta dhe të besueshme nga kohërat e mëhershme, të bazuara gjithnjë nga këndvështrimet e Imam Merginanit. Autori e mbaroi këtë vepër në një periudhë prej pesë viteve.⁸

6. “Gajetu’l Bejan”, autori i kësaj vepre njihet si Kivamuddin Emir Katib el Itkani (v. 758/1357). Një nga mësuesit e tij ishte Signaki. El Itkani është një nga dijetarët kryesor të gjuhës arabe dhe fikhut. Ka dhënë mësim në medrese të ndryshme. Ai shërbeu edhe si

gjykatës edhe si myderriz në Bagdad. Meshedi Ebu Hanife u bë një nga medresetë ku punoi. Disa nga veprat e tij të rëndësishme janë këto: “Et Tebjin”, “El Lubab fi Ilmi’l-Hisab”, “Durer” etj.

7. Autori i “El Inaje” është Ekmeluddin Baberti er Rumi (v. 786-1384), një nga juristët hanefi. Fillimisht shkollimin e kreu në Anadoll. Pastaj shkoi në Alepo dhe mori mësim nga mësuesit atje dhe u kthye në Egjipt. Baberti ka edhe komentimin e Imam Bezdeviut. Një vepër tjetër është “Tuhfetu’l Ebrar”. Vlen të përmendet se libri “Inaje” u botua së bashku me librin “Fethu’l Kadir.”⁹

8. “El Binaje fi Sherhi’l Hidaje”, autori i tij është Bedruddin Hafiz el Ajni (v. 855/1451), një nga komentuesit e Buhariut.

9. “Fethu’l Kadir li’l Axhzi’l Fakir”, autori i tij është Ibnu’l-Humam es Sivasi (v. 861/1457). Ibën el Humami nuk ishte i njohur vetëm në fikh, por ai njihej edhe në shkencat e hadithit dhe tefsirit, ai gëzonte një respekt të madh nga dijetarët. Në sufizëm, ai njihej si mësuesi i mësuesve.

10. “Esasu’n Nihaje fi Sherhi’l Hidaje”, autori i këtij libri është Muhamed b. Muhamed el Halebi (v. 880/1405), vepra e tij është në 5 vëllime.¹⁰

VLERËSIMI I PUNËS

“El Hidaje” i Imam Merginanit u popullarizua për herë të parë në kohën e tij. Më pas u bë libër juridik dhe tekst shkollor në medresetë në Anadoll dhe në Perandorinë Osmane dhe vazhdoi për shumë vite në këto rajone. Kur Mevlana erdhi në Konja, ai shkoi në Damask pas vitit 1233 për të mësuar



fikhun hanefi. Dihet se pasi shkoi në Damask, ai lexoi librin “El Hidaje” në medresetë Mukaddime.¹¹

Periodha e selxhukëve, nga ana tjetër, u shndërrua në lloj medreseje institucionale. Në këtë periudhë, informacioni i fikhut më së shumti u transmetua nga libri “El Hidaje”. Në Perandorinë Osmane, libri “El Hidaje” mësohej në të gjitha periudhat. Për shembull, Tashkopruzade u emërua profesor në medresetë Sahn-i Seman në vitin 1539. Sulltani i asaj kohe i kërkoi Tashkopuzade të lexonte “El Hidaje” nga kapitulli “Nikah” deri te kapitulli “Buju”. Përmendet ndër librat që duhen lexuar në tekstin e quajtur “Kanunname-i Talebe-i-Ulum”, i cili thuhet se i përket periudhës së Fatihut, në medresetë Sahn-i Seman midis viteve 1540-1541 dhe 1556-1557.¹²

Për ta përmbledhur, “El Hidaje” u mësua si një libër shkollor në periudhën osmane, përkatësisht në medrese të ndryshme të medreseve Sahn-i-Seman dhe Sulejmanije.¹³

Sipas disa burimeve, gjatë periudhës në Perandorinë Osmane, 5 nga 22 shënimet u bënë në “El Hidaje” dhe 8 në “El Vikaje”, që ishte formë e shkurtuar e përmbledhëse e tij. Sipas këtij burimi, në këtë periudhë janë kryer 13 studime mbi “El Hidaje”. Prandaj, shohim se është punuar shumë në këtë libër gjatë periudhës osmane, por edhe në periudha të tjera. Në të njëjtën kohë, në këtë periudhë u bënë shënime, komente dhe përkthime të ndryshme.¹⁴

Merginani përdor disa shprehje idiosinkratike në veprën e tij. Për shembull, kur përdor fjalën “El Kitab” ka për qellim librin “El Muhtasar” të Imam Kuduriut. Nëse çështja e përmendur nga autori ekziston edhe në “El Xhami’u’s-sagir” dhe në “El Muhtasar”, ai e fillon fjalën me fjalën “kale”. Gjatë regjistrimit të haditheve, ai jep interpretimin e haditheve me shprehjen “el-hadis mahmul ala...” dhe interpretimin e tij me fjalën “nahmiluh”. Ai përdor termat “li-ma bejjenna” për provat racionale që ka përmendur më parë, “li-ma televna” për ajetet, “li-ma revejna” për hadithet dhe “li’l-ether” për fjalën (kavlinë) e sahabëve. Herë pas here, ai përfshin fjalën “li-ma ravejna” si për lajmet (haber) ashtu edhe për punën (ether). “Kale’l-abdu’d-daif” kur shkruante pikëpamjet e veta. Mirëpo, pas vdekjes së tij, kjo shprehje u ndryshua nga studentët tij me shprehjen “kale radijallahu anhi” ose “kale rahimehullâh”. Autori përdori fjalën “kalû” në çështjet për të cilat u diskutua, dhe me shprehjen “meshajihunâ” nënkuptonte dijetarët e Transoksianës rreth Buharasë dhe Samarkandit, dhe me fjalën “fi dijarina” nënkuptonte qytetet e Transoksianës (Maveraunnehir).¹⁵

Libri “El Hidaje”
u shkrua
saktësisht në një
periudhë prej
trembëdhjetë
viteve. Pasi
Imam Merginani
e shkroi këtë
libër, ai u lexua
në të gjithë botën
pa ndërprerje.

PËRFUNDIM

Imam Merginani jetoi në periudhën e Karakhanidëve. Ai është një nga dijetarët hanefi dhe është i njohur kryesisht për jurisprudencën e tij. Rajoni ku ai lindi dhe u rrit është rajoni Transoksiana. Ky rajon i ka dhënë Islamit shumë juristë. Në fakt, ky rajon është më i njohur për fikhun e tij. Imam Bezdevi, Imam Serahsi, Imam Xhessas etj., janë dijetarë nga kjo trevë. Për këtë arsye, Imam Merginani u edukua në një gamë të gjerë njohurish.

Meqenëse stërgjyshërit e Imam Merginani ishin edhe juristë, Imam Merginani e kishte të lehtë t’i takonte këtyre shkencave. Imam Merginani mori mësim nga juristët e famshëm të asaj periudhe dhe vetë kontribuoi në formimin e dijetarëve shumë të përzgjedhur.

Imam Merginani dha vepra të rëndësishme në fushën e fikhut dhe disa nga veprat e tij kanë arritur deri në ditët tona. Disa janë të botuara dhe disa dorëshkrime (të shkruara me dorë). Libri “El Hidaje” u shkrua saktësisht në një periudhë prej trembëdhjetë viteve. Pasi Imam Merginani e shkroi këtë libër, ai u lexua në të gjithë botën pa ndërprerje. Mësohej kryesisht në medrese midis shekujve XII dhe XVI. Libri “El Hidaje” njihet kryesisht si libër që mbulon pikëpamjet e medhhebit hanefi dhe në të njëjtën kohë shfaqet si një libër që mbron medhhebin duke dhënë dëshmitë e tij. Herë pas here jep edhe pikëpamjet e medhhebeve të tjera.

1 Çelebi, fq. 227-228, Leknevi el-fevaidu’l-behiyye, f. 141-144.

2 İsmail Hakkı, Uzunçarşılı, Osmanlı Devleti’nin İlmiye Teşkilatı, (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1988), f. 22.

3 Kâtip Çelebi, vell. II, 2032-2038. Bunlardan meşhur olan bazılarının müelliflerinin vefat sırasına göre eseri hakkında bilgi vermeye gayret ettik.

4 İbn Kutluboğa, a.g.e., f. 47.

5 Subki Taduddin Ebu Nasr Ebu Abdullah b. Alib. Abdulkafi, Tabakatü’s-Safiiyyeti’l-Kubra, (I-VI), 1964, II, 195-199 Taşköprüzade, vell. II, f. 267.

6 İbn Kutluboğa, a.g.e., f. 71.

7 Kâtip Çelebi, vell. II, 2033.

8 Taşköprüzade, vell. II, f. 270; Zirikli, vell. II f. 265; Kehhale, vell. XI, f. 189.

9 Kâtip Çelebi, vell. I, f. 112; Brockelmann, I, 1, 460.

10 Kâtip Çelebi, vell. II, 2036.

11 Safi Arpaguş, “Mevlâna Celaleddin Rumi (1207-1273)”, İSTEM: İslam Sanat, Tarih, Edebiyat ve Musikisi Dergisi, 2007, vell. 5, nr. 10, f. 94-95.

12 İhsan Fazlıoğlu, “Türk Felsefe-Bilim Tarihi’nin Seyir Defteri (Bir Önsöz)”, Divan İlmî Araştırmalar Dergisi, 2005/1. nr. 18, f. 15-31.

13 Cahid Baltacı, XV. ve XVI. Asırlarda Osmanlı Medreseleri, İstanbul: İrfan matbaası, 1976, f.41; Uzunçarşılı, f. 28; Ulusoy, a.g.e., f. 71-72.

14 Ulusoy, a.g.e., f. 73.

15 Taşköprüzade, Miftâhu’s-sa’âde, vell. III, f. 265-266.

Një burim i rëndësishëm për të kaluarën e Islamit dhe myslimanëve të vendeve tona


(Raport Mexhlisi i Ulemave të Shkupit 1938-1940, Logos-A, Shkup, 2022, f. 368)

Nuridin Ahmeti

Në kuadër të botimeve të Shtëpisë Botuese “Logos-A” me qendër në Shkup, këto ditë ka dalë nga shtypi libri “Raport Mexhlisi i Ulemave të Shkupit 1938-1940”.

Gjatë viteve 1914-1918, bota u përball me Luftën e Parë Botërore. Të radhitura sipas interesave të tyre gjeopolitike, disa shtete të kohës krijuan dy blloqe të njohura politike e ushtarake, bllokun e Antantës ku bënë pjesë shtetet Britania, Franca dhe Rusia dhe blloku Trepalësh, ku bënë pjesë Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia. Siç dihet kjo luftë përfundoi me fitoren e Antantës. Serbia në këtë luftë ishte orientuar në krahun e Antantës dhe, me sugjerimin e shtetit mik të saj, Francës, ajo (Serbia) bashkë me Rumaninë dhe Çekoslovakinë e formojnë aleancën e përbashkët politike dhe ushtarake të njohur si Antanta e Vogël. Ndërsa, në vorbullën e këtyre ngjarjeve Shqipëria, rrjedhimisht edhe shqiptarët kishin zgjedhur neutralitetin.

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, u shuan edhe dy perandoritë e njohura të kohës, Perandoria Osmane dhe Austro-Hungareze. Rrjedhimisht, edhe tokat që ishin në ombrellën e këtyre perandorive mbetën nën mëshirën e fuqive të kohës. Tokat shqiptare, të cilat për një periudhë të gjatë ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe disa nga territoret shqiptare për një periudhë të shkurtër ishin nën sundimin Austro-Hungarez, tani mbetën pa zot shtëpie, të cilat më pas dhe hynë në pazarin e shteteve të fuqishme evropiane, posaçërisht të atyre që ishin fituese të Luftës së Parë Botërore. Tokat shqiptare, tanimë u bënë pre e shteteve fqinje, të cilat në forma të ndryshme, ushtarake etj., u zgjeruan në territoret e tokave shqiptare. E orientuar në krahun e shteteve fituese të luftës, Serbia e asaj kohe shpërblehet me formimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, e cila u shpall në dhjetor të vitit 1918. Territoret e sotme të Kosovës, tokat shqiptare në Maqedoninë e sotme të Veriut, Lugina e Preshevës dhe tokat shqiptare në Malin e Zi të sotëm, u pushtuan nga kjo mbretëri, i cili pushtim kishte edhe pasojat



demografike, etnike, kulturore etj., sidomos për shqiptarët që jetonin në këtë mbretëri. Në vitin 1919 u miratua Kushtetuta e parë e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, e kjo nënkupton se u bë edhe rregullimi i ri administrativ në këtë mbretëri. Duhet potencuar, se gjatë ekzistimit të kësaj mbretërie, 1918-1941, ka pasur disa herë ndryshime në aspektin administrativ e juridik. Rregullimet administrative, pasuan edhe me rregullimet ligjore dhe administrative në aspektin fetar. Nga të dhënat rezulton se në kuadër të kësaj mbretërie, “u formuan dy organizata të komunitetit mysliman, Bashkësia Fetare Islame e Bosnjës e Hercegovinës, e cila pati një autonomi të plotë që buronte nga Kushtetuta e sjell që nga koha e

Perandorisë së Austro-Hungarisë. Qendra e saj ishte Sarajevë, ndërsa me të udhëhiqte Reis-ul-Ulemaja dhe, Myftinia Supreme, në kuadër të së cilës përfshihej komuniteti mysliman i Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Sanxhakut. Qendra e saj ishte Beogradi, ndërsa me të udhëhiqte kryemiftiu, i cili njihej si myftiu suprem. Për dallim nga BFI-ja e Bonjës e Hercegovinës, Myftinia Supreme, ishte nën varësi të plotë të Qeverisë së SKS-së, përkatësisht të Ministrisë për Fe. Veprimtaria e saj mbështetej mbi një Rregullore të miratuar gjatë vitit 1919, e cila në vitin 1920 kaloi në Ligj. Sipas dispozitave të asaj rregulloreje, i tërë pushteti ishte koncentruar te kryemyftiu, dhe myftitë e qarqeve e të rretheve të cilët emëroheshin nga ana e ministrit për Fe”.¹

Në vitin 1930, pas disa ndryshimeve erdhi deri te bashkimi i BFI-së “në Mbretërinë Jugosllave, përkatësisht nga dy organizata sa ekzistonin deri në atë periudhë, u krijua një udhëheqje e përbashkët, që ndryshe quhej Udhëheqja Supreme e BFI-së, selia e së cilës kaloi në Beograd. Në kuadër të saj u formuan dy mexhlise të ulemasë me të drejta dhe kompetenca të barabarta: Mexhlisi i Ulemasë së Shkupit dhe Mexhlisi i Ulemasë së Sarajevës, që

Ulema Mexhlisi është organi kryesor përmes të cilit kryhet administrimi dhe mbikëqyrja e jetës së gjithmbarshme fetare islame, arsimore dhe kulturore. Sipas nenit 81 të Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame.

përbëheshin prej tre anëtarëve. Udhëheqjen Supreme e përfaqësonte Reis-ul-Ulemaja, ndërsa Mexhlisin e Ulemasë kryetari. Zgjedhja e Reis-ul-Ulemasë, kryhej nga Bordi të cilin e përbënin të gjithë anëtarët e Mexhlisit të Ulemasë në Sarajevë dhe Shkup; të gjithë myftitë; të gjithë anëtarët e Gjyqit Suprem të Sheriatit, Gjimnazit të Sheriatit në Sarajevë dhe Medresesë së Madhe “Kral Aleksandri i I” në Shkup; referenti i Fesë Islame pranë Ministrisë së Ushtrisë dhe Marinës, ministrat aktiv”.² Një mënyrë e tillë e funksionimit të BFI-së, i garantonte pushtetit të atëhershëm serb që përmes këtij institucioni edhe më tej ta mbante nën kontroll të plotë tërë popullsinë myslimane, në radhë të parë atë shqiptare.

Mehmet Spaho, si lider i “Organizatës së Myslimanëve të Jugosllavisë”, në vitin 1936, në bashkëpunim me qeverinë e Stojadinoviqit, bëri disa ndryshime në organizimin e brendshëm në BFI, si miratimi i Kushtetutës së re, selia e Reis-ul-Ulemasë të zhvendoset nga Beogradi në Sarajevë, hapja e një medreseje tjetër në Shkup nga ajo e “Kral Aleksandrit I”, e cila do të ishte Medreseja e njohur “Gazi Isa Beu” dhe organizimi i zgjedhjeve të lira.³ Ndryshimet e lartcekura, siç duket do të jenë edhe në favorin e veprimtarëve shqiptarë të kohës, sepse u përkrahen nga njerëzit me ide nacionaliste që vepronin brenda Ulema



Mexhlisit dhe Ferhat Draga, veprimtari i njohur, u caktua për kontakte me liderin e OMJ-së. Sipas marrëveshjes Spaho-Stojadinoviq, zgjedhjet u mbajtën, Kushtetuta e re u aprovua dhe pas disa muajve hyri në fuqi.⁴

Sipas zgjedhjeve të lira të organizuara nga Ulema Mexhlisi i Shkupit, në maj të vitit 1937, lista e përfaqësuar nga Ferhat Draga rezultoi fituese, jo me shumicë votash, përball listave të Ataullah ef. Kurtishi dhe Fejzi Haxhiamziqit, ky i fundit cilësohej me prirje pro qeveritare të kohës. Duke qenë se Ferhat Draga nuk e fitoi shumicën e anëtarëve të Ulema Mexhlist dhe për shkak të prirjeve jo të drejta të Fejzi Haxhiamziqit, Ferhat Draga hynë në marrëveshje me listën e Ataullah ef. Kuritshit, ku bënte pjesë edhe veprimtari e patrioti i njohur Mulla Idriz Gjilani. Pra, Ulema Mexhlisi në këtë periudhë u fut në menaxhimin e krahut nacionalistë shqiptarë të dëshmuar për veprimtarinë e tyre fetare e kombëtare dhe ky veprim sigurisht nuk do të shihej më sy të mirë nga pushteti i atëhershëm. Konstituimi i udhëheqjes së re të Ulema Mexhlistit të Shkupit, solli emra të dëshmuar në veprimtarinë e tyre në çështjen tonë kombëtare, si: Ferhat bej Draga, Ibrahim Lutfiu, Kadri Salihu, Asim ef. Luzha, Mustafa Dërguti, Sherif ef. Langu, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef. Hamidi, Mulla Idriz Hajrullahu – Gjilani, Azem ef. Latifi, Iliaz Agushi, Shaban ef. Jashari, Sefedin Mahmutbeu, Abdullah Musliu etj., të cilët përmes këtij institucioni u kujdesën për të mirën e pasurisë materiale, shpirtërore e kombëtare të popullit që i shërbenin. Udhëheqja e re e këtij institucioni dukej kështu: Ferhat Draga, kryetar i Kuvendit Vakëf Mearifit; Kadri Salihu udhëheqës i Këshillit i Kuvendit dhe anëtarët: Qemal Osmani, Sefedin Mahmutbeu, Zenel Strazimiri dhe Xhevat Mahmutbeu.⁵ Brenda organizimit të Ulema Mexhlistit, veprimtari edhe Mexhlisi i Ulemasë, me këtë përbërje: hfz. Sherif Langu, kryetar, Ataullah ef. Kurtishi, Idriz ef. Hajrullau dhe Bedri ef. Hamidi.⁶ BFI zgjodhi edhe udhëheqjen e lartë apo Reis Ulemanë Fehim ef. Spaho, anëtar i dëshmuar i Ulema Mexhlistit të Sarajevës, ndërsa sekretar u vendos Ibrahim Lutfiu, njeriun i cili ishte dëshmuar me veprimtarinë e tij atdhetare dhe i cili përfaqësonte Ulema Mexhlinin e Shkupit.

Duke e respektuar hierarkinë e mësipërme, Ulema Mexhlisi i Shkupit, në përputhshmëri me kushtetutën e atëhershme të BFI-së, në vitin 1940 i nis raportin të cilin Shtëpia Botuese Logos-A me qendër Shkup, po ua vë në dispozicion të përkthyer nga gjuha serbe. Raporti përfshinë punën e këtij institucioni për periudhën nga korriku i vitit 1938 deri në janar të vitit 1940.

Me pak fjalë, detyra e këtij institucioni përshkruhet në këtë formë. “Ulema Mexhlisi është organi kryesor përmes të cilit kryhet administrimi dhe mbikëqyrja e jetës së gjithmbarshme fetare islame, arsimore dhe kulturore. Sipas nenit 81 të Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame (f. 9)”.

Raporti në fjalë, përshkruan gjendjen e myslimanëve të cilët përfshiheshin në kuadër të Ulema Mexhlistit të Shkupit. Në raport paraqiten në mënyrë të detajuar, aq sa e lejonin rrethanat politike të kohës, pasqyra statistikore të popullatës myslimane, të dhëna për xhamitë, teqetë dhe gjendjen e tyre, përshkruan gjendjen e varrezave myslimane, objekteve të vakëfeve, kuadrin fetar, nëpunësit e xhamive, imamët, organet dhe institucionet fetare e arsimore, mësuesit fetar nëpër shkollat shtetërore, organizimin e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Ulema Mexhlistit në Shkup, administrimin dhe mbikëqyrjen e jetës shoqërore islame, kulturore etj.

Ky raport, siç mund të shihet edhe nga periudha kohore që përfshinë, bëhet fjalë për vite mjaft tronditëse dhe me pasoja në historinë e njerëzimit, pra është fjala për fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Andaj, edhe nëpunësit, të cilët i kanë tubuar këto të dhëna, sigurisht se kanë pasur sfidat e tyre. Edhe vetë përgatitësit e raportit, nuk lënë pa i potencuar sfidat me të cilat hasin nëpunësit fetarë gjatë mbledhjes së të dhënave në teren.

Pa dyshim se anëtarët e Mexhlistit të Ulemasë së Shkupit: hfz. Sherif Langu, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri Hamidi dhe Mulla Idriz Gjilani, për aq kohë sa qëndruan në krye të Mexhlistit të Ulemasë së Shkupit, dhanë një kontribut të çmuar jo vetëm fetar por edhe kombëtar. Natyrisht, fryma e dashurisë për vendin e tyre që këto personalitetet e reflektonin, do të ndikonte edhe te disa pjesëtarë të tjerë që ata kishin kontakt përmes pozitës që e mbanin. Një pjesë e imamëve që Ulema Mexhlisi i Shkupit do t'i emërojë për të shërbyer, dhe siç dihet disa prej tyre, do të jenë figura të njohura kontribuuese në organizatat nacionaliste ndërmjet dy luftërave botërore, si në: Xhemijet, Ballin Kombëtar, Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare etj.

Ky raport, është me interes për të kaluarën tonë, sepse ka shënime dhe faktografi të panjohura deri me tani apo pak të njohura, për vendet që i mbulonte Ulema Mexhlisi i Shkupit dhe për këtë është me interes.

Për studiuesit e historisë; sepse ka të dhëna të konsiderueshme për personalitetet që kanë kontribuar në jetën tonë shoqërore e politike, në këtë periudhë, mënyra e përvetësimit të disa pronave nga pushteti i atëhershëm dhe siç dihej, ky aspekt ishte njëra nga arsytet që popullata u detyra t'i lëshojnë vendet e tyre. Të theksojmë këtu se, reforma agrare, e cila ishte shkaku kryesor i varfërimit të të gjithë shtresave të myslimanëve dhe që i nxiti në shpërngulje, la pasoja edhe më të mëdha. Përveç që ishte një zgjidhje jo fatlume, u zbatua në mënyrë shumë të egër, duke e proletarizuar një numër shumë të madh të myslimanëve, kurse familjet e tëra myslimane i solli në varfëri të skajshme (f. 24-25)”.



Ky dokument,
i botuar në
formë libri
prej 368
faqesh, është
zbuluar nga
studiuesi,
Qerim Lita,
gjatë punës së
tij
shumëvjeçare
hulumtuese-
kërkimore në
Arkivin
Shtetëror të
Republikës së
Maqedonisë së
Veriut në
Shkup.

Për studiuesit e historisë së arsimit; sepse do të hasim shënime për shkollimin, mungesën e shkollimit fillor në disa zona, mos interesimin e pushtetit për të hapur shkolla, funksionimi i mejtepeve dhe medreseve etj., “Vlen të theksojmë se, nëpër vendbanimet myslimane, thuhet në raport, shumë rrallë hapen shkolla apo klasa të reja, prandaj konstatojmë që duhet dorëzuar ankesa edhe deri tek autoritetet përkatëse që t’i kushtojnë vëmendje më të theksuar edhe shkollimit dhe ngritjes arsimore të banorëve myslimanë përmes ngritjes së shkollave nëpër vendbanime ku jetojnë ata (f. 28).” Ulema Mexhlisi i Shkupit ishte përgjegjës edhe për dy medresetë që funksiononin në këtë periudhë në Shkup, Medreseja e Madhe “Kral Aleksandri I” dhe Medreseja e Gazi Isa Beut, nga ku dolën kuadro të njohura edhe shqiptare, sidomos kjo e dyta, e cila nxori personalitete të shquara të

organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, si: Kadri Halimi, Azem Marana, Ilmi Ejupi, Abdullah Musliu, Hasan Bilalli etj..

Për studiuesit e demografisë; sepse do të gjejmë shënime interesante për regjistrimet e xhematëve, numrin e tyre etj., “pasi u mbledhën të dhënat, ato u përpunuan dhe, në bazë të rezultateve mund të konkludojmë: në bazë të regjistrimit të kryer nga ana e imamëve të mexhliiseve numri i përgjithshëm i romëve në këtë anë është rreth 60.000 (f. 305)”.

Për studiuesit e sociologjisë; sepse përshkruhet jeta shoqërore e banorëve të kësaj ane, mënyra e jetesës, marrëdhëniet ndër shoqërore të myslimanëve me disa pjesëtarë të komuniteteve tjera fetare etj.. “Vlen të theksohet se, numri i shkurorëzimeve të martesave të përziera është shumë i theksuar madje duke e tejkaluar edhe numrin e kurorëzimeve që u lidhën më vitin 1939, kështu që, pas çdo dy kurorëzimeve të martesave të përziera pasojnë tri shkurorëzime dhe tërë kjo flet për dëmin dhe jonatyrshmërinë e kësaj të keqe (f. 44)”.

Ky material përmbillet me këto fjalë “Raporti i dorëzuar mbi punën e Ulema Mexhlistit në Shkup për periudhën prej 1 korrik 1938 deri më 1 janar 1940, është pranuar në mbledhjen e Ulema Mexhlistit në Shkup, më 4 maj të vitit 1940, me numër 5810/40 (f. 340)”. Kjo nënkupton, se të dhënat e ardhura nga bashkëpunëtorët e Ulema Mexhlistit nga tereni, janë përpunuar, i janë nënshtruar diskutimit të anëtarëve të Ulema Mexhlistit dhe më pas është dërguar në destinacionin e caktuar.

Ky dokument, i botuar në formë libri prej 368 faqesh, është zbuluar nga studiuesi, Qerim Lita, gjatë punës së tij shumëvjeçare hulumtuese-kërkimore në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Shkup. Ky dokument, i cili i ka munguar studiuesve tanë deri me sot, tani po u mundësohet që ta kenë në duar jo vetëm studiuesit, por edhe të tjerët të interesuar, dhe kjo realizohet falë gatishmërisë që ka treguar shtëpia e njohur botuese “Logos-A” me qendër në Shkup në krye me drejtuesin prof. dr. Adnan Ismailin, andaj kur është fjala për botimin e literaturës së rrallë ky personalitet meriton mirënjohje.

Dhe krejt në fund, me lejoni të them, se kushdo që merret me të kaluarën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, për periudhën që kap ky botim, këtë dokument-raport do të duhej ta kishte si literaturë bazë.

- 1 Qerim Lita, “Vakëfet e Mexhlistit të Ulemasë në Shkup në harkun kohor 1919-1941”, *Institucioni i Vakëfit në hapësirën ballkanike*, Alsar, Tiranë, 2021, f. 328.
- 2 Po aty, f. 336.
- 3 Qerim Lita, “Zgjedhjet e vitit 1937 konform Kushtetutës së BFI-së të vitit 1936 në Mexhlinë e Ulemasë së Shkupit”, *80 vjet të Kushtetutshmërisë së BFI-së*, BFI, Shkup 2017, f. 15-16.
- 4 Po aty, f. 16.
- 5 Po aty.
- 6 Qerim Lita, “Vakëfet e Mexhlistit të Ulemasë...”, f. 338.

Rëndësia e mektebit në frymën e duhur islame

Dr. Azmir Jusufi

Mektebi është institucioni themelor edukativo-arsimor që ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Mektebet e para, së bashku me xhamitë, ishin simbol i njohur i lagjes së caktuar. Nga shkollat e para fetare brenda sistemit shkollor për fëmijët myslimanë, mektebet gradualisht u rritën në shkolla që ishin pjesë e sistemit zyrtar. Pas shfuqizimit të këtyre shkollave, mektebet, si institucione të pavarura, filluan jetësimin e tyre të ri nën kujdesin e xhamive ose mesxhideve.

Që nga themelimi i mektebeve të para në vendet tona, roli i tyre është zhvilluar deri më sot në një mënyrë për të përmbushur nevojat edukativo-arsimore të fëmijëve myslimanë dhe Bashkësisë Islame të kësaj zone.

Mektebet kanë qenë veçanërisht të suksesshme gjatë tre shekujve të parë që nga ardhja e Islamit. Në atë kohë, mektebi ishte shkollë private, funksionimi i së cilës varej nga aftësitë materiale të vakëf-dhuruesit. Me dobësimin ekonomik të Perandorisë Osmane, mektebi kaloi vitet e tij të vështira. Një gjendje e tillë rezultoi në idenë e modernizimit të mektebit.

HISTORIKU I MEKTEBIT SHKURTIMISHT

Emri mekteb vjen nga folja ketebe, që ka lidhshmëri me shkrimin, gjegjësisht me të shkruarit.¹ Mektebi është vendi ku dikush mëson të shkruajë. Se sa është e rëndësishme të dihet shkrim-leximi, dëshmon edhe betimi i Krijuesit në Kuranin fisnik: “Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!”²

Duke ardhur në këto hapësira, Osmanët futën një sistem të ri arsimor në të cilin mektebi ishte një formë e shkollës fillore dhe përkrah xhamisë ishte simbol i krijimit të një qeverisje të re. Prandaj termi mekteb, në gjuhën tonë, në fakt, erdhi përmes gjuhës turke. Mektebi, mejtefi ose mehtefi, siç quhej në pjesë të ndryshme, ishte shkolla fillore dhe bazike për myslimanët gjatë sundimit osman në këto troje. Për një periudhë të gjatë kohore, për shumicën myslimane,

veçanërisht për fëmijët e varfër, kjo ishte forma e vetme e arsimit fillor, kështu që përveç lëndëve fetare, mësoheshin edhe lëndë të përgjithshme. Por me ndryshimin e rrethanave shoqërore, u ndryshua edhe forma e mektebit, madje edhe roli i tij brenda sistemit arsimor.³

Në mekteb, paraardhësit tanë morën arsimim të përgjithshëm, mësuat matematikë, gjeografi, histori, gjuhë, por me ndryshimet në shoqëri ai këtë rol të përgjithshëm e humbi dhe u fokusua vetëm në mësimin e fesë dhe urdhrave e riteve fetare. Ai, duke humbur rolin e tij të përgjithshëm, nuk ka humbur asgjë në rëndësi në jetët tona. Përkundrazi, ai mbeti një hap i pazëvendësueshëm dhe një hallkë e domosdoshme në zinxhirin e rrugëtimit jetësor dhe edukimit të fëmijëve tanë.⁴

PREJ KUR DATON MEKTEBI?

Që nga dita e parë e misionit pejgamberik të Muhamedit a.s., ekziston mektebi. Pejgamberi a.s., dhe grupi i ngushtë i sahabëve, harfet e para të

Emri *mekteb* vjen nga folja *ketebe*, që ka lidhshmëri me shkrimin, gjegjësisht me të shkruarit.

Shpalljes dhe rregullat e para të fesë i mësoi në shtëpinë e Erkamit. Në Medine Pejgamberi a.s. i angazhon në mekteb edhe të burgosurit e Bedrit⁵, ku mektebi e fiton rolin e përgjithshëm e të mësuarit të shkrim-leximit, sepse aty, në xhaminë e Pejgamberit a.s., përveç fesë, mësoheshin edhe shkenca të tjera. Në atë mekteb të Pejgamberit a.s., është rritur gjenerata e cila me angazhimin e vetë, edhe sot e kësaj dite, i mahnit njerëzit.

Në ditët e sotme, është detyrimi ynë të kryejmë urdhrin e parë të Zotit, që me kujdes të shtuar t'i përgatisim fëmijët tanë për shkollën e mektebit, sepse kërkimi i njohurive për të gjithë myslimanët e myslimanet është farz (detyrim i prerë). Po kështu, ne jemi të detyruar të bëjmë gjithçka që duhet për të bërë që fëmijët tanë të edukohen në frymën e pastër islame, sepse siç thotë Pejgamberi a.s.: "Nuk mund t'u lësh fëmijëve asgjë më të mirë se një edukim të mirëfilltë".⁶

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: "Edukoni fëmijët tuaj në shenjën e tre cilësive: ta donë Pejgamberin a.s., ta donë familjen e tij dhe të donë që të lexojnë/mësojnë Kuranin!"⁷

Po ashtu, Pejgamberi a.s., ka thënë: "Armiku juaj nuk është njeriu të cilin ju e vrisni në betejë dhe kështu e fitoni titullin gazi/luftëtar,

**Në mekteb
mësohen
rregullat,
dispozitat dhe
ritet e fesë
sonë. Kjo është
e rëndësishme
të dimë sepse
ato nuk na
lejojnë që të
lajthitemi, na
mbrojnë
gjithashtu që
të ecim drejt
dhe me
dinjitet.**

ose ai të vret ty dhe bini si dëshmor dhe e meritoni Xhenetin. Armiku juaj i vërtetë është fëmija i juaj i paedukuar që erdhi nga shtylla kurrizore e juaj. Pastaj, armiku juaj është edhe pasuria e juaj që e keni fituar me duart e veta dhe ajo u bë preokupimi i juaj i vetëm".⁸

RËNDËSIA E MEKTEBIT

Sot, fëmijët arsimohen në shkollë dhe edukohen në mekteb. Shkolla do t'i udhëzojë ata gjatë rrugëtimit të tyre për t'u bërë ekspert në ndonjë fushë të jetës, kurse mektebi do t'i udhëzojë dhe drejtojë ata përgjatë rrugës në të cilën do të edukohen me plot kuptimin e fjalës.

Në mekteb mësohen rregullat, dispozitat dhe ritet e fesë sonë. Kjo është e rëndësishme të dimë sepse ato nuk na lejojnë që të lajthitemi, na mbrojnë gjithashtu që të ecim drejt dhe me dinjitet. Fëmija duhet të mësojë se si falet namazi dhe të mësohet ta ketë si shprehje faljen e tij, sepse namazi është i fuqishëm që ta mbajë njeriun larg nga mëkatimi. Përmes namazit arrihet kontakti i përditshëm me Zotin, duke biseduar me Të, dhe bëhet i vetëdijshëm se nuk ka vend për të shpëtuar nga dija absolute e Zotit. Cili prej nesh nuk do të donte që fëmija i tij të ishte larg



çdo vesi? Secili prej nesh do të donte fëmijë të dobishëm. Ekziston rruga drejt këtij qëllimi. Duhet të nisemi në këtë rrugë dhe të qëndrojmë vazhdimisht në atë rrugë, pa marrë parasysh sfidat dhe telashet që na shfaqen gjatë kësaj rruge.

Prej qëllimeve parimore të mektebit është që të mësohen harfet e Kuranit dhe të dihet leximi i Fjalës së Zotit. Të gjithë do të përballemi me pyetjen se kush ishte udhërrëfyesi ynë në këtë botë? Përgjigja duhet të jetë se udhërrëfyesi (imami) ynë ishte Kurani. Është detyrim yni, të bëjmë gjithçka që mundemi për t'i mësuar fëmijët tanë të lexojnë Shpalljen, të mësojnë Kuranin. Nga Ebu Hurejre r.a., transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kur njeriu vdes, i pushon veprimtaria e tij me vepra të mira, përveç në tre raste: lëmoshë e përhershme, dije të dobishme prej së cilës kanë dobi të tjerët ose fëmijë të mirë që bën dua për të!”⁹

Fëmija që në mekteb “shartohet” dhe do të jetë si një pemë e frytshme me fruta të ëmbla. Frytet janë vepra të mira, kurse nga ato fryte të mira do të kenë dobi edhe vetë prindërit e tij dhe rrethi ku ky do të jeton e vepron, sepse fëmija i edukuar është e mirë e përhershme.

Pejgamberi a.s., u pyet se a pushon detyrimi i fëmijëve për t’iu bindur prindërve pas vdekjes së tyre? Pejgamberi a.s., tha se nuk ndalet dhe se, përveç detyrimeve të tjera, është të kërkojë falje për prindërit e tij. Nëse i mësoni fëmijët të falin namaz dhe të bëjnë shprehi faljen e tij, ata do të lexojnë në namaz çdo ditë: “Rabbenagfir li ve li validejje” – “Zoti ynë, më fal mua dhe prindërit e mi”. Ai do të kërkojë falje dhe do t’ju dërgojë dhurata edhe pas vdekjes suaj. Do të jetë gëzimi i juaj i përjetshëm.

Në e dimë, sepse kështu na mëson Pejgamberi a.s., se disa njerëz kur të ringjallen në botën tjetër do të pyesin, prej nga më kanë ardhur këto vepra të mira, unë nuk i kam sjellë ato me vete? Do t’i përgjigjet atij, fëmijët t’i dërguan dhe dhuruan ato. Po ata fëmijë të cilët rregullisht i dërgove në mekteb dhe vëzhgove mbi edukimin e tyre, ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar në suren Ta-Ha: “Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë”¹⁰.

PËRFUNDIM

Bazuar në të dhënat e ofruara, është e qartë se mektebi është institucion me një traditë të gjatë të Islamit në këto troje. Gjatë shtatë shekujve, mektebi si formë edukimi, shënoi ulje dhe ngritje, ndryshoi formën e tij, përjetoi sfida të ndryshme, mirëpo u bëri ballë atyre dhe kurrë nuk u shua.

Detyra e vendosur përpara kësaj lloj shkolle, për të edukuar dhe arsimuar në frymën e Islamit, ishte herë më e vështirë, herë më e lehtë, varësisht nga rrethanat shoqërore, ekonomike dhe politike, por rëndësia e tij nuk ishte kurrë e papërfillshme.

Duke pasur parasysh faktin se momenti aktual karakterizohet nga një neglizhencë gjithnjë e më e theksuar e përgjegjësive prindërore, roli i mektebit, si një institucion edukativo-arsimor, padyshim që bëhet edhe më i rëndësishëm, kurse kërkesat që vendosen para tij edhe më të shumta.

Mektebi është një nga shtyllat kryesore në aktivitetet e Bashkësisë Islame, sepse bashkon familjen dhe xhematin duke edukuar anëtarët e saj të ardhshëm. Prandaj, familja duhet të mbështesë mektebin në aspektin e përfshirjes së anëtarëve të saj në punën e tij, kurse Bashkësia Islame duhet të njohë specifikat e kohës, në mënyrë që mektebi të plotësojë kërkesat e kohës në mënyrën më të mirë të mundshme.

1 Teufik Muftić, Arapsko-bosanski rječnik, (Sarajevë: El-Kalem, 2017), 1267.

2 Surja El Kalem, ajetet 1-2. Përkthimi i ajeteve nga Haxhi Sherif Ahmeti.

3 Amira Trnka-Uzunović, (Uloga mekteba u historiji obrazovnog sistema Bošnjaka), Novi Muallim, nr. 34, Sarajevë, 2008, 72.

4 Nga web-faqja: <http://dzemat-braunau.at/mekteb-nas-zove/>.

5 Shih në web-faqen: <https://znaci.ba/tekstovi/bitka-na-bedru>; <https://mesihat.org/2017/06/09/bitka-na-bedru-nas-uci/>.

6 Hadithin e shënon El-Hakimi.

7 Hadithin e shënon Ed-Dejlemiu.

8 Hadithin e shënon Et-Taberaniu.

9 Hadithin e shënon Imam Muslimi në Sahihun e tij.

10 Surja Ta-Ha, ajeti 132. Përkthimi i ajetit nga Haxhi Sherif Ahmeti.

Mektebi është një nga shtyllat kryesore në aktivitetet e Bashkësisë Islame, sepse bashkon familjen dhe xhematin duke edukuar anëtarët e saj të ardhshëm.

Më shumë se një nekrolog për shokun dhe mikun tim të çmuar, Jashar ef. Jasharin

Në fillim, ju shpreh dhembjen që kam personalisht, familjes dhe të gjithë miqve, dhe në të njëjtën kohë edhe duatë e zjarra që rahmetliun, Allahu ta vendosë në Xhenet. E tash këtu do të përmend ajetet kuranore 25 dhe 26 të sures El Murselat: “A nuk e bëmë Ne tokën që në gjirin e vet mban të gjallë dhe të vdekur?”

Përcaktimi i të Madhit Allah shkon në vend. S’ ka shybe. Të enjten, ditën e parë të Ramazanit, ky shpirt i ndritur kaloi në Ahiret. Të xhumanë, të parën në këtë Ramazan, Jashar efendiu u vendos në shtëpinë e parë të Ahiretit. Ky burrë fisnik, gjatë gjithë jetës përjetoi momente të rënda. U rrit jetim, sepse babën ia vranë çetnikët serbë, por edhe atyre, i ati i Jashar efendiut ua kishte dhënë hakun. Katër vjeç ishte në atë kohë.

Me gjithë këto vuajtje të rënda në atë kohë, Jashar efendiu do të shkollohej për hoxhë, sepse kështu mori edukatë islame nga nëna dhe familja e vet, duke e forcuar shumë edhe dashurinë për vatan. Pas Medresesë, ai nisi punën në Bashkësinë Islame në Kosovën tonë. Këtu bëri punët më të përgjegjshme. Ishte i ditur dhe shumë i përpiktë karshi obligimeve të marra. Me zotësitë e një hoxhe shumë të përgatitur, përfitonte zemrat e xhematlive. Kur lexonte Kuran me një zë të ëmbël, të zaptonte në shpirt.

Jashar efendiu si jurist i përgatitur, në Bashkësinë Islame të Kosovës, ishte sekretar i përgjithshëm. Këtë funksion e kreu derisa shkoi në pension. Këtë punë e përfundoi faqebardhë. Këtu do ta rrëfej një anekdotë që ka të bëjë me këtë burrë të guximshëm dhe shumë fisnik. ...iuu

Pas viteve të nëntëdhjeta, kur po na pritnin ditë shumë të rënda, po pse jo edhe BIK-un, Jashar efendiu kishte marrë një aktvendim, në kuadër të punës së sekretarit. Atë aktvendim ia dhashë një juristi me funksion më të lartë në organet e Judikaturës së Kosovës. Pasi e lexoi, më tha: “Mulla Ali, kush e ka përpiluar këtë aktvendim?”

Unë i thashë: “Sekretari i Përgjithshëm i BIK-ut, Jashar ef. Jashari.” Ai më tha: “Pak juristë ka Kosova që mund të bëjnë



aktvendime të këtilla. Hallall i qoftë! Paska dituri të thella!” Kështu e shihnin të mençurit këtë burrë fisnik. Kështu e meritonte respektin. Precizitetin e tij me të cilin trajtonte një problematikë nuk mund ta ketë askush. Binomin fe e atdhe e kishte shumë të ruajtur dhe plot zjarr dashurie. Nuk kish’ njeri që mund ta largonte nga ky sifet me plotë të mbara, e që edhe më shumë e hijeshonin personalitetin e tij. Po e përmbyll këtë nekrolog me një dyvargësh që e këndoi fyelli i Xhelaluddin Rumiut:

“ Kush u nda nga origjina si një pikë në gjithësi, Pa pushim përpiqet koha ta bashkojë përsëri.”

Edhe hoxha ynë u kthye në origjinë prej ku doli. Artisti e do artin e tij...

Mulla Ali Vezaj
Prizren

Urimi i Myftiu të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e festës së Fitër Bajramit

*Të nderuar besimtarë,
Vëllezër dhe motra!*

Sonte, në vaktin e iftarit, besimtarët myslimanë mbyllin agjërimin e muajit të bekuar Ramazan, gjatë të cilit me përkushtim, bindje e devotshmëri, kryen një ndër kushtet themelore të besimit islam – agjërimin e muajit Ramazan.

Agjërimi i muajit Ramazan është ibadet të cilin besimtari e kryen vetëm për hir të Krijuesit, për ta arritur kënaqësinë e Tij, dhe i bindur se Ai do ta shpërblejë atë në Ahiret.

Gjatë muajit Ramazan, besimtarët përveç që shprehën përkushtimin ndaj Krijuesit, duhet përmendur se agjërimi i bëri ata, por edhe komunitetin e shoqërinë, më të ndjeshëm, më solidarë, më humanë e më socialë.

Nimetet dhe begatitë e agjërit me të cilat Zoti xh.sh. i furnizoi besimtarët ishin të mëdha e të shumta.

Gjatë një muaji të tërë ishim si asnjëherë tjetër bashkë në adhurime, falje e lutje. Ishim bashkë në syfyre e në iftare, vizituam familjarë, farefis e miq, treguam solidaritet, mbështetje, respekt e dashuri. Shtëpitë, lagjet e xhamitë tona përjetuan në formën më të mirë gjallërinë, të shoqëruar me ibadete me më të dashurit tanë, me miq e farefis.

Vëllezër e motra!

Ramazani po e përcjellim të lumtur që Krijuesi na e dha mundësinë t'i përfetojmë nimetet e tij, e nesër, krenarë e faqebardhë, me familjet tona festojmë festën e Fitër Bajramit, festë kjo tashmë e shtresuar thellë në identitetin tonë. Fitër Bajrami është festa më popullore që prek të gjitha moshat dhe të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Fitër Bajrami na vjen pas një muaji të mëshirës e sakrificës, pas muajit të faljeve e begatitë të veçanta që i sjell vetëm Ramazani, dhe si i tillë përveç që kemi kryer një urdhër të Zotit, jemi të sigurt se nga ky muaj do të dalim më të dëlirë, më humanë, më të afërt me njëri-tjetrin, më solidarë e më të fisnikëruar.

Nimetet, mësimet e porositë e muajit të bekuar Ramazan, duhet të na shoqërojnë edhe në muajt e tjerë, e para prej tyre është kujdesi ndaj familjes, ruajtjes së saj, si dhe rritës dhe edukimit të drejtë të saj. Vetëm një familje e shëndoshë dhe e edukuar mirë, është themeli për një komunitet e shoqëri me vlera e parime fisnike.

Familja te populli ynë, në vazhdimësi ka qenë institucioni më i vlerësuar e më i çmuar, vlera këto të cilat duhen trasuar e ruajtur me xhelozë edhe te brezat e rinj. Atakimi i vlerave mbi të cilat është ngritur familja te ne, nuk është në të mirën



tonë dhe të popullit tonë. Po ashtu, e kemi obligim që ta ruajmë e ta ngremë vendin tonë aty ku e meriton ai.

Ka dashtë Zoti që tash e sa vite vendi ynë është i lirë e i pavarur, mirëpo është obligim yni që vendin tonë ta ndërtojmë e ta bëjmë me perspektivë, një vend ku jetohet me dinjitet, ku fëmijët tanë të rriten të sigurt e të marrin edukim e arsimim cilësor, një vend ku sigurojmë vende pune e jetesë të dinjitetshme.

Dikur lirinë e vendit e kishim ide e projekt, ndërsa tani falë sakrificës shekullore të popullit, tash e sa kohë shtetin tonë e kemi realitet, por, si qytetarë të këtij vendi, e kemi obligim që ta bëjmë më të mirën për vendin tonë, që ta bëjmë atë të jetueshëm për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Braktisja e vendit nuk është zgjidhje e duhur, sidomos nga të rinjtë dhe ekspertët tanë. Jeta në këtë botë nuk e ka qëllim e mision vetëm anën materiale. Dashtë Zoti që vendi ynë, me angazhimin tonë, të bëhet vend ku jetohet e punohet me dinjitet.

Vëllezër dhe motra!

Në këtë natë të madhe, në vigjilje të festës së Fitër Bajramit, lusim Zotin për mirësi, begati, paqe e harmoni, larg zënkave e konflikteve, sherreve e egoje të dynjasë.

Duke ju uruar e përgëzuar, lutem që në familjet tona festa e Fitër Bajramit të na sjell ngrohtësi, dashuri, harmoni e lumturi.

Agjërim, lutje e ibadete të pranuar!

Me fat festa e Fitër Bajramit!

Prishtinë, 20 prill 2023

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava

STOLISËT QYTETI I PRISHTINËS PËR NDER TË MUAJIT RAMAZAN

Më 2 prill 2023, pjesa e qytetit, e cila lidh tri xhamitë, atë “Sulltan Mehmet Fatih”, xhaminë “Jashar Pasha” dhe xhaminë “Sulltan Murat”, u stolis për nder të muajit të bekuar Ramazan. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë së bashku me kryetarin e Prishtinës, z. Përparim Rama ishin prezent në këtë ngjarje. Myftiu Tërnavë e vlerësoi këtë nismë, e cila u realizua për herë të parë në Prishtinë, duke falënderuar bashkëpunëtorët, të cilët mundësuan realizimin e këtij projekti. Ndërsa kryetari i Prishtinës, tha se kjo pjesë e Prishtinës nga viti i ardhshëm do të



shndërrohet në një ambient tjetër me parqe e lokale afariste, e cila do të krijojë

një atmosferë të këndshme për besimtarët e turistët.

IFTARI I SHTURAR NË KUVENDIN E KOSOVËS

Më 17 prill 2023, presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, shtruan iftar për Myftiun Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij. “Me kënaqësi i kemi ftuar sonte udhëheqësinë e BIK-ut për të marrë pjesë në iftarin tonë të posaçëm në Shtëpinë e Popullit, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, bashkë me Presidenten Vjosa Osmani. Urojmë një mbrëmje të këndshme dhe të bekuar për të gjithë pjesëmarrësit e këtij iftari” – shkroi në profilin e tij në Facebook kryetari Konjufca. Myftiu Tërnavë falënderoi presidenten Osmani dhe



kryetarin Konjufca për shtrimin e këtij iftari të përbashkët, duke potencuar kështu përkushtimin e Bashkësisë

Islame të Kosovës për të krijuar në vend një frymë paqeje dhe solidariteti për të gjithë qytetarët pa dallim.

KRYEMINISTRI KURTI SHTRIOI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BIK-UT

Më 13 prill 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e shtruar nga kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, i cili shoqërohej nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku. Kryeministri Kurti u uroi agjërimit sa më të lehtë të ditëve të mbetura të këtij muaji të shenjtë për besimtarët myslimanë. “Muaji Ramazan është muaj i devotshmërisë, mirësjelljes me njerëzit përreth dhe ndihmës për atë në nevojë. Në iftare të përbashkëta si sonte përcjellim mesazhin e tolerancës, solidaritetit dhe mirësisë” – u shpreh kryeministri Kurti.



Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryeministrin Kurti për shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu përkushtimin e institucionit të

Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e paqes dhe vlerave humane në vend.

KRYETARI I AAK-SË, Z. RAMUSH HARADINAJ SHTROI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BIK-UT

Më 3 prill 2023, Myftiu Tërnavë me bashkëpunëtorë, mori pjesë në iftarin që shtroi lideri i AAK-së z. Ramush Haradinaj. Me këtë rast, kryetari Haradinaj, theksoi se: “Harmonia dhe solidariteti në rrugën drejt qëllimeve të përbashkëta, janë vlerë e madhe e jona që e kanë lakmi edhe popujt me demokracitë më të avancuara.” Myftiu Tërnavë duke falënderuar kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinaj për këtë iftar që tashmë është bërë tradicional, theksoi se BIK-u vazhdimisht punon që në Kosovë të ketë harmoni e bashkëjetesë dhe respekt të ndërsjellë mes të gjithë njerëzve pavarësisht dallimeve etnike dhe fetare që mund t’i kemi.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NDËRTIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E PROJEKTIT “QENDRA ISLAME NË LIPJAN”

Më 4 prill 2023, Myftiu Tërnavë dhe drejtori i organizatës “Qatar Qarity”, Esam Dabab, nënshkruan marrëveshjen për ndërtimin dhe funksionalizimin e projektit “Qendra Islame në Lipjan”. Myftiu Tërnavë, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, tha se në këtë qendër do të zhvillohen aktivitete arsimore dhe kulturore-fetare. Ai tha se me këtë projekt, ne jemi më afër xhemit tonë. Myftiu falënderoi organizatën “Qatar Qarity” për realizimin e këtij projekti, duke shprehur se deri më tani, me këtë organizatë kemi realizuar shumë projekte në të mirë të qytetarëve tanë, për çka shprehu mirënjohje për shtetin e popullin e Katarit, që vazhdimisht kanë përkrahur Kosovën në të gjithë etapat.



Edhe drejtori i organizatës “Qatar Qarity”, Esam Dabab, u shpreh i lumtur që u nënshkrua kjo marrëveshje dhe që punët do të fillojnë sa më parë. Ai tha se BIK-u është palë gjithnjë e përkushtuar në realizimin e projekteve në të mirë të interesit të qytetarëve.

KRYETARI I PDK-SË, Z. MEMLI KRASNIQI SHTROI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BIK-UT

Më 5 prill 2023, Myftiu Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e shtruar nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqi. Z. Krasniqi tha: “Uroj që frymëzimi i këtij muaji, për të bërë vepra të mira për familjen, shoqërinë e shtetin, të na përcjellë gjatë gjithë kohës.” Ai me këtë rast përgëzoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për punën e vlefshme në ndihmë të nevojtarëve. Ai falënderoi Myftiun veçanërisht për mbështetjen e madhe që BIK-u i dha marshit paqësor për drejtësi, në solidarizim me themeluesit e UÇK-së në Hagë”.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës për iftarin tashmë tradicional, duke shprehur kështu angazhimin dhe përkushtimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e vlerave qytetare në vend.



MYFTIU TËRNAVA NDAU MIRËNJOHJE PËR NDËRTUESIN E XHAMISË NË TOPALLË

Më 7 prill 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i ka dhuruar mirënjohje Muharrem Salihut, në shenjë falënderimi për kontributin dhe angazhimi në jetën fetare. Z. Salihu ndërtoi xhaminë e bukur dhe unike në Topallë të Medvegjës. Ai mbetet mjaft aktiv në idetë dhe investimet në këtë pjesë të ndjeshme, andaj ndërtimi i kësaj xhamie atje është i veçantë, ashtu sikurse xhamia në aspektin e arkitekturës. Arkitekti i saj, Arbër Sadiki, u shpërblye me çmimin prestigjioz të arkitekturës islame në Riad.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM REISIN E BFI-SË SË RMV-SË, SHAQIR EF. FETAIN

Më 7 prill 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion të lartë të Bashkësisë Fetare të Maqedonisë së Veriut, të prirë nga reisi Shaqir ef. Fetai. Qëllimi i kësaj vizite ishte thellimi i bashkëpunimit në mes të dy institucioneve fetare për çështjet e projektet e përbashkëta, të cilat janë me interes për të dyja institucionet dhe besimtarët shqiptarë. Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje reisit dhe e përgëzoi për angazhimin e kësaj bashkësie që bën në

organizimin e jetës fetare në Maqedoninë e Veriut. Nga ana tjetër, reisi Shaqir ef. Fetai, në emër të besimtarëve të Maqedonisë së Veriut e uroi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për muajin Ramazan, duke e falënderuar njëkohësisht për bashkëpunimet e frytshme që po realizohen në mes dy bashkësive fetare. Ai tha se vizitat mes dy bashkësive janë të domosdoshme, duke marrë parasysh se jemi një komb me një traditë e histori.



FSHATI CERAJË NË LEPOSAVIQ BËHET ME XHAMI

Më 7 prill 2023, është bërë përrurimi i xhamisë në fshatin Cerajë të Leposaviqit. Në përrurimin e xhamisë morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Enis Rama, imamë dhe efendilerë të tjerë, si dhe xhematë të shumtë. Në ndërtimin e këtij objekti fetar kanë kontribuar donatorë të ndryshëm, ndërkaq banorët e asaj zone janë shprehur të kënaqur dhe e kanë konsideruar këtë veprim kombëtar e patriotik.



IFTARI TRADICIONAL PËR PUNONJËSIT E BIK-UT

Më 8 prill 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shtroi iftar për të gjithë udhëheqësit e këshillave të Bashkësisë Islame, administratat dhe nëpunësit fetarë. Ky iftar në ditën e fitores në Bedër është shndërruar tashmë tradicional, e që mbahet në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë.



Më 14 prill 2023, Myftiu shtroi iftar për të gjitha punonjëset e këtij institucioni. Ky iftar u shtrua në ambientin e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë. Myftiu Tërnavë në fjalën e tij i përgëzoi mualimet për punën dhe përkushtimin që po e bëjnë në edukimin dhe mësimin e fesë islame.

KRYETARI I LDK-SË, Z. LUMIR ABDIXHIKU SHTRIOI IFTAR PËR UDHËHEQËSIT E BIK

Më 16 prill 2023, Myftiu Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e shtruar nga kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku. Kryetari Abdixhiku ndër të tjera tha: “Këto ditë të fundit të muajit të Ramazanit, besimtarët myslimanë luten për agjërim të pranuar dhe të dalin nga ky muaj të pasuruar shpirtërisht. Le të shërbejnë këto ditë për të dhënë mesazh për më shumë solidaritet, tolerancë dhe paqe në vendin tonë.”



Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin Abdixhiku për shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që në vend të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërmjet gjithë qytetarëve të vendit pa dallim.

MYFTIU MBAJTI LIGJËRATË NË XHAMINË E BARDHOSHIT DHE “PAVARËSIA” NË PRISHTINË

Më 16 prill 2023, për nder të Natës së madhe të Kadrit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mbajti një ligjëratë në Xhaminë e Bardhoshit kushtuar vlerës dhe rëndësisë që ka kjo natë.



Më 18 prill 2023, për nder të dhjetë netëshit të fundit të Ramazanit dhe Natës së Kadrit, Myftiu mbajti ligjëratë para namazit të teravive në xhaminë “Pavarësia” në Prishtinë, në praninë e shumë xhematlinjeve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË, AMBASADORIN MICHAEL DAVENPORT

Më 18 prill 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin z. Michael Davenport.

Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi mirëseardhje dhe më pas e njohu ambasadorin Davenport me organizimin e jetës fetare në Kosovë, si dhe me aktivitetet që po bënë BIK-u gjatë muajit të bekuar Ramazan. Myftiu Tërnavë çmoi dhe vlerësoi lart bashkëpunimin me OSBE-në përgjatë viteve në realizimin e shumë projekteve, e sidomos në fushën e dialogut ndërfaqetor në Kosovë.

Nga ana e tij, ambasadori Davenport, falënderoi Myftiun për pritjen dhe nënvizoi bashkëpunimin shumë të mirë që ka me institucionin e BIK-it,



duke potencuar edhe njëherë rolin efikas që ka luajtur Myftiu Tërnavë dhe BIK-u për harmoninë, bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfaqetare dhe ndëretnike në Kosovë. Në fund, ambasadori Davenport e uroi Myftiun Tërnavë dhe

gjithë besimtarët myslimanë për festën e Fitër Bajramit.

Dy palët u pajtuan se rruga e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve edhe më do të thellohet në të ardhmen.

MYFTIU TËRNAVA SHITROI IFTAR PËR IMAMËT MYSAFIRË NGA TURQIA

Më 20 prill 2023, Myftiu Tërnavë shiti iftar për imamët mysafirë nga Turqia, që kanë shërbyer nëpër disa xhami të Kosovës gjatë muajit të bekuar Ramazan, falë bashkëpunimit mes BIK-it dhe Dijanetit të Turqisë. Në këtë iftar që prezent edhe këshilltari për Çështje Fetare pranë Ambasadës Turke në Kosovë, z. Bunjamin Albayrak. Myftiu Tërnavë falënderoi imamët për shërbimet fetare dhe kontributin e tyre në xhamitë e Kosovës gjatë këtij muaji të bekuar, e në veçanti falënderoi popullin dhe shtetin turk për ndihmën dhe mbështetjen që ka dhënë dhe po jep për fuqizimin e shtetit dhe popullit të Kosovës. Në fund, Myftiu Tërnavë ndau mirënjohje për të gjithë imamët vizitorë, që me përkushtim e korrektësi kanë shërbyer gjatë muajit Ramazan.



TURQIA DËRGOI NË KOSOVË 5 MIJË PAKO USHQIMORE



Më 12 prill 2023, Drejtoria e Vakëfeve në Turqi ka dërguar pesë mijë pako për muajin Ramazan, e të cilat u shpërndan në 10 ditshin e fundit të Ramazanit. Turqia përkundër se u godit nga tërmete të mëdha, përsëri është pranë Kosovës dhe në veçanti pranë rasteve të ndjeshme në Kosovë. Këtë pako ushqimore u shpërndan në të gjithë Kosovën.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS SHTROI IFTAR NË ULQIN


Më 13 prill 2023, Bashkësia Islame e Kosovës, shtroi iftar për Këshillin, imamët, myezinët, mytevelitë dhe aktivistët e Mexhlsit të Bashkësisë Islame të Ulqinit. Fillimisht një fjalë rasti për t'iu uruar mirëseardhje e mbajti kryetari i Mexhlsit të BI-së së Ulqinit, z. Hysni Begu. Më pas një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, i cili foli



në pika të shkurtra rreth këtij iftari, i cili tashmë është shndërruar në tradicional, duke thënë se me këtë synojmë ruajtjen e lidhjeve shpirtërore ndërmjet institucioneve. Ndërkaq, të premten, më 14 prill, delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti hytben e xhumasë në disa xhami të Ulqinit. Në xhaminë e Pinejshit ligjëroi kryeimami Vedat ef. Sahiti, në xhaminë e Rashishtes së Naltë, ligjëroi dekani i FSI-së, Islam ef. Hasani, në xhaminë e Mezjahit ligjëroi Agim ef. Gashi, ndërsa në xhaminë e Lamit ligjëroi Abedin ef. Sadriu.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NË PLLATON E PALLATIT TË RINISË

Më 5 prill 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama dhe ambasadorin e Turqisë në Kosovë, z. Tunc Angilli, morën pjesë në iftarin, i cili shtrohet tash e 17 vjet në pllato e Pallatit të Rinisë nga fondacioni “Ejup Sulltan” nga Turqia. BIK-u që nga fillimi ka qenë një nga partnerët kryesor të fondacionit “Ejup Sulltan”, duke siguruar kështu mishin përgjatë gjithë muajit Ramazan. Çdo natë të muajit Ramazan këtu ushqehen deri në 3 mijë persona në iftar dhe syfy. Dimensioni social i Ramazanit është një element shumë i rëndësishëm, i cili kalit akoma më shumë solidaritetin dhe humanitetin, si dhe fisnikëron shpirtin e besimtarit.



KRYEIMAMI SAHITI MBAJTI LIGJËRATË NË SHTIME

Më 8 prill 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në tribunën fetare të organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Shtimes. Në këtë tribunë mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, kryesuesi i asamblesë komunale, drejtues të institucioneve komunale, si dhe shumë qytetarët të Shtimes. Fillimisht këtë tubim e përshëndeti kryetari i Këshillit të BI-së së Shtimes, Skender ef. Baftiu. Kryeimami Sahiti mbajti një ligjëratë kushtuar Ramazanit dhe shpalljes hyjnore. Ai foli rreth të mirave dhe begative që sjellë muaji Ramazan. Tribuna u shoqërua me këndimin e pjesëve nga Kurani dhe ilahive, të cilat u interpretuan nga Avdush ef. Krosa dhe Armend ef. Beqiri.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KOMUNA E GRAÇANICËS

Më 10 prill 2023, për nder të muajit të bekuar Ramazan, Komuna e Graçanicës, shtroi iftar për komunitetin mysliman në këtë komunë. Fillimisht të pranishmit në këtë iftar i përshëndeti nënkryetari i Komunës së Graçanicës, Leutrim Ajeti, i cili iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve në këtë iftar. Pjesë e këtij iftari ishte edhe kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, i cili falënderoi Komunën e Graçanicës për shtrimin e këtij iftari. Ai foli shkurtimisht edhe rreth vlerave dhe begative që sjellë muaji Ramazan. Në këtë iftar morën pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Novobërdës, Bajrush Imeri, nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi dhe nënkryetari i Komunës së Obiliqit, Ibush Mjekiqi, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës, Policisë së Kosovës, OSBE-së, UN, si dhe bashkëpunëtorë të tjerë të komunës.



KRYESIA E BIK-UT SHTRIOI IFTAR NË BUJANOC



Më 15 prill 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, shtroi iftar për Këshillin, imamët, përfaqësuesit komunal, drejtorët e shkollave dhe qytetarët e Bujanocit. Në këtë iftar mori pjesë edhe kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti me bashkëpunëtorë. Ai fillimisht përcolli urimet dhe përshëndetjet e përzemërta të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Kryeimami Sahiti çmoi lart kontributin e imamëve të Luginës së Preshevës për ruajtjen e Islamit në këtë rajon. Pas iftarit, delegacioni i BIK-ut vizitoi disa xhami, ku edhe ligjëruan para xhematit të kësaj treve dhe i prinë faljes së namazit të teravive.

KRYEIMAMI I KOSOVËS QËNDROI NË MEDVEGJË

Më 17 prill 2023, një delegacion i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i udhëhequr nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti ka qëndruar të dielën në Medvegjë, me ç'rast vizituan banorët e saj dhe fshatrave përreth për t'u informuar për mbarëvajtjen e jetës fetare në këtë pjesë dhe në veçanti gjatë muajit Ramazan. Kryeimami së bashku me dekanin e Fakultetit të Studimeve Islame, Islam Hasanin, drejtorin për Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra dhe imamë nga Prishtina vizituan fillimisht xhaminë e fshatit Topallë, xhami kjo e cila u vlerësua në Riad për arkitekturën islame. Kryeimami Sahiti mori pjesë më pas në iftarin tashmë tradicional që shtrohet në Medvegjë me banorët e kësaj pjese. Vizita e tillë nga Kryesia e BIK-ut, u çmua dhe u vlerësua edhe nga imami i xhamisë së fshatit Sjarinë dhe besimtarët atje. Po ashtu delegacioni i Kryesisë së BIK-ut vizituan edhe fabrikën e tekstit, e cila është së fundmi ka kaluar në pronësi të një biznesmeni shqiptar.



DELEGACIONI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS VIZITOI DIASPORËN

Drejtori Simnica vizitoi Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bernë të Zvicrës

Më 13 mars 2023, drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, dhe kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, të shoqëruar nga nënkryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, Fehim ef. Abasi, vizituan Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bernë të Zvicrës, në të cilën u pritën nga ambasadori i Ambasadës të Kosovës, z. Sami Ukella dhe nga sekretari i parë, Gjenis Haxhimemmeti. Drejtori Simnica uroi dhe falënderoi z. Ukellën për pritjen, duke përcjell kështu edhe përshëndetjet e Myftiut Tërnavë. Ai e përgëzoi atë për punën dhe koordinimin që bën me Qendrat Shqiptare Islame në Zvicër, duke i dëshiruar shëndet, suksese e mbarësi në punën e tij. Nga ana e tij, z. Ukelli, i uroi mirëseardhje drejtorit Simnica, të cilin më pas e njohu edhe me punët dhe angazhimet e Ambasadës. Ai shtoi se duhet edhe më tej të ketë një koordinim ndërmjet qendrave shqiptare dhe Konsullatës, me qëllim të koordinimit dhe bashkëpunimit në punë.

Vizitë në xhaminë “Höri” në Cyrih

Më 14 prill 2023, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ligjëroi për namaz të xhumasë, në xhaminë “Höri” në Cyrih të Zvicrës, konkretisht tek imami Bilal ef. Tahiri. Drejtori Simnica e uroi dhe e përgëzoi imamin e nderuar, kryesinë dhe xhematin në emër të BIK-ut, në emër të organeve udhëheqëse të saj dhe në emrin e Myftiut Tërnavë. Gjithashtu ai i falënderoi për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm të tyre për institucionet tona fetaro-arsimore, Medresenë “Alauddin” dhe Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Vizitë dhe iftar në xhaminë shqiptare në Cyrih

Në vazhdën e vizitave të rregullta, më 14 prill, drejtori i Diasporës, vizitoi për iftar xhaminë shqiptare në Cyrih, ku u prit nga imami Nebih ef. Rexhepi, kryetari, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Përfaqësuesi i BIK-ut, mbajti edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan. Drejtori Simnica në ligjëratën e tij falënderoi të gjithë mërgimtarët tanë për kontributin e vazhdueshëm dhënë për vendlindjen në përgjithësi, e në veçanti për institucionin e BIK-ut.

Vizitë dhe iftar në xhaminë e Regensdorfit

Më 15 prill, në vazhdën e vizitave të rregullta, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, vizitoi për namaz të drekës



xhaminë e Regensdorfit, ku u prit nga imami, Ferit Zeqiri, kryesia dhe xhemat i kësaj xhamie, ndërsa për iftar dhe namaz të teravive vizitoi Xhaminë e Bardhë shqiptare në Aarburg – Zvicër, ku u prit nga imami, Nehat ef. Ismaili, kryetari, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Përfaqësuesi i BIK-ut, mbajti edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan, para namazit të jacisë.

Vizitë në “Mesxhidi – Nur” dhe “Ebu Hanife

Më 16 prill 2023, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ligjëroi për namaz të drekës në xhaminë “Mesxhidi – Nur” në Frauenfeld të Zvicrës. Drejtori Simnica e uroi dhe e përgëzoi imamin e nderuar, kryesinë dhe xhematin në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të organeve udhëheqëse të saj dhe në emrin e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan. Gjithashtu ai i falënderoi për ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm të tyre për institucionet tona fetaro-arsimore, Medresenë “Alauddin” dhe FSI në Prishtinë.

Më 16 prill, drejtori Simnica, ishte i ftuar për iftar në xhaminë “Ebu Hanife” në Grenchen në Zvicër, ku u prit me një pritje të ngrohët nga imami i përkohshëm, Sylejman ef. Fejzullahu, nënkryetari, z. Ragaibi, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Kishte mysafirë edhe nga qendrat e tjera, imamë, kryesi xhamish nga vende të ndryshme në Zvicër.

Vizita në xhaminë “OAZA” dhe në xhaminë “Sunnah”

Gjatë kohës së namazit të drekës, drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, vizitoi xhaminë “OAZA” në Spreitenbach – Cyrih. Përfaqësuesi i BIK-ut, u prit nga imami Xheladin ef. Leka, anëtarët e Kryesisë së xhamisë dhe nga xhemati. Pas namazit, drejtori Simnica, mbajti një ligjëratë.

Në vazhden e vizitave të rregullta, më 17 prill, drejtori Simnica, vizitoi për iftar xhaminë “Sunnah” në Dietikon në Cyrih, në Zvicër, ku u prit nga imami Muhamer ef. Latifi, kryetari Qamil Xhelili, anëtarët e Kryesisë dhe nga xhemati i shumtë i kësaj xhamie. Ai para namazit të jacisë mbajti edhe një ligjëratë.

Drejtori Simnica, në ligjëratat dhe vizitat e tij, theks të veçantë i kushtoi shpalosjes së punës dhe veprimtarisë së institucionit të BIK-ut dhe nevojës që mërgata jonë të vazhdojë përkrahjen edhe më tej ndaj këtij institucioni nëpërmes sadakatul fitrit, zekatit dhe ndihmave të ndryshme për të mundësuar kështu mbarëvajtjen e veprimtarisë fetare në vendin tonë. Përfaqësuesi i BIK-ut këtu e përfundoi vizitën e tij në Zvicër, ku falënderoi të gjithë ata që organizuan programin e kësaj vizite, duke filluar nga udhëheqësia e KMSHZ-së, gjegjësisht kryetarin e saj, Mehas ef. Alija, sekretarin, z. Ismail Ademi, arkëtarin, z. Sami Avdyli, imamët, si dhe kryesitë e xhamive me xhematët e tyre për të gjithë respektin dhe mikpritjen në nivelin më të lartë.



BESIMTARËT MYSLIMANË FESTUAN FITËR BAJRAMIN



Më 21 prill 2023, besimtarë të shumtë në Kosovë, por dhe më gjerë festuan festën e Fitër Bajramit, festë kjo e cila vjen pas agjërimit të muajit Ramazan. Besimtarë të shumtë anekënd trojeve shqiptare janë bashkuar në orët e para të mëngjesit për të falur namazin e sabahut e më pas edhe atë të Fitër Bajramit. Manifestimi qendror në Kosovë u

mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Fillimisht u ligjëruea për festën e Fitër Bajramit dhe rolin e Ramazanit nga teologu Muhamed Stublla. Manifestimi vijoi më pas me faljen e namazit të sabahut, e më pas edhe të Bajramit, të cilit i priu kryeimami i Kosovës, Vedat ef, Sahiti, ndërsa hytben e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili përçoi

mesazhe paqeje, solidariteti, afërsie mes njëri-tjetrit. Veç të tjerash, Myftiu Tërnavë, apeloj te të gjithë qytetarët e Kosovës që të mos largohen nga vendi, por njëkohësisht edhe të krijohen kushte më të mira. Besimtarët janë ata që e ndjenjë më së shumti këtë festë, e cila vije pas agjërimit të Ramazanit, por edhe ibadeteve të tjera të shumta.

MYFTIU TËRNAVA ORGANIZOI PRITJE PËRURIMI PËR FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Më 21 prill 2023, me rastin e Fitër Bajramit, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë dhe nëpunës të Kryesisë së BIK-ut, si tradicionalisht, organizoi pritje përurimi në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës nga ora 9:00-12:00 .

Nga institucionet për vizitë erdhën

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti me kabinetin e tij, ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili, drejtori i Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Behar Ejupi.





Nga partitë politike

Z. Lumir Abdixhiku, kryetar i LDK-së, z. Besnik Tahiri nga AAK, z. Bajrush Xhemajli nga PDK, Ferid Agani, kryetar i PD-së, Qazim Rrahmani, sekretar i përgjithshëm nga Partia e Ashkalinjve për Integrim.



DEKLARATA NGA DISA PERSONALITE ME RASTIN E URIMIT TË FESTËS

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, në urimin e tij për festën e Fitër Bajramit, theksoi rolin dhe kontributin e madh historik dhe shoqëror që ka luajtur dhe po luan BIK-u në ndërtimin e institucioneve shtetërore. “Pas një muaji përkushtimi e sakrifice për lartësim shpirtëror, uroj që kjo festë t’ju sjellë gëzim dhe paqe! Si ditë e besimit dhe shpresave të reja qoftë ditë e ripërtëritjes së dashurisë për njeriun dhe njerëzoren. Në solidaritet me të varfrit e të vetmuarit, kjo festë ua mbush të zemrat me mirënjohje. Uroj mirësi e begati në shtëpitë tuaja dhe në shtetin tonë!” – u shpreh kryeministri Kurti.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhiku, tha: “Lutje dhe agjërime të pranuar për të gjithë ata që kaluan një muaj sakrifice sprovuese nën shenjë të Zotit. Festa e Fitër Bajramit i kurorëzon përpjekjet e të gjithë atyre që besojnë në Krijuesin, që kanë përshkuar udhëtimin shpirtëror njëmuajor, e që ia kanë dalë mbanë të jenë bërë më të vërtetshëm, më të mëshirshëm dhe më zemërgjerë. Le të vazhdojmë të forcojmë edhe më tej këtë ndjenjë që muaji i shenjtë dhe festa e Fitër Bajramit na mësojnë. Atë të solidaritetit, të harmonisë e të kujdesit ndaj tjetrit. Në veçanti, le të kujdesemi ndaj atyre në nevojë. Shëndet, paqe e begati për ju e familjet tuaja; për gjithë atdheun tonë!”

Z. Besnik Tahiri nga AAK tha: “Bashkërisht me kolegë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës sot patëm nderin që të urojmë Myftiun e Kosovës për festën e Fitër Bajramit, e përmes Myftiut dhe Bashkësisë Islame të Kosovës të urojmë të gjithë qytetarët e Kosovës. Ky muaj është muaj që simbolizon solidaritetin dhe përkushtimin për të gjithë ata njerëz që kanë agjëruar gjatë këtij muaji, por edhe njëkohësisht edhe të gjithë ata që kanë ndihmuar qytetarët e Kosovës, popullin shqiptar, në këtë muaj të solidaritetit. Për ne është shumë me rëndësi që këto festa janë festa që na bashkojnë por njëkohësisht na vendosin në momente për të reflektuar”, tha Tahiri.

Kryetari i Partisë së Ashkalinjve për Integrim, z. Qazim Rrahmani, tha: “Ashtu siç kanë ditur myslimanët të jenë të bashkuar gjatë muajit Ramazan, shpresoj që edhe në festë të jemi sa më të bashkuar dhe Ramazani të lë shenjë që të jemi sa më afër njëri-tjetrit dhe për ta ndihmuar e mirëkuptuar njëri-tjetrin. Kjo festë i bashkon gjithë njerëzimin, andaj në emër të komunitetit shprehi urimet më të sinqertë për të gjithë besimtarët mysliman por edhe për Myftiun Tërnava.”

Ispeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, u shpreh: “Jam i kënaqur që jam këtu për të uruar kryemyftiun Tërnava për t’i uruar festën e Bajramit e së bashku edhe të gjithë besimtarëve të besimit islam. Këtë muaj kemi agjëruar të gjithë sepse kemi pasur edhe festën e Pashkëve, edhe festën e Bajramit kështu që besoj të gjithë populli është me uratë, me lutje dhe me agjërime dhe të kemi mundësi të jetojmë në paqe, dashuri, mirëkuptim, në pajtim, në falje dhe në unitet siç ka thënë Myftiu Tërnava në fjalën e tij të Bajramit.”



REALIZIMET

E SHOQATËS "BEREQETI"

GJATË MUAJIT RAMAZAN 2023

Donatorë,
Zoti
ju shpërbleftë
për mbështetjen
tuaj!

IFTARE
36000
SHUJTA

MIELL
55000
KG.

PAKO
17500
USHQIM
HIGJENË

PARA
TË GATHSME
20165
EURO

DHURATA
11800
PAKO

RROBA PËR
15000
FËMIJË



Kontribuo edhe ti në xhirollogarinë: OJQ SHOQATA BEREQETI,
Banka Ekonomike Sh.a. • IBAN: XK051401000000813233 • SWIFT Code (BIC): EKOMXKPRXXX,
 paypal.me/bislame

Donacionet tuaja mund t'i dorëzoni edhe në këshillat e Bashkësisë Islame nëpër qytetet e Kosovës.

 Shoqata Humanitare Bëmirëse Bereqeti  +383 38 224 024  +383 49 733 678